16. **Rritja ekonomike e Shqipërisë e kohëve të fundit që prej tranzicionit, ka qenë mbresëlënëse.** PBB pësoi një rritje të ndjeshme prej 6.6 përqind në vit që nga fillimi i programit të stabilizimit në vitin 1992 deri në vitin 1997, kur pati një ndërprerje masive të menjëhershme të veprimtarisë ekonomike për shkak të rënies së skemës së piramidave. Ritmet e rritjes u rikuperuan shpejt siç evidentohet nga shifra 7 përqind e rritjes mesatare vjetore reale të PBB midis viteve 1998 dhe 2006. Një pjesë e madhe e kësaj rritjeje ekonomike u përforcua nga një ulje e qëndrueshme e financimit të defiçitit, nga çmime të ulta dhe të qëndrueshme (inflacion), nga një rritje e produktivitetit total të faktorëve të prodhimit, si edhe nga kërkesa e fortë e ndikuar në një masë jo të vogël nga rritja e remitancave. Përvec kësaj, kushtet e tregut të punës duket të jenë përmirësuar veçanërisht në zonat urbane ku dallohet një rënie në normën e papunësisë, një rritje në punësimin e të rriturve si edhe një tendencë në rënie në migrimin e jashtëm.

17. **Evidenca tregon se gati e gjithë ulja e varfërisë ka ardhur si rrjedhojë e rritjes ekonomike.** Ndryshimet në varfëri mund të vijnë nga rritja e të ardhurave mesatare në një mjedis pabarazie të qëndrueshme ose nëpërmjet një rishpërndarjeje tek skaji më i ulët i shpërndarjes, madje edhe kur nuk ka ndryshime në të ardhurat mesatare, ose një ndërveprim midis të dyjave. Një proçedurë e tillë llogaritjeje tregon se një pjesë e madhe e uljes së varfërisë kohët e fundit në Shqipëri ka ardhur si rezultat i rritjes së të ardhurave mesatare brenda një kuadri vërtet të qëndrueshëm pabarazie. Po kështu mund të thuhet edhe për të gjitha rajonet e gjera agro-ekologjike të vendit, si edhe për zonat urbane dhe rurale. Përjashtime bëjnë zonat Bregdetare dhe Qëndrore ku një rritje më e madhe se mesatarja në pabarazi, ka çuar drejt një përgjysmimi të uljes potenciale të varfërisë e cila mund të vinte vetëm nga rritja ekonomike. Në tërësi, pjesa  e popullatës nën vijën e varfë risë, mund të ishte ulur me 9 pikë përqindjeje, (në vend të rezultatit aktual prej 7 pikë përqindjeje.) me përjashtim të një rritjeje të vogël në rishpërndarje në pjesët e sipërme të shpërndarjes që e kompensoi uljen e varfërisë me 2 pikë përqindjeje. Po kështu, ndryshimet në thellësinë dhe në ashpërsinë e varfërisë, tregojnë gjithashtu, së dominon komponenti i rritjes. (Grafik *.7*). Sikurse edhe në treguesin e nurmit të të varfërve (poverty headcount) ulja në thellësinë dhe ashpërsinë e përmasave të varfërisë, do të kishte qenë më e madhe në se nuk do të kishte patur ndryshime në pabarazi çka kundërbalancoi disa nga arritjet.

**Grafik .7: Proporcioni i ndryshimeve në Varfëri i shpjeguar me rritje dhe rishpërndarje**




18. **Rritja e konsumit që shpjegon normat e rënies së varfërisë shpjegohet pjesërisht edhe me rritjen e të ardhurave nga veprimtaritë shtëpiake**. Megjithatë, ka njëfarë dyshimi se në kontekstin e Shqipërisë, një pjesë e mirë e kësaj rritjeje në konsum vjen edhe falë migrimit. Fluksi i madh i migrantëve

dhe remitancat që ata dërgojnë, kanë kontribuar në rritjen e konsumit duke ulur madhësitë e familjeve, duke financuar konsumin drejtpërsëdrejti dhe duke ofruar kapital për fillimet e bizneseve.

**Migrimi dhe remitancat kanë përshpejtuar përmirësimet.**

19. **Si migrimi i brendshëm ashtu edhe ai ndërkombëtar kanë qenë masivë.** Mbi 20 përqind e të rriturve janë shpërngulur brenda vendit. Kjo do të thotë se rreth 450 000 persona aktualisht jetojnë në një vend të ndryshëm nga ai ku jetonin në vitin 1990. Në se ne do të numërojmë të shpërngulurit që në lindjen e tyre, atëhere përafërsisht 1 në 3 të rritur ka bërë shpërngulje brenda vendit, për pasojë rreth 16 përqind e kryefamiljarëve në të gjithë vendin janë individë që janë shpërngulur që në vitin 1990. Përpos kësaj, 34 përqind e familjeve kanë të paktën një anëtar të mëparshëm që aktualisht jeton jashtë shtetit dhe 50 përqind e këtyre familjeve kanë shumë anëtarë jashtë shtetit. Duhen vlerësuar tre pika nga migrimi i kohëve të fundit.

20. **Së pari, pjesa më e madhe e migrantëve, si të brendshëm edhe ndërkombëtarë, janë nga zonat rurale.** Pothuajse 2 në 3 migrantë të brendshëm dhe rreth 55 përqind e të gjithë migrantëve ndërkombëtarë, vijnë nga zona rurale. Deri rishtazi, flukset e migrantëve ruralë të brendshëm, janë drejtuar, në pjesë të barabarta, në zona të tjera rurale, në Tiranë dhe në zona të tjera urbane. Megjithatë, në mënyrë disproporcionale, qysh në vitin 2002, pjesa më e madhe po lëvizin drejt Tiranës.

21. **Së dyti, qysh në vitin 2002, fluksi i migrimit të brendshëm dhe ndërkombëtar, është ngadalësuar ndjeshëm dhe po tregon shenja rënieje**. Kjo ndodh për shkak të një sërë arsyesh. Një nga arsyet është së që me rënien e ekonomisë së komanduar, kushtet ekonomike janë përmirësuar ndjeshëm, sikurse tregohet edhe nga norma e lartë ë rritjes së PBB. Një arsye tjetër është se nuk ka ndodhur aktualisht një krizë aq e madhe që të jetë e barabartë për nga rëndësia dhe madhësia e vet me atë të skemave piramidale, çka duket se ka qenë shtysa kryesore, e vetme dhe më e madhe e migrimit të kohëve të fundit. Përfundimisht, ligjet e emigrimit në Greqi dhe në Itali, të cilat janë dy vendet pritëse më të rëndësishme për emigrantët ndërkombëtarë, janë forcuar në mënyrë të konsiderueshme.

22. **Së treti, përjashtim nga kjo prirje rënieje përbën fluksi i migrantëve nga zonat Malore**. Thuajse 30 përqind e migrantëve të brendshëm vijnë nga kjo zonë, megjithëse ajo përbën vetëm 11 përqind të popullatës së vendit. Një e katërta e njerëzve të lindur në zonat malore janë shpërngulur brenda vendit dhe gjysma e tyre jetojnë brenda ose në periferi të Tiranës. Ndërkohë që fluksi i migrantëve ndërkombëtarë ka rënë në të gjitha pjesët e tjera të vendit, ai ka vazhduar të rritet në zonat Malore. Në fund të vitit 2004, numri i migrantëve ndërkombëtarë nga këto zona filloi t'i përafrohej numrit të atyre të zonave Bregdetare.

23. **Migrimi ka patur një ndikim të rëndësishëm në shumë tregues të mirëqënies, megjithëse jo pozitivisht tek të gjitha.** Një krahasim i drejtpërdrejtë midis familjeve me migrantë dhe atyre pa migrantë tregon diferenca të mëdha në konsum dhe në varfëri. Si emigrimet e përkohshëm ashtu dhe ata të përhershëm ndërkombëtarë, kanë një ndikim pozitiv në konsum por ndikimi është më i madh nga emigrimi i përhershëm. Për shembull, një vit shtesë i migrimit të përkohshëm shoqërohet me një rritje prej 5 përqind në konsum. Ndërsa për familjet me migrantë të përhershëm, ai është 50 përqind më i lartë, megjithëse ky është një nivel më i lartë së ç'pritet. Nivelet e vetëraportimit të mirëqënies tregojnë gjithashtu se familjet me migrantë u karakterizuan nga përmirësime pozitive në kohë krahasuar me ato familje pa migrantë të cilat raportuan se nuk kishin ndryshime. Përfundimisht, migrimi tregon se mund të sjellë mobilitet më të madh punësimi.

24. **Rreziku qëndron në faktin së vendi nuk po dëshmon një përmirësim të aftësive profesionale, në sajë të lëvizjeve demografike dhe përbërjes së kualifikimit të emigrantëve të rikthyer.** Vitet mesatare të arsimimit të emigranëve të kthyer kanë pësuar një rënie të dukshme që në

vitin 1995, madje në nivelin arsimor të emigrantëve të rinj vihet re një ulje më e madhe se sa tendenca në ulje e emigrantëve të tjerë. Së dyti, ndërkohë që ka një lidhje të fortë dhe pozitive midis emigrantëve të kthyer dhe pronësisë së biznesit, të dhënat gjithashtu tregojnë së këto biznese janë të tipit të një prodhimtarie të ulët. Kjo tregon se emigrantët ndoshta nuk kanë patur mundësi të përparojnë jashtë shtetit e në këtë mënyrë kanë më pak mundësi që të bëhen katalizatorë të zhvillimit. Natyrisht që kjo mund të jetë e përkohshme. Ajo mund të reflektojë fazat e hershme të një tendence të përgjithshme drejt rikthimeve më të shumta duke përfshirë persona më të kualifikuar dhe sipërmarrës. E treta dhe çka është më shqetësuese është fakti që emigrimi ka një efekt negativ në nivelet e frekuentimit të shkollës nga familjet, veçanërisht për femrat dhe fëmijët në moshën e shkollës së mesme nga zonat rurale.

**Produktiviteti i ulët bujqësor shpjegon pjesërisht prapambetjen në mirëqënien rurale.**

25. **Shumica e fermave familjare prodhojnë vetëm për nevoja familjare.** Së pari raporti midis sasisë së prodhimeve që mblidhen dhe atyre që shiten, është shumë i ulët. Vetëm 28 përqind e fermerëve e shesin prodhimin e tyre në treg dhe mesatarisht vetëm 9 përqind e prodhimt të mbledhur shitet nga vetë fermerët. Së dyti, ka një përdorim shumë të pakët të krahut të punës të marrë me qira në fermat familjare.Të dhënat tregojnë se krahu i punës i marrë me qira është thuajse jo ekzistent për fermat e vogla familjare. Vetëm 8 përqind e të gjitha fermave kanë marrë me qira krahë pune megjithëse kjo shifër rritet në rreth 17 përqind për ata që kanë marrë tokë me qira. Pjesa e punës me qira në koston totale të inputeve është vetëm 3 përqind për të gjitha fermat. Kjo tregon së fshatarët mbështeten në punën familjare ose në punëtorë të papaguar ( si kushërinj ose punë në shkëmbim nga fqinjët.) Më në fund shumica e fermave karakterizohen nga teknologji e ulët. Vetëm rreth një e treta e familjeve raportojnë se zotërojnë ndonjë lloj pajisjeje dhe e shumta 3 përqind e të gjitha familjeve, kane traktor. Megjithatë, megjithëse shumica e fermerëve përdorin pesticide dhe farëra moderne, pjesa e kostos për pesticidet është më e lartë se gjysma e kostos së të gjitha faktorëve të prodhimit të blerë dhe kjo ndoshta nënkupton se çmimi i këtyre artikujve kaq të rëndësishëm mund të jetë relativisht i lartë, veçanërisht për fermerët që do të marrin pjesë në treg ( ata që marrin me qira).

26. **Evidenca empirike tregon se produktiviteti është i ulët sepse shumica e fermerëve përballen me kufizime të shumëanshme.** Në tërësi, eficienca e fermerëve, – çka do të thotë alokimi i faktorëve të prodhimit për përdorimin më produktiv, – është e ulët dhe kjo gjë mund të thuhet për fermerët e të gjitha kategorive të madhësive të tokave. Fshatari i mesëm po operon vetëm në një të tretën e distancës nga potenciali. Ka tre burime kryesore të ineficiencës. Së pari ka shumë familje që nuk kanë akses në tokë të mjaftueshme. Familja mesatare kultivon vetëm 0.8 hektarë dhe një pjesë e madhe e kësaj toke është e ndarë në ngastra më të vogla. Megjithatë, një rritje prej 10 përqind e tokës në dispozicion të fermerit, do të rrisë prodhimin bujqësor me 4.4 përqind. Së dyti shumë fermerë nuk marrin shërbimet e duhura nga institucionet bujqësore për menaxhimin e faktorëve te prodhimit, ujitjen, dhe të drejtat e pronës. Për shembull, të paktë janë ata fermerë që marrin ose ju ofrohen shërbime shtesë me farëra, drithëra, kontroll për insektet, plehra kimike dhe ushqim për bagëtinë, megjithëse të dhënat tregojnë se ata fermerë që kanë marrë konsulencë për cilësinë e tokës dhe mënyrat për ta përmirësuar atë, janë shumë më eficient se sa ata që nuk e kanë marrë një ndihmë të tillë. Së treti, aksesi për kredi brenda komunitetit, duket se pengon rritjen e efiçencës. Të dhënat tregojnë se nëse dikush nga komuniteti do të kishte nevojë për kredi për të filluar një biznes, atëhere vetëm në 35 përqind të komuniteteve, njerëzit, do të kishin mundësi ta merrnin atë nga qeveria apo bankë private. Së fundmi, migrimi masiv jashtë shtetit, shton kufizimet duke ulur ndihmën që mund të jepet në aspekte të rëndësishme si në krah pune apo edhe në përpjekjet e pjesës tjetër të familjes që mbetet, për shkak të marrjes së remitancave dhe investimit të tërësishëm në bujqësi.

**Përpjekjet për të ndihmuar të varfërit nëpërmjet NE kanë patur pak sukses.**

27. **Targetimi i performancës u përmirësua paksa për shkak të përmirësimeve më të shpejta drejt mbulimit të të varfërve me ndihmë ekonomike, krahasuar me një përkeqësim të humbjeve në**

**drejtim të këtij ndihme.** Në vitin 2005, programi i NE, iu ofrua 1 në tre familjeve të varfëra duke dëshmuar kështu një përmirësim në krahasim me vitin 2002, kur programi i ofrohej vetëm 1 familjeje në 4. Një pjesë e madhe e këtij përmirësimi i dedikohet një ekspansioni relativisht më të shpejtë të mbulimit me ndihmë të të varfërve në zonat rurale krahasuar me zonat urbane dhe në zonat Qendrore krahasuar me zonat Bregdetare dhe Malore. Megjithatë, një pjesë më e madhe e familjeve në zonat më të varfëra Malore është përfshirë në program. Një vlerësim i burimeve të targetimit të performancës tregon se një pjesë e madhe e kësaj arritjeje u dedikohet përpjekjeve të nëpunësve lokalë për të ndihmuar të varfërit e zonës së tyre, me përjashtim të zonave rurale ku nga ana e organeve qëndrore dhe atyre lokale bëhen të njëjtat përpjekje.

28. **Programi duket se bën një përzgjedhje të mirë në bazë të udhëzimeve administrative**. Megjithatë, aftësia parashikuese e ndyshoreve (kritereve) të përdorura për të përcaktuar statusin e varfërisë së një familjeje, është e ulët. Vetëm 29 përqind e të varfërve mund të parashikohen si të varfër në bazë të këtyre ndryshoreve “udhëzuese”. Së shumti, vetëm 34 përqind e të varfërve mund të parashikohen si të varfër mbi bazën e këtyre ndryshoreve përzgjedhëse dhe kjo ndodh në zonën Malore. Krahasimisht një model tjetër që ndërtohet mbi tregues lehtësisht të verifikueshëm dhe të vështirë për t’u manipuluar, sikurse aksesi për ujin e çezmës, banjë moderne, ose mjete të tjera si makinë, antenë sateliti, sobë me gaz etj, e rrit parashikimin deri në një nivel prej 12 pikë përqindjeje. Ndërkohë që proporcioni i të varfërve të parashikuar si të tillë në bazë të ndryshorve të sipërpërmendura, përbën ende vetëm 41 përqind të varfërisë në tërësi, ky model parashikon afërsisht deri në 50 përqind të të varfërve me korrektësi dhe ky është një përmirësim i konsiderueshëm në raport me ndryshoret e udhëzimeve.

**Sfida dhe mundësi për të ruajtur uljen e varfërisë**

29. **Në 15 vitet e fundit, Shqipëria ka ndërmarë reforma të rëndësishme strukturore, ka konsoliduar arritjet e saj nga tranzicioni dhe ka arritur një rritje të lartë dhe të qëndrueshme ekonomike**. Si rezultat, transformimi i strukturuar i ekonomisë ka qenë i ndjeshëm. Sikurse u theksua edhe më lart janë arritur mjaft rezultate në lidhje me përmirësimin e standarteve të jetesës. Niveli i varfërisë është ulur në të gjithë vendin dhe pabarazia është rritur vetëm pak. Megjithatë, realiteti sugjeron gjithashtu se përfitimet e mbarëpërhapura nuk janë ndarë në mënyrë të barabartë çka duket qartë në rritjen e hendekut midis zonave rurale dhe urbane. Raporti sqaron se hendeku në rritje në kushtet e jetesës midis zonave urbane dhe rurale krijohet pjesërisht nga prodhimtaria e ulët e fermave të vogla familjare. Shkak për këtë produktivitet të ulët konsiderohen pengesat e shumta për të patur mjetet e nevojshme, infrastruktura e pamjaftueshme e tregut, teknologjia e ulët dhe shërbimi i pamjaftueshëm institucional, të gjitha këto të përkeqësuara nga migrimi masiv jashtë shtetit, ku edhe vetë migrimi është përgjegjës për produktivitetin e ulët në zonat rurale.

30. **Objektivi i këtij raporti ka qenë të paraqesë lidhjet midis stanjacionit rural, migrimit të gjerë dhe rritjes urbane si një prej treguesve përcaktues për Shqipërinë në ndryshim**. Për rrjedhojë, ndërsa vendi e hedh vështrimin përpara, ai do të përballet me dy sfida. E para është konsolidimi dhe ruajtja e rrugës për një rritje te lartë ekonomike dhe tjetra që është e lidhur me sfidën e parë, është ngushtimi i diferencës së madhe në të ardhurat e mirëqënies midis zonave urbane dhe rurale.

31. **Së pari është thelbësore të ruhen ritmet e rritjes.** Në qendër të uljes aktuale të varfërisë ka qenë rritja e ndjeshme ekonomike e cila ka qenë e qëndrueshme në periudha të gjata kohore. Ruajtja e një rritjeje të tillë ekonomike do të mbetet vendimtare. Në të ardhmen sikurse edhe në të kaluarën, kjo do të kërkojë angazhim në politika të shëndosha makroekonomike. Përveç kësaj, do të nevojitet edhe kapërcimi i disa pengesave mikro-ekonomike që i dalin përpara rritjes ekonomike sikurse janë a) investimet e pakta në infrastrukturë, b) reformimi i shërbimeve (utiliteteve) publike, kryesisht energjia elektrike, me qëllim transferimin eficient të përfitimeve tek firmat dhe familjet, c) heqja e pengesave anti-konkuruese

nëpërmjet ndërmarrjes së reformave të ndershme në taksa dhe forcimit të institucioneve rregullatore për të ndaluar kapjen e shtetit.

32. **Së dyti, me qëllim që të përmirësohen të ardhurat rurale dhe kësisoj standartet e jetesës, nevojitet të zgjerohen veprimtaritë rurale jo-bujqësore, përveç rritjes së produktivitetit bujqësore të fermerëve të vegjël.** Aktualisht, zonat rurale po pësojnë një transformim radikal. Shumë individë dhe familje veçanërisht në zonat rurale janë shpërngulur brenda vendit ose jashtë tij për të shpëtuar nga perspektiva e të ardhurave të pakta në këto zona. Ndaj, lehtësimi e madje ndoshta përshpejtimi i migrimit rural drejt zonave urbane, do të ishte një zgjidhje e mirë drejt uljes së varfërisë. Një srategji e tillë do ta përqëndronte vëmendjen drejt zhvillimit dhe modernizimit të infrastrukturës urbane dhe shërbimeve. Në fakt, zgjidhja për rritjen e përshpejtuar rurale, është rritja (zhvillimi) urbane. Largimi i një pjese të madhe të popullatës rurale nga këto zona, krijon mundësi për rritjen e madhësisë së tokës, e lehtëson më shumë konsolidimin e saj dhe rrit produktivitetin rural veçanërisht në rastet kur ata që largohen janë ata më të pasuksesshmit në bujqësi. Për më tepër, niveli mbresëlënës i uljes së varfërisë u arrit pjesërisht edhe nga rritja e ndjeshme në të ardhurat rurale jo-bujqësore. Kjo do të thotë se rritja e mundësive për veprimtari rurale jo bujqësore, veçanërisht në agro-përpunim, do të duhet të shërbejë si pjesë e rëndësishme e strategjisë. Megjithatë, edhe sikur një strategji e tillë të funksiononte në mënyrë të përsosur, nuk do të ishte e mundur që të gjitha përfitimet e mundshme nga kjo strategji, të eleminonin plotësisht të gjitha problemet rurale. Fermerët që mbeten ende do të kenë nevojë për mbështetje me qëllim që të ruajnë produktivitetin dhe të ardhurat e tyre. Raporti identifikoi tre pengesa kryesore për të përmirësuar produktivitetin e fermave familjare: tokë e pamjaftueshme, mungesë aksesi për kredi dhe institucione jo-kompetente (te pamjaftueshme). Ndaj, arritja e progresit në këto zona mund të krijojë themelet për një rritje të ekonomisë rurale në të ardhmen. Në veçanti, lehtësimi i aksesit për tokën për fermerët prodhues do të ishte mjaft i rëndësishëm, çka do t'i bënte tregjet e tokës më aktivë nëpërmjet vendosjes së të drejtave të sigurta për tokën. Zgjerimi i rrjetit të vaditjes dhe ofrimi i shërbimeve shtesë mund të sjellë arritje të tjera në produktivitet, sidomos nëse shoqërohet me kontrollin e cilësisë së inputeve, me promovimin e kultivimit organik, drithërave me vlerë të lartë dhe aktivitete që përmirësojnë vlerën e shtuar pas mbjelljeve.

33. **Së treti, të përmirësohet targetimi i performancës së NE.** Si pjesë e PBB ose e shpenzimeve për mbrojtjen sociale, NE është një program i vogël. Megjithatë, duke qenë instrumenti kryesor për mbështetje direkte të të ardhurave, që mbulon 15 përqind të familjeve, potenciali i saj si një program anti-varfëri ose përdoret pak ose nënvleftësohet. Për shembull aktualisht, Shqipëria po ndërmerr reforma në vendosjen e çmimeve për ujin, energjinë elektrike, dhe sektorët shëndetësorë të cilat potencialisht mund të kenë një ndikim negativ në mirëqënien e të varfërve. Por nëse NE do të shkonte tek të gjithë ose tek shumica e të varfërve, ajo mund të shërbente si një instrument për të zbutur efektin potencialisht negativ të këtyre reformave për të varfërit. Për fat të keq, NE mbulon vetëm një pjesë të vogël të të varfërve dhe udhëzimet e përdorura për të seleksionuar familjet kanë korrelacion të ulët (lidhje të dobëta) me statusin e varfërisë. Për pasojë, një tipar tërheqës për projektin e programit është natyra e tij decentralizuese. Ndaj për të përmirësuar targetimin e performancës të NE, si edhe për të përdorur gjerësisht potencialin e saj, nevojiten tre përmirësime: a) përmirësimi i përpjekjeve të pushtetit qëndror për të shpërndarë fonde në komuna duke marrë në konsideratë një formulë që merr parasysh statusin e varfërisë të një komune sikurse është harta e varfërisë b) selksionimi në bazë të një liste të shkurtër të ndryshoreve (kritereve) që mund të vëzhgohen lehtësisht, që është e vështirë t'i fshehësh dhe që mund të kenë një korrelacion të lartë me varfërinë. Kjo do të thjeshtojë gjithashtu aplikimin dhe procesin e verifikimit të informacionit dhe c) të vazhdojë të përdorë informacionin lokal dhe maturi.

**Konkluzion**

34. **Vetëm në tre vitet e fundit, 2002 dhe 2005, thuajse 235,000 njerëz janë nxjerrë nga varfëria në Shqipëri**. Rritja e madhe ekonomike dhe fluksi i madh i remitancave, janë në qendër të kësaj arritjeje mbresëlënëse. Megjithatë, produktiviteti i ulët i fermave predominuese të vogla familjare, ka ngadalësuar prospektet e rritjes rurale. Për më tepër, programi NE, programi i testuar i ndihmëes në të ardhura, është i vogël në përmasa dhe ka një mbulim të vogël, kështu që ndikimi i tij në uljen e varfërisë ka qenë modest. Si rezultat i këtyre zhvillimeve, të varfërit janë kryesisht rezidentë të zonave rurale me kualifikim të ulët (të matur sipas viteve të shkollës së kryer ) dhe familje të mëdha. Konkluzioni kryesor i këtij raporti është se në të ardhmen Shqipëria ka përpara sfidat e konsolidimit dhe ruajtjes së përmirësimeve në kushtet e jetesës si edhe të ngushtimit të diferencës në rritje midis zonave rurale dhe urbane. Për të përballuar këto sfida, Shqipëria duhet të ruajë ritmet e larta të rritjes, të rrisë produktivitetin rural dhe të përmirësojë targetimin e performancës të programit të saj të NE.

# *KREU 1:* ZHVILLIMI, VARFËRIA DHE PABARAZIA

*Në 15 vitet e fundit rritja ekonomike e Shqipërisë ka arritur një mesatare prej gati 7 përqind në vit, me përjashtim të vitit 1997 kur pati një ndërprerje të papritur si rezultat i humbjes së kursimeve në skemat piramidale. Rritja e lartë dhe e qëndrueshme ka çuar në përmirësime të mëdha të mirëqënies. Pjesa e popullatës nën vijën e varfërisë ka rënë nga 25.4 përqind në 18.5 përqind. Kjo u shoqërua edhe me një konvergjencë midis rajoneve dhe përmirësime në akses ndaj shërbimeve bazë. Megjithatë, pati një rritje të diferencave në varfëri midis zonave rurale dhe urbane, në vlera absolute dhe relative kësisoj të varfërit tani janë më të përqëndruar në zonat rurale.*

## A. EKSPERIENCA E RRITJES EKONOMIKE

1.1 **Rritja ekonomike e Shqipërisë që prej fillimit të tranzicionit ka qenë mbresëlënëse. Ndryshe prej disa vendeve të ish Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të Evropës qendrore dhe lindore që filluan liberalizimin e ekonomisë që në vitet 1980, Shqipëria nuk ndërmori ndonjë reformë para-tranzicionale para vitit 1991.** Gjatë viteve 1991-1992, ekonomia pësoi një rënie të theksuar në prodhim shoqëruar me nivele të larta papunësie dhe inflacioni. Situata e përkeqësuar ekonomike çoi drejt një migrimi masiv të forcës së punës jashtë vendit, veçanërisht në Itali dhe në Greqi. Që prej fillimit të programit të Stabilizimit në vitin 1992, prodhimi u rrit me hapa të shpejtë deri në vitin 1997, kur pësoi një frenim të papritur nga rënia e skemave piramidale. Por prodhimi e mori veten shpejt dhe arriti norma të larta pozitive rritjeje, falë politikave të stabilizimit ekonomik dhe një periudhe stabiliteti politik. Ndërmjet viteve 1998 dhe 2006 PBB reale ka kapur një mesatare afërsisht prej 7% në vit. Ecuria e inflacionit ka qenë gjithashtu mbresëlënëse, me një devijim të vogël nga objektivi prej 3 përqind i bankës qëndrore për më shumë së 8 vjet që nga data e sotme. (Figura 1.1). Rritja relativisht e lartë dhe e qëndrueshme ka çuar në një GNI për frymë afërsisht prej US$3,000 në vitin 2006 duke e kaluar Shqipërinë në grupin e vendeve me të ardhura mesatare.

**Figura 1.1: Rritja e PBB reale, 1992-2006 (%)**




*Burimi*: Ministria e Financave (MF), Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN).

1.2 **Kërkesa e fortë e brendshme e mbështetur nga përmirësimet e produktivitetit total të faktorëve të prodhimit si edhe nga remitancat, ka siguruar norma të larta rritjeje gjatë periudhës së tranzicionit.** Që me fillimin e tranzicionit, rritja ekonomike e Shqipërisë ka ardhur kryesisht si rrjedhojë e përmirësimeve në rishpërndarjen e burimeve nga sektorët, firmat dhe veprimtaritë me produktivitet të ulët, tek ato me produktivitet të lartë. Si rezultat, produktiviteti total i faktorëve të prodhimit, (TFP), shpjegon pothuajse gjithë rritjen e periudhës 1993-2003, pra 6.1 përqind të mesatares vjetore të rrritjes së PBB prej 6.3 përqind. Ndërkohë, kontributi i mobilizimit të faktorëve dhe akumulimi si i punës edhe ai i kapitalit, kanë vetëm një rritje modeste dhe përballen me kufizime. Normat e investimeve u rritën pas krizës financiare të vitit 1997, por pas vitit 1999, kanë pësuar ulje dhe stanjacion. Kjo pasqyron pjesërisht investimet e huaja direkte të pakta, të cilat në 3.7 përqind të PBB, janë të ulta krahasuar me vende të tjera në tranzicion dhe me ekonomi me rritje të lartë. Duke patur një konsum

vazhdimisht të lartë, kursimet vendase kanë pësuar një rënie pas vitit 2001. Si migrimi i punëtorëve të rinj edhe norma e ulët e kursimeve, do të vazhdojnë të kufizojnë rritjen e faktorëve të prodhimit dhe të konfirmojne nevojën për të gjetur burime të reja për rritjen e TFP.

1.3 **Ritmet fillestare të shpejta tëi rritjes ekonomike , u vunë re kryesisht ndër ata sektorë të ekonomisë ku liberalizimi i tregut eci shpejt si në bujqësi dhe në shërbime.** Më vonë, ndërtimi u shfaq si një ndër sektorët kyç për të ruajtur rritjen, duke kompensuar ngadalësimin në bujqësi si edhe luhatjet në industri. Pas një rënieje fillestare në fillim të viteve 1990, bujqësia e Shqipërisë pati një ekspansion të madh në kohë, i cili u mbështet nga ndryshmi i nxitjeve, (kalimi nga ferma kolektive në ferma private), i larmishmërisë, veçanërisht në blegtori dhe në perime si edhe zhvillimin e agro-përpunimit. Megjithatë, ndërkohë që filloi transformimi strukturor i ekonomisë dhe kufizimet e mbetura në bujqësi—si madhësia e vogël e ngastrave të tokës, përdorimi i kufizuar i mjeteve moderne, infrastruktura e varfër, aksesi i pakët drejt tregut, kapaciteti i dobët përpunues, si edhe mungesa e tregut të mirfilltë të tokës,- çuan drejt një ngadalësimi në zhvillimin bujqësor prej rreth 3 përqind në vit. Ngadalësimi në zhvillimin bujqësor si edhe hovi në prodhim në sektorë të tjerë, e ngushtoi pjesën e PBB në 21 përqind nga niveli i saj i lartë prej 35 përqind në vitin 1995 (Figura 1.3), Gjithsesi, ajo ende mbetet burimi kryesor i të ardhrave për rreth 40 përqind të popullatës. Në dhjetë vitet e fundit, kontribuesit kryesorë në zhvillimin e Shqipërisë, kanë qenë sektorët e "jo të tregtueshëm", sikurse ndërtimi dhe shërbimet. Së bashku ato tani përbëjnë dy të tretat e PBB.

**Figura 1.2: Rritja ekonomike sipas sektorëve, 1993-2005 (%)**




*Burimi*: ËDI dhe Database live e Shqipërisë.

**Figura 1.3: Përbërja e PBB 1993-2005 (%)**




*Burimi:* ËDI dhe Database live e Shqipërisë.

1.4 Një pjesë e rëndësishme e kësaj performance ekonomike është mbështetur nga konsolidimi i qëndrueshëm fiskal dhe stabiliteti makroekonomik. Pozicioni fiskal ka ardhur duke u përmirësuar në sajë të përshtatjeve fiskale të bëra në vitet e fundit. Defiçiti buxhetor (duke përfshirë grantet) u pakësua nga 13 përqind e PBB në vitin 1997 në 3.2 përqind në vitin 2006, ndërsa defiçiti primar ra nga 8 në 0.5 përqind të PBB gjatë së njëjtës periudhe. Po kështu ka patur edhe një shtrëngim të politikës fiskale, pjesërisht si rezultat i tejkalimit të performancës së të ardhurave dhe pjesërisht si rezultat i realizimit të dobët të projekteve të investimeve kapitale.

1.5 Vazhdimi i reformave për të rritur efikasitetin e administratës tatimore, i kombinuar me përpjekje të mëdha në drejtim të uljes së nivelit të ekonomisë informale, e cila konsiderohet si një nga më të lartat në rajon, pritet që të rrisë më tej të ardhurat tatimore. Kërkesa më të pakta për huamarrje nga sektori publik që rezultojnë nga konsolidimi fiskal, ruajtën prirjen rënëse të normave të interesit. Inflacioni,

megjithëse pak më i lartë aty nga fundi i vitit 2006, krahasuar me një vit më parë, qëndroi brenda objektivit prej 2-4 përqind të Bankës së Shqipërisë (Figura 1.4). Përpjekjet e konsoliduara kanë ulur gjithashtu raportet borxh/PBB dhe kanë krijuar një rreth virtuoz në rrugën drejt qëndrueshmërisë së financës publike. Por borxhi i cili është kryesisht i brendshëm, ka një profil të shkurtër maturie dhe një bazë të ngushtë investitorësh, duke krijuar rreziqe të mbartura dhe duke rritur ngurtësinë e shpenzimeve.

1.6 **Normat e rritjes së qëndrueshme ekonomike kanë çuar drejt hapjes vendeve të punës në një masë modeste.** Norma e papunësisë duke përdorur përcaktimin standart ILO, ra nga 10 përqind në rreth 7 përqind në vitin 2005. Një përcaktim tjetër i papunësisë i cili përfshin punëtorët e dekurajuar, tregon gjithashtu një model të ngjashëm të uljes, megjithëse norma fillestare e papunësisë vlerësohet të jetë më e lartë me këtë metodë. (Tabela 1.1, rreshti 3). Një pjesë e uljes së papunësisë ka ndodhur si rezultat i uljes së kërkesës aktive për një punë, sikurse tregohet edhe nga një numër i madh i njerëzve në moshë pune, jo aktivë, veçanërisht shtëpiaket, si edhe nga norma relativisht e ulët e punësimit të individëve në moshë pune. Përveç kësaj, një rritje në frekuentimin e shkollave, veçanërisht në atë të shkollave të mesme, mundësisht në zonat rurale, flet pjesërisht për një nivel në rënie të pjesëmarrjes në forcën e punës. Por pavarësisht nga këto prirje, të dhënat tregojnë qartë se midis viteve 2002 dhe 2005, ka një rritje të vogël në punësim në zonat urbane dhe midis popullatës së rritur. (Tabela 1.1 dhe Figura A.3).

**Figura 1.4*:* Inflacioni, Mesatarja Vjetore, 1992-2006 (%) (1999-2006, shkallëzuar në boshtin e djathtë)**




*Burimi:*: INSTAT.

**Figura A. 3: Niveli i punësimit sipas grup-moshave; 2002, 2005**

**Tabela 1.1: Treguesit Kryesorë të Tregut të Punës, 2002-2004**

| | 2002 | | | 2005 | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Urban** | **Rural** | **Total** | **Urban** | **Rural** | **Total** |
| Norma e pjesëmarrjes e forcës së punës (relaksuar) | 62.0 | 77.2 | 70.6 | 60.0 | 69.6 | 65.3 |
| Norma e pjesëmarrjes e forcës së punës (standard) | 55.1 | 74.2 | 65.9 | 54.1 | 67.1 | 61.2 |
| Norma e papunësisë (relaksuar) | 31.1 | 7.3 | 16.4 | 21.8 | 6.0 | 12.6 |
| Norma e papunësisë (standard) | 22.5 | 3.4 | 10.3 | 13.3 | 2.4 | 6.8 |
| Norma e punësimit | 42.7 | 71.6 | 59.1 | 46.9 | 65.4 | 57.0 |

*Shënim*: Llogaritjet për popullatën në moshën 15-64 vjeç. Gjithashtu shih Banka Botërore, 2005.

1.7 **Por nuk janë krijuar mjaft vende pune veçanërisht në sektorin formal.** Vetëm 15 përqind e të papunëve në vitin 2002, u punësuan në sektorin formal nga viti 2004. Vetëm 10 përqind e atyre që ishin jashtë forcave të punës në vitin 2002 bënë të njëjtin kalim. Në të kundërt, 38 përqind e të papunëve gjetën

punë në sektorin informal të punës. (Banka Botërore, 2005). Nivelet në rritje të migrimit të jashtëm sjellin prova të forta të krijimit të pamjaftueshëm të vendeve të punës. Fluksi i migrantëve të përhershëm dhe të përkohshëm drejt vendeve fqinjë në Itali dhe Greqi u rrit ndjeshëm gjatë gjithë viteve 1990 (Figura 1.5); Carletto et al., 2004 dhe 2005). Rreth 90 përqind e migrantëve u larguan në kërkim të punësimit. Megjithatë, sikurse tregon edhe Figura 1.5, ka një ngadalësim të fluksit të migrimit pas viteve 1998, kur ekonomia e mori veten nga shkatërrimet që pësoi nga skemat piramidale.

**Figura 1.5: Flukse të Migrimit të Jashtëm të Përkohshëm dhe të Përhershëm, 1990-2001**




*Burimi*: Carletto et al (2005).

1.8 Ndërkohë që kostua e ulët e krahut të punës mund të ketë qenë një tipar tërheqës për ekonominë shqiptare, po shtohet presioni për rritjen e rrogave, sikurse tregohet nga rritja e të ardhurave. Shqipëria ende ka disa nga rrogat më të ulta në rajon, pavarësisht nga rritja e tyre e madhe pas vitit 1997 (Tabela 1.2). Megjithatë, opinione alternative tregojnë se raportimet për rrogat reale në sektorin privat nuk janë të vërteta dhe rrogat aktuale nuk janë aq konkuruese sa ç'duken.

**Tabela 1.2: Rroga Vjetore Bruto ose Pagat për Kategori të Ndryshme Pune, sipas Vendeve (në US$)**

| | Menaxhimi | Profesional | Teknik | Punë e kualifikuar | Punë e pakualifikuar |
|---|---|---|---|---|---|
| Shqipëria | 13,538 | 8,123 | 6,497 | 3,569 | 2,215 |
| Bosnja & Hercegovina | 22,521 | 14,250 | 12,600 | 7,667 | 5,467 |
| Kroacia | 35,383 | 22,317 | 12,600 | 11,408 | 7,714 |
| Maqedonia | 26,251 | 14,214 | 6,445 | 5,701 | 4,079 |
| Serbia & Mali i Zi | NA | 10,649 | 3,878 | 5,715 | 4,293 |
| Rep.Çeke | 21,193 | NA | 6,031 | 9,389 | 6,583 |
| Hungaria | 37,170 | NA | 16,862 | 8,744 | 7,618 |
| Sllovakia | 21,189 | NA | 10,797 | 5,152 | 3,699 |

*Burimi*: Horizonte Investuese: Ballkani Perëndimor; MIGA, Banka Botërore 2006.

## B. VARFËRIA DHE PRIRJET E PABARAZISË

1.9 **Normat e larta të rritjes së PBB kanë qenë të shoqëruara nga një ulje masive e varfërisë.** Pjesa e popullatës konsumi mujor real për frymë i së cilës është nën nivelin 4891 lek (çmimet e vitit 2002), ra nga 25.4 përqind në vitin 2002 deri në 18.5 përqind në vitin 2005. Kjo do të thotë se afërsisht 235,000 ndër 800,000 të varfër në vitin 2002, u nxorrën nga varfëria. Popullsia në varfëri ekstreme që konsiderohet ajo pjesë e popullsisë që ka vështirësi për të përballuar nevojat jetike ushqimore, ra nga rreth 5 përqind në 3.5 përqind. Në zonat urbane, vetëm 2.7 përqind e popullatës mund të konsiderohet ekstremisht e varfër. (shih Figura 1.6 dhe (Figura 1.7).

**Figura 1.6: Të varfërit Ekstremë dhe Absolutë**




**Figura 1.7: Norma e Varfërisë sipas Zonës**




*Burimi*: Vlerësimet e Stafit të Bankës Botërore nga të dhënat në bazë të sondazheve.

1.10 **Gjithashtu u reduktuan ndjeshëm edhe tregues të tjerë të varfërisë.** Dy tregues alternative për të matur varfërinë janë hendeku i varfërisë dhe ashpërsia e varfërisë. Hendeku i varfërisë (ndonjëherë referuar edhe si thellësia e varfërisë) llogaritet duke pjestuar shumën e hendeqeve në konsumin e të varfërve ( d.m.th., vija e varfërisë minus konsumin) për të gjithë të varfërit sipas popullatës në tërësi dhe duke e shprehur atë në përqindje të vijës së varfërisë. Kësisoj një hendek varfërie me 5 përqind do të thotë se sasia totale e të varfërve që janë poshtë vijës së varfërisë, është e barabartë me popullatën shumëzuar me 5 përqind të vijës së varfërisë. Avantazhi kryesor i hendekut të varfërisë është se sa më i varfër të jetë individi, aq më i madh është kontributi i tij në varfërinë në tërësi. Treguesi i dytë alternative në këtë llogaritje është ashpërsia e varfërisë, avantazhi kryesor i së cilës është së ajo është e ndjeshme ndaj pabarazisë midis të varfërve. Tabela A 8 tregon së hendeku i varfërisë ra nga 5.7 përqind në vitin 2002 deri në 4 përqind në vitin 2005, ndërsa ashpërsia e varfërisë ra nga 2 përqind në 1.3 përqind në të njëjtën periudhë.

1.11 **Ulja masive e varfërisë është shoqëruar nga konvergjenca të rëndësishme rajonale.** Diferencat në normat e varfërisë në të gjitha zonat e ndara gjerësisht [2] janë ulur ndjeshëm në krahasim me ato të vitit 2002. Për shembull, zonat Malore ku normat e varfërisë ishin mjaft të larta në vitin 2002, e kanë ngushtuar diferencën e tyre me zonat e Bregdetare, Qëndrore dhe të Tiranës. Në mënyrë më

[2] Është e rëndësishme të kihet parasysh së këto rajone të përcaktuara gjerësisht nuk janë të njëjta me qarqet administrative të cilat quhen zakonisht Prefektura. Përkundrazi këto janë zona të grupuara së bashku sepse ato kanë njëjtat tipare gjeografike (vazhdimësi) dhe mbulim. Kësisoj, për qëllime studimi kemi bërë ndarje në katër zona të tilla ndërkohë që Shqipëria ka 12 prefektura.

specifike, ndërkohë që norma e varfërisë rurale në rajonet Malore ishte 67 përqind më e lartë se sa norma rurale kombëtare, tani ajo është vetëm 14 pëqind më e lartë. (Figura 1.8 dhe Tabela A.8). Po kështu, normat e varfërisë rurale përgjatë rajoneve kanë më pak diferenca me njera tjetrën në vitin 2005 krahasuar me vitin 2002. Në fakt, normat e varfërisë rurale për çdo rajon në vitin 2005 janë brenda nivelit vetëm 4 pikë përqindje më të larta ose më të ulta se sa norma rurale kombëtare e varfërisë krahasuar me vitin 2002 kur kishte një shtrirje më të madhe (p.sh.ato varionin nga 20 pikë përqindjeje e nivelit më të lartë deri në 8 pikë përqindjeje, niveli më i ulët.) Një ulje e ndjeshme e varfërisë në zonat Malore e kombinuar me një ulje relativisht të vogël të varfërisë në pjesët rurale të Bregdetit dhe të zonave Qëndrore, është një nga shtysat kryesore të këtij fenomeni konvergjence.

**Figura 1.8: Norma e varfërisë sipas shtresës**




*Sourçe:* Ëorld Bank staff çalçulations from survey data.

1.12 **Ndjeshmëria ndaj varfërisë sikurse edhe varfëria vetë, po vjen duke u ulur.** Ndjeshmëria, është efekti neto i krizave,(tronditje) pronave familjare dhe rrjeteve që përballojnë këto vështirësi. Masa të rrepta ndaj kësaj ndjeshmërie kërkojnë vëzhgimin e ndryshimeve në këto ndryshore në kohë. Edhe kur nuk konstatojmë kriza, ne mund të llogarisim numrin e të varfërve në një situatë ku kriza pakëson të ardhurat, në një përqindje specifike. Poshtë tregon proporcionin e popullsisë që mund të bëhet e varfër në rast se një krizë do t'i pakësonte të ardhurat në masën 50 përqind. Nga ana tjetër shifrat tregojnë se cila pjesë e popullsisë do të bjerë nën vijën e varfërisë nëse kjo do të rritej me 50 përqind (nga 4891lek në 7337 lek). Një situatë e tillë do të thotë një rritje në varfërinë absolute nga 18.5 përqind në 45 përqind në vitin 2005. Me vijën relative të varfërisë, ndjeshmëria do të ishte edhe më e lartë. Një alternativë tjetër do të ishte të shihnim së cila do të ishte madhësia e arsyeshme e rënies së të ardhurave nga një krizë ekonomike me përmasa jo-katastrofike? Për shembull, nëse shumica e njerëzve në një ekonomi janë punëtorë, ata përballen me rrezikun e papunësisë, e cila nëse ndodh mund të ulë rrogat dhe si rrjedhojë edhe të ardhurat në njëfarë proporcioni. Për rrjedhojë mund të krijohet një prag për ndjeshmërinë ndaj varfërisë shkaktuar nga kriza e papunësisë. Në Shqipëri rënia e konsumit nga papunësia e kryefamiljarit, sikurse paraqitet më poshtë (Tabela A.31 – Tabela A.34) varion nga një nivel i lartë prej 22 përqind në zonat urbane, në një nivel të ulët prej 12 përqind në zonat rurale. Duke llogaritur një ulje mesatare prej 15 përqind, ne vërejmë se 8 përqind e popullatës janë të ndjeshëm ndaj varfërisë (varfëria rritet nga 18.5përqind në 26.7 përqind). Çka është më e rëndësishme, Figure 1.9 tregon së ndjeshmëria ka rënë midis viteve 2002 dhe 2005, sipas çfarëdo vije varfërie të përdorur, çka sugjeron një avantazh tjetër nga rritja ekonomike.

**Figura 1.9: Ndjeshmëria ndaj Varfërisë**




1.13 Rritja në konsumin real për frymë ishte e lartë dhe pozitive për shumicën e popullsisë. Në tërësi, konsumi real për frymë në vitin 2005, ishte shumë më i lartë se në vitin 2002 për pothuajse çdo percentil të popullatës, sikurse tregohet edhe nga normat pozitive të rritjes në të gjithë shpërndarjen. (Figura 1.10) shih gjithashtu: Figura A.4 – A.8). Figura paraqet normën e rritjes së konsumit real për frymë në çdo percentil të shpërndarjes. Ajo tregon se mesatarja në vitin 2005, ishte 17 përqind më e lartë se në vitin 2002, ndërsa mediana në vitin 2005, ishte 19 përqind më e lartë se sa mediana e vitit 2002. Rritja e konsumit real për frymë ishte më e lartë për disa percentile se sa për të tjera, kështu që rritja mesatare në percentil (rritja e çdo percentili e marrë në mesataren e të gjithë percentileve), ishte një 15 përqindësh i fortë gjatë kësaj kohe. (Tabela 1.3, rreshti 3). Natyra pro- të varfërve e përvojës së rritjes theksohet edhe më tej nga fakti që konsumi real për frymë i percentilit të 25-të - me një fjalë të gjithë ata që janë konsideruar të varfër në vitin 2002, – u rrit pothuajse 11 përqind. (Tabela 1.3, rreshti i fundit).

**Figura 1.10: Kurba e Frekuencës së Rritjes, Kombëtare**




**Tabela 1.3: Përmbledhje e normës së Rritjes në Konsum**

| Pikë në shpërndarje | Normat e rritjes |
|---|---|
| Mesatarja | 16.8 |
| Mediana | 18.7 |
| Percentili mesatar | 14.9 |
| Vija e varfërisë (Lek), sipas çmimeve të vitit 2002 | 4891 |
| Norma korresponduese e percentilit të pro- të varfërve 25 përqind e të varfërve në vitin 2002 | 10.7 |

*Burimi*: Vlerësimet e stafit të Bankës Botërore nga të dhënat e sondazhit.

1.14 Megjithatë, rritja e konsumit real për frymë, nuk është shpërndarë në mënyrë të barabartë. Midis ndarjeve të mëdha agro-ekologjike të vendit, zonat e Bregdetit, tregojnë rritje të barabartë të konsumit përgjatë gjithë shpërndarjes. Thuajse çdo percentil është përllogaritur të ketë një rritje konsumi që është rreth mesatares së llogaritur për Bregdetin. Ndërsa , në zonat Malore, ata që ndodhen në gjysmën më të ulët të shpërndarjes, kanë rritje konsumi real për frymë mjaft më të madhe krahasuar me ata që ndodhen në gjysmën e sipërme të shpërndarjes, të cilët në fakt përfituan më pak se mesatarja për zonën. (Figura 1.11)

**Figura 1.11*:* Kurbat e frekuencës së rritjes, 2002-2005: Sipas Shtresës**




1.15 **Të dhënat tregojnë se rritja ekonomike shpjegon të gjithë uljen e varfërisë**. Ndryshimet në varfëri mund të zbërthehen në komponentë të rritjes, rishpërndarjes dhe komponentëve të tjerë. Për shembull, nëse pabarazia përkeqësohet duke mbajtur të ardhurat mesatare në të njëjtin nivel, numri i të varfërve mund të rritet. Në të kundërtën, nëse pabarazia mbetet e njëjtë por të ardhurat mesatare për çdo percentil rriten, -pra rritja e të ardhurave shpërndahet gjerësisht, -atëhere numri i të varfërve mund të bjerë. Figura 1.12 tregon se deri ne ç'masë ulja e varfërise ka ardhur si rezultat i rritjes ekonomike, rishpërndarjes (pabarazisë) si dhe e komponentëve të tjerë. Shpërbërja parashikon që komponenti i rritjes mund ta kishte ulur numrin e të varfërve (PO) me 9 pikë përqindje (çka do të thotë që numri i të varfërve mund të ishte ulur nga 25.4 përqind në vitin 2002 në 16 përqind në vitin 2005) nëse forma e shpërndarjes së të ardhurave do të kishte mbetur e njëjtë me atë të vitit 2002. Në të kundërtën, nëse të ardhurat mesatare do të ishin të njëjta si në vitin 2002 edhe më 2005, por forma e shpërndarjes do të ndryshonte, numri i të varfërve (headcount) do të ishte rritur me 2 pikë përqindje. Efekti neto është një ulje prej 7 pikë përqindje në pjesën e të varfërve, meqënëse komponenti rezidual luajti vetëm një rol të vogël. Në tërësi, ndryshimet në thellësë dhe ashpërsinë e varfërisë, sugjerojnë gjithashtu së komponenti i rritjes dominon. Sikurse edhe në numrin e të varfërve (headcount), ulja në thellësinë dhe në ashpërsinë e përmasave të varfërisë do të kishte qenë më e lartë në se nuk do të kishte ndryshime në pabarazi e cila kundërbalancon një pjesë të rritjeve në konsum.

**Figura 1.12: Sqarime për Ndryshimet në Varfëri**




| | Total çhange in poverty | Groëth çomponent | Redistribution çomponent | Interaçtion çomponent |
|---|---|---|---|---|
| Çhange in P0 | -6.878 | -9.272 | 2.188 | 0.205 |
| Çhange in P1 | -1.711 | -2.495 | 1.024 | -0.239 |
| Çhange in P2 | -0.584 | -0.917 | 0.487 | -0.154 |

1.16 Ndërkohë që roli i rëndësishëm i rritjes ekonomike në uljen e matur të varfërisë, është i përgjithshëm, rishpërndarja reduktoi thuajse përgjysmë uljen potenciale të varfërisë në zonat Bregdetare dhe në ato Qendrore. Si në Bregdet edhe në pjesët Qendrore të vendit, numri i të varfërve në tërësi (overall headcount poverty) ra me rreth 4 pikë përqindje. Megjithatë, numri i të varfëerve mund të ishte ulur nga 7 deri në 8 pikë përqind respektivisht nëse rritja e pabarazisë që e tejkalonte mesataren, nuk do ta rriste varfërinë me 3 deri në 4 pikë përqindje respektivisht. E kundërta ndodhi në zonat Malore ku kishte një shpërblim të dyfishtë. Rritja e parë e të ardhurave çoi drejt një uljeje të madhe në numrin e të varfërve (headcount) por pabarazia pësoi gjithashtu rënie, për rrjedhojë ulja e varfërise ishte edhe më e madhe se ç'mund të ishte parashikuar vetëm prej rritjes ekonomike. Në Tiranë rritja në pabarazi ishte përafërsisht e njëjtë me mesataren kombëtare, kështu që shifra neto e varfërisë ra me 9.7 pikë përqindjeje, në vend të 11.2. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për zonat e tjera urbane, duke përjashtuar Tiranën. Po të hedhim një vështrim në zonat rurale, do të vërejmë se nuk ka patur pothuajse asnjë ndryshim në formën e shpërndarjes së të ardhurave rurale, kësisoj rënia neto e varfërisë rurale është e përafërt me komponentin e reduktimit të shkaktuar vetëm nga rritja ekonomike. Roli i rëndësishëm i rritjes ekonomike që ka shkaktuar pothuajse të gjithë uljen e numrit të të varfërve (headcount poverty) përsëritet edhe për tregues të tjera të varfërisë sikurse janë thellësia dhe ashpërsia e varfërisë (Tabela A.13 – Tabela A.22).

1.17 Gjatë gjithë periudhës, ndryshimet në pabarazi mbetën modeste. Ekzistojnë mënyra të ndryshme në të cilat ndryshimet e konstatuara në konsum, mund të orientojnë drejt ndryshimeve të konstatuara në pabarazi. Së pari, rritjet në konsumin real për frymë në zonat urbane ishin shumë më të larta se në ato rurale. Së dyti, në përgjithësi dhe veçanërisht në Tiranë dhe në zonat Qëndrore, popullsia në gjysmën e sipërme të shpërndarjes pati një rritje në konsum më të madhe se sa popullsia në gjysmën e poshtme të shpërndarjes. Së treti, dhe si kundërbalancim i këtyre zhvillimeve, ishte edhe rritja e madhe e konsumit për frymë për popullatën në skajin më të ulët të shpërndarjes, krahasuar me atë të skajit më të lartë në zonat Malore. Nisur nga përqëndrimi i popullatës në Tiranë dhe në zonat Qëndrore, krahasuar me ato Malore, një rritje të vogël të pabarazisë do të ishte e pritshme.

1.18 Pabarazia në Shqipëri konsiderohet e ulët dhe disa tregues të pabarazisë tregojnë se ka patur vetëm një rritje të vogël, (Tabela 1.4), kështu që sipas standartit të treguesit më të përdorur, Gini, ai

mbetet i ulët. Koefiçenti Gini u rrit nga 28 përqind në rreth 30 përqind në tërësi gjatë gjithë kohës. Treguesit rastësore (entropy) të Theilit tregojnë gjithashtu rritje të papërfillshme. Hendeku midis atyre që ndodhen në krye të shpërndarjes dhe atyre që ndodhen në fund, i matur me raportin e percentilive të 90-të/10-të, u rrit me më pak se 1 përqind**.** (Tabela 1.4), rreshti i fundit). Pabarazia rurale mbeti e pandryshuar ndërkohë që u vërejt një rritje e vogël në zonat urbane sikurse pritej në bazë të ndryshimeve të raportuara në konsum. Modele të qëndrueshme të pabarazisë janë vërejtur në rajone, me përjashtim të zonave Malore ku ka patur një rënie në pabarazi. (shih gjithashtu edhe Tabela A.23-Tabela A.24).

**Tabela 1.4: Treguesit e Pabarazisë, Kombëtare, Urbane dhe Rurale, LSMS 2002-2005**

| | **Kombëtare** | | **Rurale** | | **Urbane** | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | **2002** | **2005** | **2002** | **2005** | **2002** | **2005** |
| Devijimi mesatar relativ | 20.2 | 21.1 | 19.5 | 19.5 | 20.4 | 21.1 |
| Koefiçenti i variacionit | 55.9 | 62.3 | 53.0 | 53.8 | 56.9 | 63.4 |
| Devijimi standart i logaritmeve | 50.0 | 52.7 | 47.7 | 48.8 | 51.6 | 53.3 |
| Koefiçenti Gini | 28.2 | 29.6 | 27.1 | 27.3 | 28.5 | 29.7 |
| Treguesi Mehran | 38.4 | 40.2 | 37.0 | 37.5 | 39.0 | 40.3 |
| Treguesi Piesch | 23.1 | 24.3 | 22.2 | 22.2 | 23.3 | 24.4 |
| Treguesi Kakëani | 7.1 | 7.9 | 6.6 | 6.7 | 7.4 | 8.0 |
| Treguesi rastësore (entropy)e Theilit | 13.2 | 15.1 | 12.1 | 12.4 | 13.7 | 15.4 |
| Masa mesatare e devijimit të logaritmit të Theilit | 12.9 | 14.4 | 11.8 | 12.1 | 13.4 | 14.7 |
| Raporti i 90të /10të i percentilit (në logaritme) | 1.155 | 1.159 | | | | |

*Burimi*: Vlerësime të Stafit të Bankes Botërore nga të dhënat e sondazhit.

## C. PRIRJET NË TREGUES TË MIRËQËNIES JO TË LIDHUR ME TË ARDHURAT

1.19 Aksesi drejt një numri shërbimesh bazë është përmirësuar midis viteve 2002 dhe 2005. Frekuentimi neto në arsimin primar ka qenë aktualisht i lartë dhe ka mbetur po i tillë. Por përmirësimet më të mëdha janë vënë re në arsimin e mesëm dhe të lartë. Sikurse tregohet në Figurën 1.13 dhe në Figurën 1.14 normat e frekuentimit neto për të gjitha kuintilet e konsumit për frymë u rritën në arsimin e mesëm dhe të lartë. Tendencat pozitive janë vërejtur si për femra edhe për meshkuj (Figura 1.16 dhe Figura 1.18). Krahas kësaj, numri i familjeve me çezmë brenda në shtëpi u rrit nga 49 në 53 pëqind gjatë kësaj kohe, ndërsa proporcioni i familjeve me çezmë jashtë shtëpie mbeti i njëjtë.(shih Figura A.9 dhe Tabela A.25).

**Figura 1.13: Frekuentimi Neto, Arsimi Primar**




**Figura 1.14: Frekuentimi Neto në Arsimin e Mesëm të Përgjithshëm**




**Figura 1.15: Frekuentimi në Arsimin e Lartë**




*Burimi:* Vlerësimet e Stafit të Bankës Botërore duke përdorur të dhëna nga sondazhi.

1.20 **Përjashtim përbëjnë sektori shëndetësor dhe shërbimet energjetike.** Në shëndetësi, si aksesi në objektet e shëndetit parësor (d.m.th. ambulancat publik , mjekët privatë, infermieret etj) edhe numri mesatar i vizitave, nuk shfaqin shenja përmirësimi (Figura 1.15). Lajmi i mirë është se ditët me raport të humbura nga sëmundjet kronike, (paaftësia) kanë rënë e kjo tregon se ndoshta njerëzit janë bërë më të shëndetshëm. Përsa i përket energjisë elektrike, u kërkua prej familjeve që të deklarojnë burimin kryesor të ngrohjes. Tabela A.27 tregon shpërndarjen e përgjigjeve. Duke u përqëndruar në aksesin e dy formave relativisht më të pastra të energjisë, si energjia elektrike dhe gazi, ne vumë re se ka shumë pak ndryshime midis viteve 2002 dhe 2005. Në vitin 2002, rreth 36 përqind e familjeve deklaruan se përdornin energji elektrike ose gaz si burim kryesor ngrohjeje Në vitin 2005, shifra arriti në 37 përqind.

1.21 **Edhe aty ku shërbimet janë përmirësuar, ende ka pabarazi**. Ekzistojnë tre burime pabarazish- të ardhurat, rural/urban dhe gjinia. Në fillojme me të ardhurat. Në arsim ndryshimet kryesore duken në arsimin e mesëm dhe atë të lartë. Për shembull në arsimin e mesëm frekuentimi ështe rreth 50 përqind për kuintilin më të varfër, krahasuar me frekuentimin neto thuajse universal për kuintilin e pasur. Në arsimin e lartë dallimet janë rritur me kalimin e kohës. Norma e frekuentimit për kuintilin më të varfër mbetet nën 10 përqind, ndërsa për atë më të pasur është rritur nga rreth 18 përqind në 46 përqind.(Figura 1.15).

1.22 **Këto diferenca të mëdha shfaqen gjithashtu kur shohim frekuentimin e mesëm dhe atë të lartë veç për djemtë dhe vajzat.** Këto diferenca janë veçanërisht të dukshme për tre kuintilet më të ulta por jo për ato dy më të lartat (Figura 1.17 dhe Figura 1.18). Përsa i takon ujit, vetëm një e treta e familjeve në kuintilin më të varfër, jetonin në shtëpi me çezmë brenda, ndërsa në kuintilin e të pasurve ishin dy të tretat (Tabela A.25). Në lidhje me energjinë elektrike, më shumë se 75 përqind e familjeve në kuintilin më

të varfër, deklarojnë se druri mbetet burimi kryesor i ngrohjes, krahasuar me vetëm 40 përqind të familjeve në kuintilin e më të pasurve.

1.23 **Dallime të mëdha ekzistojnë gjithashtu edhe midis zonave urbane dhe rurale.** Më shumë se 60 përqind e familjeve të varfëra në zonat urbane kane akses në ujin brenda shtëpisë krahasuar me vetëm 40 përqind të familjeve më të pasura në zonat rurale. Në arsim, më tepër se 60 përqind e fëmijëve në pjesën e pestë më të varfër në zonat urbane, frekuentojnë arsimin e mesëm krahasuar me vetëm 40 përqind të fëmijëve më të varfër në zonat rurale.

**Figura 1.16: Frekuentimi Primar, Meshkuj dhe Femra**




**Figura 1.17: Frekuentimi i Mesëm, Meshkuj dhe Femra**




**Figura 1.18: Frekuentimi i Lartë, Meshkuj dhe Femra**




*Burimi:* Vlerësime të Stafit të Bankës Botërore duke përdorur të dhëna nga sondazhi.

1.24 Ka edhe probleme të cilësisë megjithëse janë vërejtur edhe përmirësime. Në veçanti, shumë familje deklarojnë se kanë patur ndërprerje të shpeshta të energjisë dhe cilësi të keqe të ujit. Familjeve ju kërkua që të raportonin veçanërisht frekuencën e ndëprerjeve të energjisë elektrike në zonën e tyre. Në vitin 2005, pothuajse 40 përqind e familjeve në zonat urbane dhe rurale njoftuan se kishin patur ndërprerje ditore të energjisë elektrike. Vetëm më pak se 40 përqind e tyre raportuan se nuk kishin patur ndërprerje të energjisë elektrike. Megjithatë, kjo përbën një përmirësim në krahasim me vitin 2002 kur rreth 50 përqind e familjeve urbane dhe thuajse 80 përqind e të gjitha familjeve rurale, kishin patur ndërprerje ditore Figura 1.19 - Figura 1.21).

**Figura 1.19: Ndërprerje të energjisë – Cdo Ditë**




**Figura 1.20: Ndërprerje të energjisë – Disa herë në javë**




**Figura 1.21: Ndërprerje të energjisë – Disa herë në muaj**




**Figura 1.22: Ndërprerje të energjisë - Asnjëherë**




*Burimi*: Vlerësimet e Stafit të Bakës Botërore nga të dhënat e sondazhit.

1.25 Në lidhje me ujin, kur familjet u pyetën për cilësinë e ujit të pijshëm nga burimi kryesor i furnizimit, nëse ishte i mirë për t'u pirë apo jo, më tepër se 20 përqind nga zona urbane dhe disi më pak nga zona rurale u përgjigjën se nuk ishte i mirë në vitin 2005. Përsëri kjo tregon një përmirësim në krahasim me vitin 2002, kur të paktën 30 përqind e zonave urbane dhe disi më pak se 20 përqind e familjeve rurale e cilësuan burimin kryesor të tyre të ujit si jo të mirë. (Figura 1.23 dhe Figura 1.24).

**Figura 1.23: Cilësia e ujit – E mirë**




**Figura 1.24: Cilësia e ujit – nuk është e mirë**




*Burimi*: Vlerësimet e Stafit të Bakës Botërore nga të dhënat e sondazheve.

## D. PROFILI I VARFËRISE DHE RREZIKU I VARFËRISË

1.26 Njohja e karakteristikave të të varfërve është e rëndësishme sepse ajo mund të informojë politikat. Ne mund të shohim karakteristikat e të varfërve duke shqyrtuar frekuencën e varfërisë- me një fjalë duke parë përqëndrimin gjeografik ose demografik, si edhe profilin arsimor të të varfërve. Nga ana tjetër ose përveç kësaj, ne mund të llogarisim probabilitetin e të qenit të varfër duke u nisur nga disa karakteristika, sikurse janë vendndodhja gjeografike, demografia e familjes dhe profili arsimor. Megjithatë një opsion tjetër mbetet të shohim diferencat në konsum tek familjet të cilat kanë disa karakteristika të vëzhgueshme. Po t'i hedhim një vështrim këtyre diferencave, ato do të na tregojë se, nëse përdoret konsumi për të klasifikuar mirëqënien familjare dhe tek disa familje vërehet se kanë një konsum mjaft të ulët (ato kanë një diferencë të madhe negative), atëhere nënkuptohet se mesatarisht ato mund të klasifikohen në një shkallë më të ulët dhe kanë më shumë premisa për të qenë të varfëra. Në parim, të gjitha këto metoda duhet të çojnë drejt konkluzioneve të njëjta. Ne, së pari, paraqesim frekuencën e varfërisë ose rrezikun e varfërisë dhe pastaj fokusohemi tek modeli i konsumit sepse larmia në konsum në të gjitha familjet është më tepër informuese se sa një model binar (korrelacion të varfërisë duke përdorur një model probabiliteti). Modelet përqëndrohen në diferencat në konsum pas kontrollit për demografinë e familjes (numri i fëmijëve dhe gjinia e kryefamiljarit), kapitali njerëzor, (niveli arsimor i kryefamiljarit), statusi i tregut të punës, izolimi, traumat shëndetësore, dhe për zonat rurale sipërfaqja e tokës në dispozicion për kultivim. Lista e kontrolleve si edhe modelet e vlerësuara janë në Tabelën A.31-Tabelën A.34. Por, së pari ne bëjmë një permbledhje mbi profilin e të varfërve.

1.27 Familjet e mëdha kanë një frekuencë shumë më të lartë të varfërisë. Familja tipike shqiptare përbëhet prej rreth 4 deri në 5 persona. Së bashku, familjet me 4 dhe 5 anëtarë, përbëjnë thuajse 48 përqind të popullatës. Krahasimisht familjet me 8 ose me më shumë anëtarë përbëjnë rreth 8 përqind të popullatës. Megjithatë, 21 dhe 17 përqind e të gjithë të vafërve, respektivisht në vitin 2002 dhe 2005 jetonin në familje të tilla. Frekuenca e varfërisë për familjet me më shumë se 8 anëtarë, ishte rreth 50 përqind në vitin 2002 dhe ndërkohë që ajo ka rënë në vitin 2005, rreziku mbetet më i lartë krahasuar me familjet më të vogla. (Figura 1.25).

**Figura 1.25: Frekuenca e Varfërisë sipas Madhësisë së Familjes**




**Figura 1.26: Frekuenca e varfërisë sipas Gjinisë së Kryefamiljarit**



1.28 Ekziston një mundësi që rreziku më i lartë i varfërisë për familjet e mëdha të jetë ekzagjeruar, sepse ai nuk llogarit ekonomitë e shkallës. Ideja këtu është se meqenëse shumë mallra konsumi si ushqimet, mjetet dhe strehimi janë të përbashkëta, vlerësimet që nuk e llogarisin këtë përdorim të përbashkët, janë të njëanshme ndaj rezultateve të nxjerra për familjet e mëdha të cilat kanë përfitimin më të madh nga përdorimi i përbashkët i shtëpisë dhe ushqimeve. Me qëllim që të eksplorohet prezenca potenciale e ekonomive të shkallës, shohim kërkesën për ushqim. Duke ndjekur modelin e Gibsonit (2002), ne vlerësojmë marrëdhënien midis ndarjes së ushqimit dhe madhësisë së familjes, duke kontrolluar strukturën demografike të familjes si edhe konsumin total për frymë. Rezultatet e vlerësimit janë tek: (Tabela A.30).

1.29 Rezultati për të cilin jemi të interesuar është raporti i koefiçentit të madhësisë së familjes me konsumin total për frymë. Sikurse shihet, raporti varion nga 0.5 deri në thuajse 1, në varësi të vitit të vlerësimit. Kjo do të thotë se modeli nuk mund të hedhë poshtë (refuzojë) ekzistencën e mundshme të ekonomive së shkallës në këto të dhëna. Ndaj, ne gjithashtu raportojmë frekuencën e varfërisë për parametra të ndryshëm të ekonomive të shkallës. Rezultatet tek Figura A.12 tregojnë se ato varen nga numri i fëmijëve që jetojnë në familje, ndërsa rezultatet tek Figura A.13 tregojnë të dhëna të ngjashme për të moshuarit si edhe për familjet me kryefamiljare femra. Dy pika duhen nënvizuar në lidhje me modelet e frekuencës së varfërisë së vëzhguar. Së pari, frekuenca e varfërise nuk ndryshon me supozimet e ekonomise se madhësisë (shkallës) kur familjet klasifikohen mbi bazën e (përbërjes së) numrit të fëmijëve. Megjithatë, frekuenca e varfërisë për kryefamiljaret femra dhe të moshuarit, rritet me parametra më të lartë për supozimet e ekonomive të shkallës. Së dyti, klasifikimi i frekuencës së varfërisë, nuk ndryshon. Nuk ekzistojnë rrugë të lehta dhe të besueshme për të testuar ekzistencën e ekonomive të shkallës. Për më tepër, këto të dhëna nuk janë prova konkluduese të ekzistencës së ekonomive të shkalles. Ndaj me qëllim që ta thjeshtojme diskutimin, ne do të raportojme rezultatet për frymë.

1.30 **Familjet me kryefamiljare femra kanë një frekuencë më të ulët varfërie**. Çuditërisht, familjet me kryefamiljare femra nuk shfaqin rrezik më të lartë për të rënë në varfëri krahasuar me familjet me kryefamiljarë meshkuj, megjithëse diskutimi i mësipërm mund të tregojë se normat e tyre të varfërisë mund të jenë mjaft më të larta për supozimet të ekonomive e më të larta së shkallës. Figura 1.27 tregon së familjet me kryefamiljar mashkull, kanë të paktën një frekuencë varfërie 5 pikë përqindje më të lartë. Familjet me kryefamiljare femra përbëjnë vetëm rreth 12 përqind të të gjithë familjeve në Shqipëri por ato përbënin vetëm 8 përqind të të gjithë të varfërve në të dy vitet. Ndoshta kjo mund të shpjegohet pjesërisht me faktin se familjet me kryefamiljare femra, jetojnë në familje që kane migrantë të cilët rritin të ardhurat e familjes nëpërmjet remitancave që dërgojnë.

1.31 **Gjithashtu, rreziku i varfërisë zvogëlohet me rritjen e arsimimit.** Kryetarët e familjeve qe kanë vetëm arsimin primar, pra ata që kanë përfunduar 4 ose 8 vjet shkollë, përbëjnë rreth 75 përqind të gjithë totalit të të varfërve, megjithëse ata përbëjnë rreth 55 përqind të të gjitha familjeve. Figura 1.27 tregon se rreziku i varfërisë për kryefamiljarët vetëm me arsim primar, ishte rreth 32 përqind në vitin 2002 por 25 përqind në vitin 2005. Rënia më e madhe në frekuencën e varfërisë vihet re tek ata persona që kanë arsimin profesional. Në fakt, megjithëse ekziston një ulje e dukshme prej 28 përqind e frekuencës së varfërisë për kryefamiljarët me arsim primar, ata mbeten mbrapa kryefamiljarëve me arsim të mesëm të përgjithshëm ose profesional përsa i përket uljes së rrezikut të varfërisë. Në tërësi, ndërkohë që nuk është për t'u habitur fakti që ata që janë më të kualifikuar do të përfitojnë më shumë në kuadrin e një rritjeje të lartë ekonmike, vështirësitë e personave më pak të kualifikuar në drejtim të përparimit edhe ne situata kaq të favorshme, mbeten shqetësuese.

**Figura 1.27: Frekuenca e varfërisë sipas Arsimimit të Kryefamiljarit**




**Figura 1.28: Frekuenca e Varfërisë sipas Moshës**




1.32 **Frekuenca e varfërisë sa vjen e po rritet për kryefamiljarët më të rinj.** Në vitin 2002, diferencat në premisat për të qenë të varfër nuk ishin të mëdha gjatë ciklit të jetës. Sikurse tregohet në Figurën 1.28, ndërsa rreziku aktualisht është zvogëluar për kryefamiljarët më të mëdhenj se 30 vjeç, ai është rritur për ata që janë më të rinj. Vlen të përmendet gjithashtu se kryefamiljarët pensionistë kishin një nga frekuencat më të ulta të varfërisë në vitin 2005.

1.33 **Nuk të habit fakti që të papunët kanë një rrezik më të lartë varfërie, megjithëse kontributi i tyre në këtë drejtim është i vogël.** Familjet me kryefamiljarë të papunë kanë një probabilitet prej 34 përqind për të qenë të varfër por edhe kjo shifër është ulur në masë shumë të vogël duke arritur në 32 përqind në vitin 2005, krahasuar me frekuencën e varfërisë prej 14 përqind për familjet me kryefamiljarë të punësuar. Megjithatë, familjet me kryefamiljarë të papunësuar përbëjnë vetëm 5 përqind të popullsisë, kështu që ato përbënin vetëm 6 përqind të të gjithë të varfërve. Krahasimisht, të vetëpunësuarit ku përfshihen familjet fshatare me prodhime të veta bujqësore, zenë vendin e dytë përsa i përket frekuencës më të lartë të varfërisë por ata japin kontributet më të larta: rreth 46 përqind të të gjithë të varfërve ishin klasifikuar si të vetëpunësuar në vitin 2005.

**Figura 1.29: Rreziku i varfërisë sipas statusit të Tregut të Punës**



## E. SHPJEGIME PËR DIFERENCAT NË STATUSIN E MIRËQËNIES MIDIS GRUPEVE

1.34 Përshkrimi i shkurtër i rreziqeve të varfërisë për familjet e përcaktuara mbi një dimension të vetëm sikurse është arsimimi ose statusi i tregut të punës, apo mosha, duhet të përbëjë vetëm pikënisjen për të bërë më shumë punë të detajuar në lidhje me përcaktuesit e diferencave në mirëqënie midis grupeve. Kjo mbetet kaq e veçantë sepse për çdo familje të dhënë, faktorë të shumtë ndërveprojnë për të përcaktuar mirëqënien e saj. Ky seksion eksploron modelet e diferencave në konsum nëpërmjët një regresioni me shumë ndryshore. Qëllim mbetet izolimi i faktorëve që dallohen si disavantazhe të vërteta pasi janë marrë në konsideratë karakteristika të tjera të vëzhgueshme. Për shembull ne do të përpiqemi të gjejmë diferencën e matur në konsumin real për frymë midis familjes mesatare urbane dhe rurale nëse llogarisim diferencat në arsim, vendndodhjen rajonale, gjininë, moshën, etj. Më poshtë, kemi nënvizuar vetëm disa rezultate (shiko Tabela A.31–Tabela A.34). Pas kontrollit të demografisë dhe karakteristikave të kapitalit njerëzor, traumave shëndetësore dhe statusit të tregut të punës së familjeve, personi mesatar i marrë si model, kishte një konsum real për frymë rreth 11 përqind më të lartë në vitin 2005 se sa në vitin 2002. Koefiçenti mbetet i njëjtë madje edhe pas shtimit të efekteve specifike të rajoneve.[3]

1.35 **Familjet e mëdha dhe të reja kanë konsume më të vogla veçanërisht në zonat urbane.** Një familje me tre fëmijë nën moshën 15 vjeç ka mesatarisht 21 përqind më pak konsum për frymë. Ky defiçit ka mbetur pothuajse i njëjtë qoftë duke e parë atë si një model të marrë së bashku në vite ose qoftë si një model të marrë më vete për çdo vit. Hendeku i konsumit për frymë ka rënë pak në vitin 2005 por ende mbetet i lartë. Kur ne shqyrtojmë diferencat në konsum për frymë veç për popullsinë urbane dhe atë rurale, vërejmë se hendeku mbetet negativ dhe i madh. Diferenca është veçanërisht e madhe për familjet urbane megjithëse ajo është ulur mjaft, nga 28 përqind në vitin 2002, në 20 përqind në vitin 2005. Në të kundërtën, familjet me më tepër të rritur se sa anëtarë në varësi, (i kapur me ndryshoren "raporti i varësisë së ulët") kanë një konsum mjaft më të lartë për frymë. Familjet me kryefamiljare femra kanë një konsum më të lartë për frymë se familjet me kryefamiljarë meshkuj, çka tregon frekuencë më të ulët varfërie të vërejtur tek seksioni i mëparshëm.

1.36 **Familjet me kryefamiljarë të papunë, kanë gjithashtu një konsum më të ulët për frymë.** Diferenca është më e lartë në zonat urbane se në zonat rurale, ndoshta nga që të papunët në zonat rurale kanë lidhje më të forta tradicionale se sa rezidentët urbanë. Hendeku, i cili varion nga 20 përqind më pak në zonat urbane në 12 përqind më pak në zonat rurale, ka mbetur thuajse i njëjtë ndër vite. Krahasimisht, një diferencial kaq i madh konsumi për frymë, nuk vihet re tek familjet ku kryefamiljari nuk është aktiv.(ata që janë jashtë forcave të punës.) Ndërkohë që kriza e papunësisë është e shoqëruar me diferenca kaq të mëdha në konsum, ne nuk gjejmë lidhje të hendekut në konsum me traumat nga shëndeti, të matur me numrin e ditëve pa punë për shkak të sëmundjes.

1.37 **Ezidenti mesatar rural ka një konsum prej rreth 14 përqind më pak për frymë krahasuar me rezidentin mesatar urban**. Kjo shifër u vërtetua pas shqyrtimit të efekteve specifike të rajonit (Tabela A.31). Ndërsa kur efektet rajonale nuk llogariten, ajo është 16 përqind. Megjithatë është e rëndësishme të theksohet se me kalimin e kohës ky hendek ka mbetur i njëjtë, duke treguar kështu që një rezident mesatar rural ka fituar po aq nga rritja aktuale ekonomike sa edhe një rezident mesatar urban. Fakti që normat e varfërisë rurale kanë rënë më pak se sa normat e varfërisë urbane, tregon se rezidentët ruralë në skajin më të ulët të shpërndarjes rurale, mund të kenë fituar më pak nga rritja se rezidentët urbanë në skajin më të ulët të shpërndarjes urbane. Çuditërisht, rezidentët ruralë që u kanë kushtuar më shumë tokë (metra katrorë) drithrave ose frutave, duket se kanë një konsum më të ulët për frymë se sa rezidenti mesatar rural, megjithëse hendeku është me të vërtetë i vogël. Dhe po kaq i çuditshëm është

[3] Kur variabli i varur është në formen logaritmike dhe variabli i pavarur është një variabël dummy fiktiv ( që merr vlerën 1ose 0) ne përftojmë diferencën në përqindje duke përdorur formulën: diferenca përqind = (exp.(d)+V (d)/2)-1), ku d është koefiçenti i variablit fiktiv dhe V është diferenca e llogaritjesvlerësimit.

fakti që pavarësisht se kanë më tepër tokë të vaditur, kjo nuk sjell ndonjë avantazh në konsum midis rezidentëve ruralë. Kjo mund të shpjegohet pjesërisht me faktin se shpërndarja e rrjetit vaditës është mjaft e gjerë në distancë. Shumica e këtyre rrjeteve vaditëse gjendet në zonat malore sepse mundësia për vaditje mbetet më e lartë. Megjithatë, fermerëve në këto zona u mungojnë faktorët e prodhimit (mjetet) shtesë dhe aksesi në treg për shkak të infrastrukturës së dobët. Për më tepër numri i tokave në dispozicion për vaditje, mund të flasë për disponibilitetin, por kjo nuk tregon asgjë për funksionimin dhe cilësinë e tyre, ku veçanërisht pas vitit 1990, u zvogëlua mirëmbajtja e sistemeve vaditëse. Krahas kësaj, sistemet e vaditjes kërkojnë energji elektrike e cila mungon disa orë në ditë (Gero Carletto, bisedë personale).

1.38 **Edhe familjet e izoluara kanë një konsum më të ulët për frymë, megjithëse tani ky disavantazh mund të jetë duke u zhdukur**. Përcaktimi i familjeve të izoluara këtu nënkupton ato familje që ndodhen në distancë të largët nga shërbimet sociale. Në veçanti, ne e matim atë me distancën (në km.) nga shkolla më e afërt. Nëpërmjet kësaj matjeje, një rritje prej 1 përqind në distancën nga shkolla më e afërt, tregon një rënie prej 0.4 përqind në konsumin për frymë. Ky hendek ishte 0.7 përqind më i ulët në vitin 2002, por në vitin 2005, është zhdukur tërësisht.

1.39 **Në bazë rajonesh, ekzistojnë diferenca të mëdha në konsumin për frymë**. Duke parë të dhenat nga grupi i vëzhguar (sample), rezidenti mesatar në zonë Malore ka 12 përqind më pak konsum real për frymë se sa rezidenti mesatar në Tiranë. Në të kundërtën, rezidentët në zonën Qendrore e kanë 5 përqind më të ulët ndërsa rezidentët e Bregdetit kanë një konsum për frymë 4 herë më të lartë se sa Tirana. Por grupi i vëzhguar maskon disa zhvillime madhore në kohë. Në vitin 2002, vetëm zona Malore ka patur konsum për frymë më të ulët se Tirana, me 9 përqind. Krahasimisht, rezidenti mesatar i Bregdetit, kishte konsum 11 përqind më të lartë dhe rezidenti mesatar i Zonës Qendrore, kishte pothuajse të njëjtin konsum me rezidentin mesatar të Tiranës. Në vitin 2005, rezidenti mesatar i Tiranës kishte konsum të njëjtë ose më të lartë për frymë se rezidenti mesatar në të gjitha zonat e tjera. Parë në një pamje më të gjerë të mirëqënies në rritje, kjo tregon se sa mirë ka ecur Tirana dhe jo se sa keq kanë ecur rrethet e tjera. Tabela A. 31 tregon se rezidenti mesatar rural i bregdetit, ka një konsum prej 17 dhe 34 përqind më të lartë për frymë se rezidenti mesatar rural respektivisht i zonës Qendrore dhe Malore.

**Konkluzion**

1.40 Si konkluzion mund të thuhet se performanca mbresëlënëse e rritjes ekonomike së Shqipërisë, u shoqërua me një përmirësim po aq mbresëlënës në standartet e jetesës. Konsumi real u rrit me dy shifra, varfëria ekstreme dhe absolute ranë ndjeshëm, u zvogelua disniveli midis zonave më të varfëra dhe fqinjëve të tyre në gjendje më të mirë, si edhe u përmirësua aksesi ndaj disa shërbimeve baze, megjithëse me hapa më të ngadaltë. Në të njëjtën kohë, normat e rritjes urbane ecën më përpara se ritmet e zhvillimit rural dhe kjo çoi drejt shtimit zgjerimit të diferencave në mirëqënie midis zonave rurale dhe urbane. Për më tepër, njësia matëse e pabarazisë Gini,që aktualisht është e ulët, u rrit në mënyrë modeste dhe qëndroi rreth 30 përqind. Profili i të varfërve tregon se të varfërit janë kryesisht ata persona që jetojnë në familje të mëdha, në zona rurale dhe kanë kualifikim të dobët të matur me vitet e arsimit të kryer.

# *KREU 2:* GJEOGRAFIA E TË VARFËRVE: PRODUKTIVITETI RURAL DHE VARFËRIA

Varfëria *Rurale pati një rënie më të ngadaltë se varfëria urbane, me përjashtim të zonave Malore, ku ndodhën disa nga uljet më të shpejta të varfërisë. Të dhënat tregojnë se fermerët e vegjël janë në përgjithësi ineficientë sepse prodhimi aktual përbën vetëm një të tretën e atij që duhej të ishte. Produktiviteti i ulët vjen si rezultat i faktit që fermerët shqiptarë përballen me kufizime të shumta në lidhje me faktorët e prodhimit, nuk kanë mundësi për kredi dhe nuk marrin shërbimet e duhura nga institucionet për rritjen bujqësore. Krahas kësaj, emigrimi masiv nga zonat rurale i përkeqëson këto probleme. Rritja e produktiviteti të fermave të vogla do të luajë rolin e vet në uljen e varfërisë rurale duke zvogëluar kështu diferencën e madhe që ekziston me zonat urbane.*

2.1 **Përfitimet prej rritjes së madhe ekonomike të Shqipërisë, u ndjenë nga të gjitha grupet e popullsisë.** Rënia e përgjithshme e varfërisë u vu re si në zonat rurale edhe në ato urbane dhe në të katër rajonet agro-ekologjike të vendit. Megjithatë, shumica e të varfërve vazhdojnë të jetojnë (banojnë) në zona rurale. Ndryshimet në normat e uljes së varfërisë kanë treguar se me kalimin e kohës, pjesa e të varfërve që jetojnë në zonat rurale, aktualisht nuk është ulur por, përkundrazi është rritur. Ky kapitull analizon në mënyrë të përmbledhur tendencat tek të varfërit ruralë, karakteristkat e të varfërve dhe disa nga arsyet për rritjen e ngadaltë të të ardhurave në zonat rurale.

## A. VARFËRIA RURALE DHE TENDENCAT E PABARAZISË

2.2 **Megjithëse ka patur një ulje të ndjeshme të varfërisë në përgjithësi, normat e varfërisë rurale u ulën më ngadalë se ato urbane**. Tabela 2.1 tregon se ndërsa varfëria rurale ra në rreth 24 përqind, varfëria urbane ra në 41 përqind kështu që numri i të varfërve në zonat urbane ra nga 19.5 përqind në vitin 2002 në 11.2 përqind në vitin 2005, ndërsa ajo rurale ra nga 29.6 përqind në 24.2 përqind. Rezultat i kësaj rënieje të diferencuar të varfërisë është përqëndrimi më i madh i të varfërve në zonat rurale (Figura 2.1). Në veçanti, ndërsa të varfërit ruralë përbënin 66 përqind të numrit total të të varfërve në vitin 2002, ata arritën në 75 përqind në vitin 2005.

2.3 **Normat e varfërisë urbane** jo **vetëm janë më të ulta dhe po bien më shpejt por të dhënat tregojnë gjithashtu se varfëria urbane nuk është aq e thellë sa ajo rurale**. Treguesi i hendekut të varfërisë (thellësia e varfërisë) për zonat urbane ishte vetëm 2.3 përqind në vitin 2005, krahasuar me 5.3 përqind në zonat rurale. Për zonat urbane, kjo është një ulje prej 49 përqind nga niveli i vitit 2002, ndërsa për zonat rurale ulja ishte vetëm 20 përqind.

2.4 **Megjithatë, disa nga uljet më drastike në varfëri u vërejtën midis popullsisë rurale në zonat Malore.** Në tërësi, varfëria rurale ra me 5 pikë përqindje krahasuar me një ulje prej 22 pikë përqindje në popullatën rurale të zonave Malore. Zonat rurale në zonat Qendrore dhe Bregdetare- pësuan vetëm ulje të vogla. Për shembull, Figura 2.2, tregon se zonat rurale Bregdetare dhe Qendrore kishin thuajse 1 deri në 3 pikë përqind ulje në varfërinë absolute. Një ulje kaq e madhe në varfëri i ka lejuar zonat rurale Malore t'i arrijnë zonat e tjera rurale, por ia vlen të përmendet se norma e varfërisë atje ende është më e lartë se në zona të tjera. Sikurse do të shohim në kapitullin tjetër, një pjesë e kësaj diference masive në rezultatet e vërejtura të varfërise, mund të jetë rrjedhojë e tendencave të shfaqura në format e migrimit nga këto zona.

**Figura 2.1: Tendencat e Varfërisë Absolute në zonat Rurale**




**Tabela 2.1: Normat e Uljes së Varfërisë në Zonat Rurale dhe Urbane**

| Varfëria sipas zonës Rurale/ urbane | Ndryshimet në varfëri | | | |
|---|---|---|---|---|
| | **2002** | **2005** | **Nr. i personave** | **Ndryshimi në përqindje** |
| Popullsia totale në varfëri | 813,196 | 75,659 | -237,537 | -29.2103 |
| Urbane | 257,690 | 51,811 | -105,879 | -41.08774 |
| Rurale | 555,506 | 23,848 | -131,658 | -23.70055 |

*Burimi*: Vlerësimet e stafit të Bankës Botërore duke përdorur të dhëna nga sondazhi.

2.5 **Rritja e konsumit real për frymë në zonat rurale mbeti mbrapa rritjes se konsumit në zonat urbane, por pavarësisht kësaj ajo ka patur një shpërndarje më të barabartë.** Së pari, rritja për çdo percentil ishte mjaft më e ulët se rritja e konstatuar për popullsinë urbane. Për shembull ndërkohë që rritja mesatare për çdo percentil në zonat urbane ishte 22 përqind, ajo ishte vetëm 9 përqind për popullatën rurale. Së dyti, rritja e konsumit real për frymë, për të varfërit ruralë ishte shumë më e ulët se rritja për të varfërit urbanë midis viteve 2002 dhe 2005. Një skemë e konsumit real për frymë tregon se rritja në konsum për percentilin e 19të të popullatës urbane e cila ishte klasifikuar si e varfër në vitin 2002, ishte 19.4 përqind midis viteve 2002 dhe 2005. Krahasimisht, rritja e konsumit real për frymë për percentilin e 29të të popullatës rurale që ishte konsideruar e varfër në vitin 2002, ishte vetëm 6.3 përqind. (Tabela 2.2).

**Figura 2.2: Tendencat e varfërisë sipas shtresës, Zonat rurale**




2.6 **Por ndryshe nga popullsia urbane, ajo rurale ka patur më pak diferenca në rritjen e konsumit përgjatë gjithë shpërndarjes së saj.** Në zonat rurale, vetëm një e pesta popullatës (poshtë percentilit të 20) pati rritje të konsumit e cila ishte më e ulët se rritja mesatare e konsumit të vlerësuar për zonat rurale, ndërsa të gjithë ata që ishin mbi percentilin e njëzetë patën rritje të konsumit të përafërt me rritjen mesatare (për zonat rurale). Në zonat urbane, rreth 40 përqind e popullsisë pati rritje më të vogël të konsumit se mesatarja për zonat urbane, ndërsa pjesa tjetër pati rritje në konsum të përafërt me mesataren. Për familjen mediane rurale pati një rritje më të madhe në konsum madje edhe prej atyre që ndodheshin në krye të skajit të fundit të shpërndarjes. Në fakt, rritja mesatare e percentilit për percentilin e 20-të deri në percentilin e 90-të të popullatës rurale duket setë është rreth 10 përqind, ndërkohë që për familjet urbane është më e shpërndarë, duke treguar se rritja rurale, edhe pse më e ulët, ishte më e barabartë. Megjithatë, rritjet mesatare të konsumit në zonat urbane, ishin shumë më të larta se në zonat rurale për çdo grup-percentili, kështu që madje edhe fundi i dy të pestave të popullatës urbane (poshtë percentilit 40), patën mesatarisht rritje të konsumit për frymë që ishin më të larta se mesatarja e zonave rurale. (Figura 2.3 dheFigura 2.4).

**Figura 2.3: Kurba e Frekuencës së Rritjes, Zona Urbane**




**Figura 2.4: Kurba e Frekuencës së Rritjes, Zona Rurale**



**Tabela 2.2: Normat e rritjes së Konsumit, Rurale dhe Urbane**

| Normat e Rritjes në / me | Urban përqind | Rural përqind |
|---|---|---|
| Mesatar | 23.9 | 9.1 |
| Median | 22.1 | 10.6 |
| Percentili Mesatar | 22.2 | 8.7 |
| Percentili i të varfërve në vitin 2002 | 19.0 | 29.0 |
| Rritja korresponduese e percentilit pro-të varfër | 19.4 | 6.3 |
| Vija e varfërisë | 4891 | 4891 |

2.7 **Ndryshe nga zonat urbane, konsumi real për frymë në disa zona rurale pësoi rënie.** Një e pesta e poshtme (nën percentilin 20) e banorëve ruralë të Bregdetit pati ose rritje negative të konsumit real për frymë ose nuk pati rritje fare të tij. Po kështu ndodhi për një ë dhjetën më të ulët në zonat rurale Qendrore Por në zonat Malore rurale rritja e konsumit real për frymë, ishte drastike. Për më tepër, rritjet më të mëdha në konsum i patën ata që ndodheshin në gjysmën e poshtme të shpërndarjes. Dy pika të tjera që duhen theksuar në lidhje me zonat Malore, janë se rritja e konsuminit real për frymë në zonat e saj rurale, e tejkalon rritjen e njëjtë për zonat urbane të saj dhe është e vetmja pjesë rurale ku rritja e konsumit është e barabartë ose e tejkalon rritjen e vërejtur në zonat urbane (Figura 2.5 deri tek Figura 2.7).

**Figura 2.5: Kurba e Frekuencës së Rritjes së konsumit për zonat Rurale Bregdetare**




**Figura 2.6: Kurba e Frekuencës së Rritjes për zonat Rurale Qendrore**




**Figura 2.7: Kurba e Frekuencës së Rritjes, për zonat Rurale Malore**




*Burimi:* Vlerësimet e Stafit të Bankës Botërore nga të dhënat e sondazhit.

2.8 **Rishpërndarja luajti një rol të rëndësishëm në modelet e vëzhguara të uljes së varfërsë në zonat rurale**. Pothuajse e gjithë ulja e matur prej 7 pikë përqindje në varfërinë absolute në tërësi i atribuohet rritjes ekonomike. Në zonat rurale, situata nuk na paraqitet aq e qartë. Në zonat rurale Malore rritja ekonomike ndikoi në një masë të madhe në uljen e konstatuar të konsumit dhe rishpërndarja në skajin më të ulët të shpërndarjes e ndihmoi këtë ndikim. Megjithatë, , nëse shpërndarja do të kishte mbetur e njëjtë midis viteve 2002 dhe 2005 në zonat rurale Bregdetare, atëherë vetëm rritja e konsumit mund të kishte çuar në rreth 6 pikë përqindje të uljes se varfërisë. Në vend të kësaj, rishpërndarja në skajin e sipërm të shpërndarjes, kundërbalancoi 2 pikë përqindje të uljes potenciale të varfërisë dhe ndërveprimi i rritjes së konsumit me faktorët e rishpërndarjes, zhvleftësuan një 2 përqindësh tjetër. Në zonat Qendrore rurale, një shpërndarje e qëndrueshme do të thoshte një ulje potenciale prej 4 pikë përqindje për pjesën nën vijën e varfërisë. Megjithatë, rishpërndarja në pjesët e sipërme të shpërndarjes, balancoi pikët prej 3 përqind. Ulja prej 2.6 pikë përqindje që u vërejt, erdhi nga faktorë të pashpjegueshëm që çuan në një rritje tjetër prej 1.6 në drejtim të uljes se varfërisë.

2.9 **Modeli i ndryshimeve në konsum tregoi ndryshime të vogla në pabarazinë rurale**. Së pari, rritjet në konsum përgjatë shpërndarjes u shpërndanë në mënyrë më të barabartë. Në zonën e Bregdetit dhe në zonat Qendrore, vetëm një e pesta dhe një e dhjeta e poshtme respektivisht, pësoi një rritje negative të konsumit. Por ekzistonin shumë pak dallime në ndryshimet e matura në konsum në grupet e tjera. Së dyti, në zonat rurale Malore, ku rritja e konsumit ishte më e lartë se në të gjitha zonat e tjera rurale, ata që ndodheshin në gjysmën më të ulët të shpërndarjes, patën një rritje më të lartë të konsumit se sa ata që ndodheshin në skajin më të lartë të shpërndarjes. Rezultati është pabarazi e qëndrueshme. Koefiçenti Gini ishte rreth 27 përqind në të dy vitet. Tregues të tjerë të pabarazisë mbetën gjithashtu në nivele të qëndrueshme.

## B. KORRELACIONET E VARFËRISË NË ZONAT RURALE

2.10 **Në lidhje me modelet e vërejtura të treguesve të mirëqënies jo të lidhur me të ardhurat në zonat rurale, duhen theksuar tre pika .** Së pari, pabarazia në aksesin për shërbimet bazë midis grupeve të të ardhurave dhe gjinive të ndryshme, mbetet problem sikurse është edhe në nivel kombëtar(Figura B.1 -Figura B.6). Së dyti, pothuajse për çdo shërbim, problemet e aksesit dhe të cilësisë janë më të këqia në zonat rurale se në ato urbane. Së treti, progresi në uljen e këtyre diferencave ka qenë më i ngadaltë në zonat rurale se sa në ato urbane.

2.11 **Në bazë të studimit, të njëjtat modele të vërejtura në nivel kombëtar, vihen re gjithashtu edhe për zonat rurale**. Rezultatet e korrelacioneve të konsumit dhe premisat e të qenit të varfër, janë paraqitur në Tabelën B.1. Rezultatet e modelit të probabilitetit, (kolona e fundit), janë efektet marxhinale ku koefiçenti është rritja apo ulja në pikë përqindje e probabilitetit për të qenë të varfër. Rezultatet e të dy modeleve flasin për të njëjtin fenomen. Në veçanti, varfëria ka korrelacion pozitiv me madhësinë e familjes dhe korrelacion negativ me moshën, rezultate më të mira në tregun e punës dhe arsimimin. Për më tepër, familjet me kryefamiljare femra, nuk kanë më shumë probabilitet për të qenë të varfëra sikurse pamë kur shqyrtuam frekuencën e varfërisë. Krahas kësaj, ne vumë re se familjet rurale me akses në shërbime më të mira si ujë çezme dhe banjë brenda shtëpisë kanë më pak premisa për të qenë të varfër. Po kështu konsiderohen edhe familjet që zotërojnë pajisje si sobë me gaz, satelit, makina dhe motoçikleta, që janë tregues të të ardhurave potenciale.

2.12 **Përsa i takon pjesëmarrjes në aktivitete specifike bujqësore, rezultatet tregojnë se familjet që kanë më shumë tokë të kultivuar me perime, kanë 10 përqind më pak probabilitet për të qenë të varfër.** Gjithashtu vërejmë se familjet me më shumë pemë frutore, mesatarisht konsumojnë më shumë, por ky avantazh nuk tregon se ato mund të kenë rritje probabiliteti më të mirë apo më të keq për të qenë të varfër. Konkluzione të ngjashme mund të arrihen për një numër krerësh bagëtish apo hektarë toke të ujitshme në pronësi.

2.13 **Shpërbërja e ndryshimeve në varfëri midis viteve 2002 dhe 2005, tregon se ulja e varfërisë rurale ka qenë më e ngadaltë se ajo urbane pjesërisht sepse rritja ekonomike në zonat rurale ka mbetur mbrapa.** Pas një rritjeje prej dy shifrash në vitet '90, rritja bujqësore është ulur në rreth 3 përqind në vit. Meqënëse historia e rritjes agregate bujqësor përfshin ferma më të mëdha që shfrytëzojnë ekonomitë potenciale të shkallës, si edhe tregje eksporti fitimprurëse, është plotësisht e mundur që rritja nga ana e fermerëve të vegjël të jetë madje më e ulët se rritja e llogaritur prej 3 përqind. Duke marrë parasysh se rreth 50 përqind e popullsisë ende jeton në zona rurale, jetesa e së cilës varet nga fermat e vogla, përmirësimi i produktivitetit bujqësor për këtë klasë fermerësh, mbetet mjaft i rëndësishëm për uljen e varfërisë rurale. Seksionet e mëposhtme shqyrtojnë kufizimet me të cilat përballet rritja e produktivitetit në fermat e vogla.

## C. TENDENCAT NË PJESËMARRJEN NË VEPRIMTARI QË PRODHOJNË TË ARDHURA.

2.14 **Të ardhurat në zonat rurale janë rritur midis viteve 2002 dhe 2005, megjithatë rritja ekonomike ka ardhur si rezultat i veprimaterive jo-bujqësore**. Të ardhurat mesatare u rritën nga 2790 USD në vitin 2002 deri në 4400 USD[4]. Gjatë kësaj periudhe të ardhurat mesatare nga blegtoria ranë dhe të ardhurat mesatare nga prodhimi bujqësor mbetën të pandryshueshme kështu që pjesa e veprimtarive bujqësore në të ardhurat totale ra nga 54 përqind në vitin 2002 deri në 45 përqind në vitin 2005. Bie në sy një mbështetje në rritje e popullatës rurale në veprimtaritë jo bujqësore[5]. Në veçanti, mesatarja e pagës jo bujqësore u rrit më tepër se dyfish dhe arriti atë nivel që tani përbën burimin e dytë më të lartë (ndaj blegtorisë) të të ardhurave për popullsitë rurale. Rritja e pjesës se të ardhuarve jo bujqësore rradhitet më e larta për këtë periudhë dhe konkurohet vetëm nga rritja në pjesën e bizneseve jo fermere (vetëpunësimi).

2.15 **Portofolet e të ardhurave rurale janë mesatarisht më të larmishme**. Duke përdorur LSMS 2005, një familje përkufizohet si e specializuar nëse më tepër se 75 përqind e të ardhurave të saj totale neto rezultojnë nga një burim i vetëm. Sikurse tregohet tek Figura 2.8, numri i familjeve që janë të specializuara në një prej pesë burimeve kryesore të të ardhurave, është më e vogël në zonat rurale se në ato urbane. Për shembull, vetëm 46 përqind e familjeve rurale janë të specializuara në një prej 5 burimeve kryesore të të ardhurave. Krahasimisht, 75 përqid e familjeve urbane janë të specializuara në një prej tre burimeve të të ardhurave. Sikurse pritet, pjesa më e madhe e familjeve rurale në zonat rurale, 19 përqind e tyre, specializohen në veprimtari fermere, vijuar nga paga jo bujqësore dhe transferime në këtë drejtim.

---

[4] Le të marrim një kurs këmbimi ku 1USD =100 Albanian Lek. Moduli i të ardhurave për LSMS 2005 ka pësuar ndryshime të cilat synonin të përftonin informacion më të saktë rreth të ardhurave krahasuar me vitin 2002. Në veçanti modulet për biznesin privat dhe veprimtaritë bujqësore, si edhe për prodhimin bujqesor dhe bagëtinë e mbajtur, janë zgjeruar. Përveç kësaj, për modulin bujqësor, të dhënat e vitit 2002 u grumbulluan në muajin Qershor, ndërsa ato të vitit 2005, u grumbulluan në muajin Tetor gjatë periudhës së pikut të grumbullimit të prodhimit bujqesor. Kështu që ka mundësi që të ardhurat e vitit 2002 të mos jenë raportuar saktë, krahasuar me ato të vitit 2005; por duhet thenë së janë bërë mjaft përpjekje për të krijuar një agregat të krahasueshëm të ardhurash , me qëllim që prirjet e përgjithshme (nëse jo magnitudat), të konsiderohen të besueshme.

[5] Në këtë paragraf dhe në ata pasardhës raporti mbështetet mbi të ardhurat e raportuara nga anketimet e familjeve. Është e rëndësishme të theksohet se burime të tjera të të ardhurave, si p.sh. të dhënat e të ardhurave nga fermat, tregojnë një rritje të të ardhurave nga drithërat dhe bagëtitë nga 2003 në 2006

2.16 **Rezidentët e varfër ruralë kanë më shumë premisa të specializohen në veprimtari fermere**. Prandaj është e rëndësishme të nënvizojmë tre pika në lidhje me të ardhurat e të varfërve ruralë. Së pari, ata varen më tepër prej të ardhurave nga prodhimi bujqesor dhe blegtoria, të dyja këto, burime të ardhurash të cilat janë duke u pakësuar në Shqipëri. Pjesa e veprimtarive totale bujqësore në të ardhura totale neto, ra nga 57 përqind në vitin 2002 në 51 përqind për të varfërit në vitin 2005. Në të njëjtën kohë ajo ra nga 52 në 42 përqind për personat jo të varfër. Në fakt, pjesa e të ardhurave nga prodhimi bujqësor, u rrit nga 16 në 19 përqind për të varfërit ndërsa ajo mbeti në të njëjtin nivel për personat jo të varfër. Së dyti, në të gjitha zonat ku ka një rritje të ndjeshme të të ardhurave, ato kanë mbetur mbrapa. Këto përfshijnë të ardhura nga veprimtaritë jo bujqësore dhe të bizneseve jo fermere. Se treti, të varfërit janë më tepër të varur nga transfertat publike se sa nga ato private (remitancat). Transfertat – private dhe publike – përbëjnë rreth një të katërtën e të ardhurave të familjeve rurale. Për personat jo të varfër, pjesët nga transfertat publike dhe private janë ndarë pothuajse në mënyrë të barabartë, ndërsa për të varfërit, rreth 75 përqind e të ardhurave të transfertave vjen nga ato publike dhe vetëm 25 përqind nga ato private.

**Figura 2.8: Specializimi i të ardhurave në zonat Urbane dhe Rurale, 2005**




2.17 **Një pjesë më e vogël e të varfërve varen nga pagat jo bujqësore**. Në përgjithësi janë të pakta ato familje që marrin pagë nga bujqësia. Në tërësi, vetëm 5 përqind e popullsisë rurale, kontribuon në pagat bujqësore. Në vitin 2005, pjesa e njësisë së pestë më të varfër, e cila jepte kontributin e saj në pagat bujqësore, ishte e përafërt me mesataren kombëtare (5 përqind.). Megjithatë, rreth 37 përqind e kuintilit më të pasur, mori pjesë në pagat jo bujqësore, krahasuar me vetëm 18 përqind të më të varfërve. Për më tepër, pagat mesatare jo bujqësore që u përfituan nga njësia e pestë e më të varfërve, ishin 43 përqind më ulëta se paga mesatare e marë nga kuintili i dytë më i varfër, duke treguar ndoshta se të varfërit jo vetëm që po kontribuojnë më pak në pagat jo bujqësore por edhe që të ardhurat e tyre janë më të ulta.

## D. PRODHIMI BUJQËSOR NUK ËSHTË EFICIENT

2.18 **Shumica e fermave familjare prodhojnë për nevoja familjare**. Së pari, raporti midis cilësisë së prodhimit bujqësor të mbledhur dhe të shitur është shumë i ulët. Vetëm 28 përqind e fermerëve shesin prodhimin e tyre në treg dhe mesatarisht vetëm 9 përqind e prodhimit bujqësor të mbledhur shitet nga fermerët. Krahas kësaj, vetëm 14 përqind e fermerëve e shesin prodhimin bujqësor të mbledhur në një treg jashtë komunitetit të tyre. Të dhënat tregojnë se prodhimi bujqësor i shitur në treg është dy herë më i lartë për fermerët më të mëdhenj, ku të tillë konsiderohen ata me rreth 1.16 deri 11 hektarë tokë, krahasuar me fermerët më të vegjël (Tabela 2.3). Kjo tregon se ndarja e tokës në Shqipëri e cila përbën një tipar themelor të bujqësisë shqiptare, nuk ka premisa të përmirësojë integrimin në treg.

2.19 **Krahasimisht, zhvillimi i tregjeve për dhënien/marrjen me qira të tokës, veçanërisht nëse ai çon në konsolidimin e tokës, mund të ulë prirjen e fermave bujqësore për të prodhuar për nevoja familjare**. Sikurse tregohet në Tabelën 2.4, raporti i sasisë së shitur me atë të mbledhur, rritet në 14 përqind për fermerët që marrin tokë me qira. Për më tepër, numri i fermerëve që e shesin prodhimin e tyre bujqësor jashtë komunitetit, arriti në 22 përqind për këtë grup fermerësh.

**Tabela 2.3: Raporti midis sasisë së prodhimit bujqësor të shitur në treg dhe prodhimit të mbledhur**

| **LLOJET E FERMAVE** | **Raporti (përqind)** |
|---|---|
| Gjithë fermat | 9 |
| Marrë me qira | 14 |
| Dhënë me qira | 4 |
| **Kategoria e tokës** | |
| 0 – 0.25 ha | 5.3 |
| 0.25 – 0.6 ha | 7.6 |
| 0.6 – 1.16 ha | 9 |
| 1.16 – 11 ha | 10.3 |

*Burimi*: Vlerësimet e Stafit të Bankës Botërore nga të dhënat e sondazhit.

2.20 **Së dyti, puna me mëditje në fermat familjare ekziston në masë shumë të vogël**. LSMS 2005 nuk mblodhi të dhëna për numrin e punëtorëve me mëditje, por ajo ka grumbulluar informacion për koston e punës me mëditje. Ndaj ne llogarisim koston e punës me mëditje në koston totale të faktorëve të përdorura. Këto përqindje tregohen në kolonen e fundit të Tabelës 2.4. Vërejmë se meqënëse kostua e faktorit të përdorur në prodhimin për përdorim vetjak gjithashtu nuk disponohet, raporti i llogaritur në fakt është një kufi i sipërm (emëruesi është më i ulët se ç'duhej të ishte). Konkluzioni kryesor mbetet që puna me mëditje pothuajse nuk ekziston për fermat e vogla familjare.Vetëm 8 përqind e të gjitha fermave kanë punë me mëditje megjithëse kjo shifër rritet deri në 17 përqind për ata që kanë marrë tokë me qira. Përqindja e punës me mëditje në koston totale të faktorëve të prodhimit, është vetëm 3 përqind për të gjitha fermat. Nuk të habit fakti që ajo është më e lartë për ata që marrin tokë më qira, por dhe në atë rast ajo nuk është më e lartë se 5 përqind e kostos totale të faktorëve të prodhimit. Kjo tregon se fermerët mbështeten në punën e familjes ose në ndihmën nga punëtorë të papaguar (si të afërm apo punë në shkëmbim nga fqinjët).

2.21 **Së fundmi, analizojmë nivelin e teknologjisë në ferma.** Në një situatë ideale, do të ishte me vlerë të krahasonim numrin e fermave që përdorin faktorë prodhimi modern –p.sh.makineri moderne, plugje, farëra hibride, dhe plehra kimike – në raport me ata që mbështeten më tepër në faktorët tradicionale. Për fat të keq, të dhënat për makineritë bujqësore dhe pajisjet e tjera nuk janë të plota. Për shembull, ne vërejmë se afërsisht vetëm një e treta e familjeve deklarojnë se zotërojnë ndonjë lloj makinerie dhe së shumti 3 përqind e të gjitha familjeve fermere zotërojnë traktor. Megjithatë, zotërimi i makinerive është një tregues jo i saktë i përdorimit të tyre sepse shumë fermerë në të vërtetë i marin me qera makinat bujqësore. Krahasimisht, pjesa më e madhe e fermerëve përdorin pesticide dhe farëra të kohës (Tabela 2.4). Por kostot e pesticideve përbëjnë më shumë se sa gjysmën e kostos së të gjithë faktorëve të blerë dhe kjo ndoshta tregon se çmimi i këtij faktori të rëndësishëm është relativisht i lartë, veçanërisht për fermerët që kanë tendenca të marrin pjesë në treg (ata që marrin me qira).

2.22 **Evidenca empirike tregon se produktiviteti është i ulët sepse shumica e fermave nuk përdoren në mënyrë eficiente.** Mbi 46 përqind e të gjithë variacionit të vërejtur në prodhimin e fermerëve i atribuohet diferencave në eficiencën teknike. (Tabela B.2). Mesatarisht efiçenca teknike e fermerëve të vegjël është vetëm 28 përqind. Kjo do të thotë se fermeri mesatar po operon vetëm me një të tretën e kapacitetit më afër potencialit. Të habit fakti që kjo eficiencë e ulët është e përgjithshme në sensin që ajo nuk ndryshon shumë sipas kategorisë së tokës. Një paraqitje vizive e lidhjes midis eficiencës dhe madhësisë së tokës në pronësi tregohet në Figurën 2.9 (Paneli A). Grafiku i përhapjes tregon se për çdo sipërfaqe toke ka heterogjenitet të dukshëm në nivelet e matura të eficiencës së fermerit. Heterogjeniteti i madh do të thotë se fermeri mesatar në kuartilin më të ulët të madhësisë së tokës në pronësi nuk ndryshon aq shumë përsa i takon eficiencës nga fermeri mesatar që ndodhet në kuartlin më të lartë. Në mënyrë më specifike, eficienca mesatare për fermerët me më pak se 0.25 hektare tokë është 21 përqind, ndërsa

eficienca mesatare për fermerët në kuartilin më të lartë (ata me rreth 1.16 deri 11.5 hektarë) është vetëm 33 përqind. (shih Tabela B.3).

**Tabela 2.4: Sasia e kostos së mjeteve dhe numri i familjeve që përdorin farëra dhe pesticide të kohës**

| Lloji i fermave | Pjesa e shpenzimeve për farërat ndaj totalit të faktorëve të prodhimit të blerë | Pjesa e shpenzimeve për pesticidet ndaj totalit të faktorëve të prodhimit të blerë | Pjesa e shpenzimeve për punën me mëditje ndaj totalit të faktorëve të prodhimit të blerë |
|---|---|---|---|
| Të gjitha fermat | 22.7 | 58.3 | 2.8 |
| Dhënë me qira | 8.5 | 47.2 | 0.6 |
| Autarki | 23.5 | 58.2 | 2.8 |
| Marrë me qira | 20.6 | 65.2 | 4.6 |
| **Kategoria e tokës** | **Numri i familjeve që përdorin farëra** | **Numri i familjeve që përdorin pesticide** | **Numri i familjeve që përdorin punë me mëditje** |
| Të gjitha fermat | 57.5 | 85.2 | 7.7 |
| Dhënë me qira | 25.4 | 59.7 | 3.0 |
| Prona e vetë | 57.3 | 85.5 | 7.3 |
| Marrë me qira | 79.1 | 96.5 | 16.5 |

*Burimi*: Vlerësimet e Stafit të Bankës Botërore nga të dhënat e sondazhit.

2.23 **Një vështrim më nga afër në shpërndarjen e eficiencës teknike tregon një shpërndarje bi-modale** (Figura 2.9, Paneli B). Për këtë arsye ne i ndamë familjet në tre nivele të eficiencës teknike: nën 20 përqind, midis 21 dhe 50 dhe më shumë se 50 përqind. Vetëm 23 përqind e familjeve kanë një eficiencë teknike më të madhe se gjysma e vlerës më të lartë të mundshme e kufirit të mundësive të prodhimit, ndërsa 41 përqind prej tyre janë më pak se 20 përqind eficientë. Tabela B.5 tregon vlerat mesatare të faktorëve të vëzhguar për grupet e ndara sipas niveleve të eficiencës teknike. Dallimet kryesore vihen re në tre faktorë. Njëra ka të bëjë me rëndësinë e tokës së ujitshme. Fermerët që kanë një rezultat më të mirë eficience, raportojnë mesatarisht dyfishin e hektarëve të tokës së ujitshme në krahasim me ata të nivelit më të ulët të eficiencës. Një konstatim tjetër është se fermerët më eficientë kanë nivele më të larta inputesh (punë me mëditje ose mjete të blera) dhe në fund fermerët më pak eficientë kanë përqindje më të lartë të ardhurash që i marrin nga transfertat. Ky vështrim i thjeshtëzuar për diferencat mesatare na çon drejt shqyrtimit të përcaktuesve të eficiencës teknike, rezultatet e së cilës tregohen në Tabelën B.2. Rezultatet na çojnë në tre konkluzione kryesore.

2.24 **Së pari, një burim kryesor ineficience është toka e pamjaftueshme për shumë familje**. Në një sens më të përgjithshëm, mund të thuhet se mungesa e aksesit për tokë të mjaftueshme përbën pengesën më të madhe për rritjen bujqësore e për rrjedhojë edhe për rritjen e të ardhurave nga bujqësia në Shqipëri[6]. Familja mesatare kultivon vetëm 0.8 hektarë tokë. Për më tepër, një pjesë e madhe e kësaj toke është e ndarë në shumë parcela. Mënyrat e shumta nëpërmjet të cilave copëzimi i tokës e dëmton produktivitetin bujqësor janë të mirënjohura: parcelat e shumta të madhësive të vogla sjellin kosto të larta të

[6] Ideja e hedhur ketu – që fermat e vogla janë jo-eficiente – ka nevojë të shpjegohet më mirë. Egziston një literature e gjerë që tregon se fermat e vogla mund të jenë po aq eficient dhe ne disa raste edhe më eficient se fermat e mëdha. Në këtë raport analiza nuk konsiston në krahasimin e fermave të vogla me ato të mëdha duke qenë se firmat e mëdha nuk ishin pjese e anketimit. Treguesi i eficiencës është një tregues teknik që krahason nivelin e vërejtur të operimit me atë që mund të ishte potenciali.

transaksioneve, alokim ineficient të inputeve dhe vështirësi në adoptimin e teknologjive me ekonomi të shkallës. Kështu një konkluzion i arsyeshëm do të ishte se copëzimi i tokës përbën pengesë të madhe në përmirësimin e eficiencës së fermave.

**Figura 2.9: Shpërndarja e Eficiencës Teknike**

**A. Grafik i përhapjes së Eficiencës Teknike**




**B. Dendësia Kernel e Efiçencës Teknike**




*Shënim*: Një petal është një numër segmentesh lineare me gjatësi të barabartë që dalin nga një pikë qendrore e përbashkët. Ka dy lloje petalesh; e çelët dhe e errët. Çdo petal me ngjyrë të çelët përfaqëson një vëzhgim. Çdo petal me ngjyrë të errët, përfaqëson një numër vëzhgimesh. Zonat me ngjyrë të errët dhe të çelët përfaqësojnë rajone me dendësi të lartë dhe mesatare të të dhënave, dhe simbolet me shënues përfaqësojnë vëzhgime individuale në rajonet me dendësi të ulët.

2.25 Megjithatë, të dhënat empirike në Shqipëri tregojnë se aksesi ndaj tokës përbën një pengesë më të madhe se sa copëzimi i saj. Familjet mesatare kanë 3 parcela. Në fakt, rreth 75 përqind e fermerëve të vegjël kanë më tepër se dy parcela. Eficienca mesatare e familjeve me më shumë se 5 parcela është 35 përqind krahasuar me efiçiencën mesatare prej 24 përqind për familjet me dy ose më pak parcela. (Tabela B.3). Në përgjithësi, sa më i madh të jetë numri i parcelave, aq më i lartë do të jetë rezultati i eficiencës mesatare. (Tabela B.6). Meqënëse, ndryshorja e varur është rezultati i inefiçiencës, një koefiçent negativ nënkupton që ndryshorja (e pavarur) e ul inefiçiencën (rrit efiçiencën). Vëreni që rezultatet tregojnë se një rritje në numrin e parcelave në dispozicion të fermerit, e rrit efiçiencën., çka do të thotë se kjo e sjell fermerin më prane potencialit të prodhimit më të lartë. Nëse do të dominonin efektet negative të copëzimit, atëhere do të kishim një koefiçent pozitiv.

2.26 **Me qëllim që të kuptojmë shkallën e përfitimeve nga zotërimi i sipërfaqeve më të mëdha të tokës, le të shohim Tabelën B.6 e cila tregon se një rritje prej 10 përqind në tokën që mund t'ju vihet në dispozicion fermerëve, do të rrisë vlerën e prodhimit bujqësor deri në 4.4 përqind[7].** Të dhëna shtesë tregojnë se ata fermerë që u konstatua se kishin marë më tepër tokë, pra ata që kishin marrë tokë me qera, i tejkalonin të tjerët në shumë drejtime. Se pari, ata janë më tepër efiçientë (shih Figura 2.10). Eficienca mesatare e atyre që kanë marrë tokë me qira, është 37 përqind dhe është më e lartë se 13 përqindëshi i atyre që kanë dhënë tokë me qira ose 28 përqind për ata që nuk marrin pjesë në tregun rental (autarki). Së dyti, ata gjithashtu kanë edhe fitime më të mëdha. Fitimet totale të atyre që kanë marrë tokë me qira janë dy herë më të larta se fitimet mesatare të të gjithë fermerëve. (Tabela B.7).

[7] Fakti që nuk ekzistojnë të ardhura konstante të shkallës nuk është i papritur. Koeficientët e vlerësuar mund të tregojnë ndryshime në cilësinë e tokës, të cilin nuk arrijmë dot ta kontrollojmë, ose mungesë të inputeve të tjerë plotësues.

Vetëm 21 përqind e familjeve qiramarrëse kanë patur fitime negative krahasuar me 42 përqind të qiradhënësve të tokës. Së fundmi, ata përdorin më shumë inpute moderne si makineri, mjete për blegtorinë etj, ndoshta për të shfrytëzuar ekonomite potenciale të shkallës e cila bëhet e mundur duke punuar më shumë tokë.

**Figura 2.10: Efiçenca Teknike e Pjesëmarrësve në Tregun e Tokës me Qira**




*Burimi*: Vlerësime të Stafit të Bankës Botërore nga të dhëna të sondazhit.

2.27 **Së dyti, një tjetër burim i ineficiencës janë institucionet e jo-kompetente bujqësore. Një institucion i tillë është ai i këshillimit masiv**. Tabela B.2 tregon se fermerët që kanë marrë instruksione mbi cilësinë e tokës si edhe rrugët për ta përmirësuar atë, prej një nëpunësi të këshillimit bujqësor, ishin më efiçientë se fermerët që nuk morën udhëzime të tilla. Megjithatë, të pakta janë ato familje që përdorin apo marrin shërbime të tilla për farërat, prodhimin, dhe insektet dhe akoma më të pakta janë ato që përfitojnë shërbime nga programe për faktorët e prodhimit (plehrat kimike) dhe ndërzimin artificial (programet për blegtorinë). Rezultatet tregojnë gjithashtu se institucionet që ofrojnë të drejta të sigurta mbi pronën po përmirësohen në mënyrë efikase. Për shembull, fermerët që kanë çertifikata pronësie që nga reformat e tokës së vitit 1991, janë në përgjithësi më efiçientë. Përveç kësaj, ata që e kanë trashëguar tokën, e cila është një alternativë për të drejtat e sigurta mbi pronën brenda familjes, demonstrojnë gjithashtu efiçienca më të larta. Të drejtat e sigurta mbi pronën janë të rëndësishme sepse ndërkohë që më shumë se 90 përqind e familjeve pretendojnë se janë pronarë të tokës, numri i familjeve me të drejta të ligjshme mbi tokën e tyre, ndryshon ndjeshëm sipas madhësisë së tokës. Tabela 2.5 tregon se proporcioni i familjeve me të drejta ligjore mbi tokën po bie me rënien e sipërfaqes së tokës.

**Tabela 2.5: Pronësia dhe e Drejta mbi Tokën sipas Sipërfaqes së Tokës**

| Kategoria e Tokës | Pronësia mbi tokën. Pjesa e familjeve (përqind) | Kanë të drejtë ligjore mbi tokën (përqind) |
|---|---|---|
| 0-0.25 Ha | 87 | 47 |
| 0.25-0.6 ha | 98 | 69 |
| 0.60-1.16 ha | 99 | 88 |
| 1.16-11.5 ha | 99 | 92 |

*Burimi*: Vlerësimet e Bankës Botërore nga të dhënat e sondazhit.

2.28 **Përfundimisht, një rritje prej 10 përqind në sipërfaqen e tokës së vaditur e rrit vlerën e prodhimit bujqësor me 0.42 përqind** (Tabela B.6). Vetëm 40 përqind e të gjitha parcelave kanë akses për vaditje dhe dihet se shumica e sistemeve të vaditjeve nuk funksionojnë në nivel maksimal. Rezultatet në Tabelën B.2 tregojnë në njëfarë mënyre se pjesëmarrja në vaditje e rrit efiçencën, pasi koefiçenti është statistikisht i rëndësishëm dhe ka shenjën e duhur. Marrë se bashku, kjo do të thotë se ka premisa për më shumë potencial në përmirësimin e prodhimit bujqësor duke përdorur më shumë vaditje se sa është përdorur deri më sot. Kjo qëndron sidomos kur vaditja është plotësuse e inputeve të tjera si plehra kimike dhe pesticide.

2.29 **Së treti, kufizimet në dhënien e kredive janë burim kryesor inefiçience**. Pak më tepër se një e treta e gjithë familjeve fermere në komunitete raportojnë se kanë akses për kredi nga qeveria apo nga ndonjë bankë private nëse ata do të kërkonin një hua të vogël për të filluar një biznes. Brenda komunnitetit, vetëm 36 përqind e familjeve mund të përfitojnë një hua të tillë me një interes prej rreth 11 përqind. Figura 2.11 tregon se sa më e vogel të jetë sipërfaqja e tokes, aq më e vogël është dhe mundësia për të marë kredi. Vetëm 28 përqind e familjeve në kuintilin më të vogël të madhësisë së tokës kanë akses për këtë lloj kredie krahasuar me 42 përqind në krye të kuintilit. Të dhëna të tjera për kufizimet në kredi mund të gjenden tek Tabela B.2.

**Figura 2.11: Aksesi për Kredi sipas kategorisë së sipërfaqes së Tokës**




2.30 **Rezultatet nga analizat e përcaktuesve të efiçiencës teknike tregojnë se një përpjekje e përbashkët e cila mund të zvogëlonte izolimin, (të reduktojë distancën për tek bankat) dhe të ofronte kredi (nëpërmjet bankave private ose qeverisë), do të ulte inefiçiencën**. Rezultatet tregojnë gjithashtu se burimi i kredive ka shumë rëndësi. Ndërkohë që aksesi për kredi nga bankat private dhe nga qeveria është i shoqëruar me rritjen e efiçiencës, aksesi për kredi brenda komunitetit- çka do të thotë huamarrja nga huadhënës lokalë- e ul efiçiencën (megjithëse koefiçenti nuk është statistikisht i rëndësishëm, shenja e tij tregon që eficienca ulet.) Një arsye që mundësia për kredi në komunitet mund të shoqërohet me inefiçienca në rritje, mund të shpjegohet me faktin që kredia ofrohet mbi bazën e njohjeve lokale dhe nuk i jepet fermerit më efiçient, të cilit pavarësisht nga kjo, i është kufizuar kredia. Një arsye tjetër mund të jetë ajo që normat e interesit mund të jenë kaq të larta sa që shumë fermerë të mirë nuk e kërkojnë një kredi të tillë dhe ata që e kërkojnë një kredi të tillë, janë ata që përpiqen më pak dhe kësisoj nuk do t'ja dalin mbanë.(seleksionimi i kundërt) .

2.31 **Nivelet e ulta të mundësisë për kredi përjashtojnë familjet nga ndërmarrja e aktiviteteve madhore ose e veprimtarive që kanë rrezik të lartë dhe fitim të madh.** Në një studim të kohëve të fundit, Mc.Carthy dhe te tjere (2006), u konstatua se familjet që kanë emigrantë jashtë shtetit, kanë më tepër prona blegtorale dhe alokojnë më tepër tokë për kullota dhe ushqim për bagëtinë, të cilat janë veprimtari plotësuese. Ato janë në gjendje ta bëjnë një gjë të tillë sepse nga njera anë duke pasur anëtarë të familjeve emigrantë puna në familje zvogelohet, prandaj keto familje kanë më pak tendenca që të angazhohen në veprimtari me pune intensive. Nga ana tjetër, anëtarët e familjeve që janë emigrantë dërgojnë remitanca të cilat e ulin kufizimin e likuiditeteve dhe ju japin mundësi familjeve të tyre të zgjedhin veprimtari me më shumë risk por më të përfitueshme dhe që kërkojnë më pak punë intensive. Në të vërtetë studimi tregon se këto familje kishin më shumë të ardhura nga bujqësia dhe të ardhura totale.

2.32 **Së fundmi, migrimi prezanton kufizime të tjera në prodhimin bujqësor**. Migrimi i një anëtari jashtë shtetit ka një efekt negativ në përpjekjet totale dhe për frymë të familjes për punë në bujqësi. Një anëtar më tepër migrant e ul punën në total të familjes në bujqësi si edhe punën për frymë me 640 dhe 118 orë në vit respektivisht. (McCarthy et al. 2007). Konstatimet janë si për përpjekjet në punë të meshkujve edhe të femrave, megjithëse ulja është më e lartë për punëtorët meshkuj. Për më tepër, familjet me migrantë ndërkombëtarë, investojne më pak në teknologji që rrisin produktivitetin dhe që kursejnë kohën sikurse janë plehrat kimike dhe pajisjet e marra hua. Reduktimi në periudhën pas migrimit i punës në zotërim të familjeve me migrantë dhe shkëmbimet midis rreziqeve dhe të ardhurave nga prodhimi bujqësor dhe blegtoral, ka çuar gjthashtu drejt një largimi nga prodhimi i frutave dhe i të lashtave drejt veprimtarive blegtorale si edhe aktiviteteve të tyre komplementare si foragjeret dhe livadhet për familjet me migrantë. (Miluka et al. 2007; McCarthy et al. 2007).

2.33 **Natyrisht që do t'ja vlente të kuptonim me hollësi sektorët ku familjet me emigrantë jashtë shtetit investojnë përpjekjet e tyre tani që ata harxhojnë më pak kohë në bujqësi.** Në mungesë të këtij informacioni, mendojmë se ka disa mundësi. Në bujqësi, ku kemi pak informacion, ne tashmë e kemi parë zhvendosjen e përpjekjeve të tyre drejt prodhimit blegtoral sepse të ardhurat më të larta nga remitancat u krijojne mundësinë për të ndërmarë aktivitete me rrezik më të lartë (prodhimi blegoral konsiderohet si aktivitet me rrëzik më të lartë se prodhimi bujqesor) por gjithashtu me fitim më të lartë. Gjithashtu eshtë shumë e mundshme që gjendja më e mirë në të ardhura krijon mundësi për një kohë të lirë më të madhe. Por nëse fakti që ata punojnë në bujqësi perben nje tregues, ata mund të ndermarrin aktivitetete jo-bujqesore sikurse mund të jete hapja e ndonjë biznesi familjar ose angazhimi në aktivitetet jo bujqësore me pagë, ku që të dyja këto aktivitetete janë më me rrezik por kanë shpërblime më të mëdha dhe mund të përmirësojnë mirëqenien. Në cdo rast, konstatimet sugjerojnë se nga familjet ka një lëvizje të përgjithshme jashtë bujqësisë, çka po lehtësohet më shumë nga migrimi.

2.34 **Pasojat rezultojnë në dy efekte**. Tërheqja nga aktivitetet bujqësore i shtohet kufizimeve të cilat pengojne rritjen e produktivitetit të bujqësisë, duke përfshirë edhe rallësinë e faktoreve të prodhimit sikurse është puna[8]. Por tërheqja e shumë familjeve mundet gjithashtu të ketë edhe rezultate pozitive dhe të përmirësojë produktivitetin bujqësor nëse kjo çon drejt konsolidimit të tokës, drejt uljes së copëzimit si edhe transferimit të saj drejt familjeve më produktive.

[8] Diskutimi nëse fuqia punëtore në bujqësi në Shqipëri është e bollshme apo e mangët është i papërcaktuar, Popullësia e madhe fashatare, familje të mëdha në ferma të vogla, sugjeron një teprice fuqie punëtore në bujqësi. Megjithatë në praktikë vërehet shumë pak punëmarrje dhe shumica e familjeve bazohen në krahun e punës së disponushme brenda familjeve. Mungesa e punëmarrjes dhe përqendrimi në krahun e punës brenda familjes, mund të jetë rezultat ose i moralit të rrezikshëm të lartë, mungesës së kredive për të paguar marrjen në punë ose mungesës së fuqisë punëtore. Duke qenë se shumë familje marrin remitanca që e minimizon problemin e kredisë atëherë morali i rrezikshëm dhe mungesa e kredisë nuk duket të jenë pengesa. Kjo të lë te mendosh mundësinë e mungesën e fuqisë punëtore.

**Konkluzione**

2.35 Me qëllim që të përmirësohen të ardhurat rurale dhe kësisoj edhe standartet e jetesës, do të jetë e domosdoshme të rritet produktiviteti bujqësor. Por sikurse u theksua edhe ne diskutimin e mësipërm, ekzistojnë një sërë pengesash për arritjen e këtyre synimeve. Fermerët shqiptarë përballen me shumë kufizime në lidhje me faktorët e prodhimit, nuk kanë akses për kredi dhe nuk marrin shërbimet e mjaftueshme nga institucionet bujqësore. Megjithatë, çdo progres duhet të fillojë duke lehtësuar disa prej këtyre kufizimeve madhore. Së pari, lehtësimi i aksesit për më shumë tokë nëpërmjet tregut të tokës me qira për fermerët që janë më produktivë, përbën një potencial të madh. Sikurse u tha edhe më lart, të dhënat empirike theksojnë faktin që zotërimi i sipërfaqeve më të mëdha të tokave, ka më shumë rëndësi për përmirësimin e efiçencës se sa konsolidimi. Kjo nuk do të thotë që konsolidimi nuk është i rëndësishëm ose që ai nuk duhet të përbëjë një prioritet. Kjo më tepër tregon se përfitimet nga dhënia e aksesit për më shumë tokë tek fermerët më produktive, nuk janë shfrytëzuar plotësisht. Nuk është e qartë se cili duhet të jetë roli specifik i politikave publike për të rritur veprimtarinë në këtë treg, por dhënia e të drejtave të duhura për pronësinë e tokes, sigurisht që do të ndihmojë. Kjo ka rëndësi sepse të dhënat tregojnë se janë më të shumta ato familje që marrin pjesë në dhënien e tokës me qira të cilat e kanë marë të drejtën e pronësisë së tokës krahasuar me familjet që nuk marrin pjesë. (Tabela B.10). Së dyti, rritja e mundësisë për kredi për më shumë fermerë, do të rrisë gjithashtu produktivitetin rural.

2.36 Së fundmi, është e nevojshme ngritja e institucione të forta për zhvillimin bujqësor. Ofrimi i një shërbimi këshillimor efikas dhe proaktiv mund të jetë shumë i vlefshëm. Kemi vënë re se institucionet që sigurojnë të drejtën e pronësisë, dhe e mbrojnë këtë të drejtë, janë mjaft premtuese. Por edhe më e rëndësishme do të jetë aftësia e këtyre institucioneve për t'ju përgjigjur nevojave të fermerëve që fillojnë veprimtari të reja. Dy nga këto fusha të zhvillimit janë blegtoria dhe prodhimi i frutave. Për shkak të lehtësimit të kufizimeve të likuiditeteve, si dhe mungesës së krahut të punës, shumë fermerë shqiptarë po drejtohen drejt rritjes së gjedhit dhe prodhimit të nënprodukteve komplementare, me qëllim rritjen e të ardhurave totale dhe nga bujqësia. Në fakt, prodhimi blegtoral dhe nënproduktet përbënin thuajse 80 përqind të të gjithe vlerës totale të prodhimit bujqësor të familjeve. (Tabela B.9)). Në vitin 2005, prodhimi i frutave përbënte rreth 6 përqind të vlerës totale të prodhimit bujqësor, ndërkohë që ai po rritet. Megjithatë, pjesëmarrja në prodhimin e pemëve frutore, është rritur ndjeshëm nga 54 përqind e familjeve në vitin 2002 në 83 përqind në vitin 2005. Shitja e pemëve frutore gjithashtu u rrit nga 14 përqind në 18 përqind në të njëjtën periudhë. Rritja e pjesëmarrjes në prodhimin e pemëve frutore dhe në prodhimin blegtoral si edhe në shitjen e tyre, tregon se veprimtari të tilla kanë ofruar mundësi fitimprurëse për familjet bujqësore në Shqipërinë rurale. Ne konstatojmë se si të ardhurat nga të korrat, dhe të ardhurat totale për familjet bujqësore janë të lidhura pozitivisht dhe ndjeshëm me sipërfaqen e tokës së kultivuar me pemë frutore dhe me zotërim të gjedhit. Me qëllim që Shqipëria të shfrytëzojë avantazhet e saj krahasuese në këto fusha, roli i institucioneve komplementare për sigurinë e ushqimit dhe transferimin e teknologjisë është thelbësor.

# *KREU 3:* MIGRIMI DHE MIRËQENIA OSE SHKËPUTJA NGA VARFËRIA

*Në kuptimin e plotë të fjalës Shqipëria ështe një vend në lëvizje. Migrimi i saj i brendshëm dhe i jashtëm në 15 vitet e fundit, ka qenë masiv si në drejtim të shkallës edhe ndikimit. Rreth 20 përqind e të rriturve janë shpërngulur brenda vendit dhe një në tre familje ka një migrant jashtë shtetit. .Më shumë se 65 përqind e këtyre familjeve, marrin remitanca të cilat kanë patur një ndikim të rëndësishëm në konsum, në ofertën e punës dhe në investime. Familjet me migrantë ndërkombëtarë deklarojnë përmirësim të kushteve të jetesës mbi bazën e një vlerësimi subjektiv të statusit të varfërisë, kanë konsum më të lartë dhe kanë më shumë premisa të investojnë për të filluar biznesin e tyre. Për shembul,l një vit shtesë i migrimit të përkohshëm ndëkombëtar shoqërohet me një rritje prej 5 përqind të konsumit real për frymë dhe ndikimi është edhe më i madh për migrimin e përhershëm ndërkombëtar. Të dhënat e paraqitura tregojnë se migrimi shpjegon pjesërisht ndryshimet e vërejtura në varfëri. Por migrimi masiv jashtë shtetit duket se ka patur edhe disa pasoja negative, në faktin që familjet e emigrantëve duket se investojnë më pak në arsim dhe punojnë më pak. Ky ndikim vihet re veçanërisht në zonat rurale.*

3.1 **Sikurse është dokumentuar gjerësisht në studimet e mëparshme, Shqipëria është një vend në lëvizje me nivele masive si në migrimin e brendshëm edhe në atë ndërkombëta**. Lëvizjet e mëdha të brendshme janë më tepër nga zonat rurale në ato urbane ndërsa migrimi ndërkombëtar tradicionalisht është drejtuar tek vendet fqinjë sikurse Greqia dhe Italia. Për më tepër, një prirje më e re është shfaqur ndaj vendeve më të largëta por më të dëshirueshme si destinacione, si në Europë ose në Amerikën e Veriut. Duke u nisur nga natyra ekstremisht dinamike e fenomenit, objektivi kryesor i këtij dokumenti është të përditësojë dijet tona dhe njohjen e migrimit në Shqipëri duke përdorur studimin më të fundit mbi familjet. Veçanërisht kjo analizë do të përpiqet të japë përgjigje për disa çështje që diskutohen në dialogun aktual të politikës mbi migrimin në Shqipëri. A po ndryshon përbërja demografike dhe socio-ekonomike e migrantëve me kalimin e kohes? A po pakësohen migrimi dhe fluksi i remitancave? A po ndodh një fenomen i ri i të rikthyerve dhe cila ështe përbërja e tyre? Cili ështe ndikimi i llojeve të ndryshme të migrimit në mirëqenie? Duke u nisur nga hapat e mëdhenj në uljen e varfërisë në këto vitet e fundit, cili është roli i migrimit në këtë proces dhe a po ndihmon migrimi rajonet më të varfëra të marrin veten?

## A. MADHËSIA DHE FORMA E MIGRIMIT

### *Migrimi i Brendshëm*

3.2 Gjatë 15 viteve të fundit, rreth 20 përqind e të rriturve janë shpërngulur brenda vendit. Kjo do të thotë se rreth 450,000 persona jetojnë aktualisht në një vend të ndryshëm nga ai ku kanë pasë jetuar në vitin 1990. Nëse i numërojmë të shpërngulurit që prej ditës së lindjes atëhere 1 në 3 të rritur është shpërngulur brenda vendit. Nëse nuk janë paraqitur ndryshe, rezultatet kryesore në pjesën tjetër të kreut do të trajtojnë flukset e migrimit të vërejtura qysh më 1990 sepse para këtij viti migrimi ose ishte rreptësisht i kontrolluar ose plotësisht i ndaluar dhe faktikisht jo ekzistent. Rreth 16 përqind e familjeve në mbarë vendin kryesohen nga persona që janë shpërngulur që në vitin 1990. Në shumicën e rasteve, janë individët ata që lëvizin dhe jo e gjithë familja. Për shembull vetëm 5 përqind e familjeve lëvizën së bashku në të njëjtin vit midis viteve 1990 dhe 2004.

3.3 Tendencat tregojnë se migrimi i brendshëm u rrit midis viteve 1990 dhe 1998 dhe pastaj ra. Ky migrim kulmon me vitet që vijuan menjëherë pas rënies së piramidave- ku proporcionalisht më shumë njerëz u shpërngulën drejt Tiranës- duke reflektuar ndoshta përdorimin e gjerë të migrimit të brendshëm si një strategji në përgjigje të krizës të shkaktuar nga kolapsi i skemave piramidale. Qysh në vitin 1998, fluksi është ulur ndjeshëm dhe duket se është stabilizuar në afërsisht 20,000 persona në vit. (Figura 3.1).

**Figura 3.1: Fluksi i Migrantëve të Brendshëm sipas Viteve**




3.4 Nuk të habit fakti që shumica e migranteve të brendshëm që prej vitit 1990 vijnë nga zonat rurale. Rreth 2 në 3 migrantë (65.3 përqind ose 291,000 persona ), janë shpërngulur nga zonat rurale, megjithëse popullsia rurale ishte rreth 56 përqind dhe në rënie (ajo përbënte 52 përqind në vitin 2005) gjatë asaj periudhe. Megjithatë, çuditërisht rreth 40 përqind e atyre individëve janë rivendosur brenda zonave rurale, shpesh nga një rajon në tjetrin (Tabela 3.1). Përsa i takon destinacionit, flukset janë të shpërndara në mënyrë të barabartë, ku rreth një e treta e numrit total të migrantëve shkojnë në Tiranë, në qytete të tjera ose në zona rurale, respektivisht. Në vitet e fundit pjesa e migrantëve të brendshëm që shkojnë drejt Tiranës, është rritur më tej. Midis viteve 2002 dhe 2004, pothuajse 4 nga dhjetë migrantë të brendshëm kanë lëvizur drejt bashkisë së Tiranës.

**Tabela 3.1: Migrimi i Brendshëm sipas Vendndodhjes së Origjinës (PREJ NGA) dhe Destinacionit (PËR KU); 1990-2005**

| | | PËR KU | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | Tirana | Të tjera urbane | Rural | Total |
| ***PREJ NGA*** | Tirana | 0.4 | 0.1 | 0.1 | 0.6 |
| | Urbane të tjera | 19.4 | 7.8 | 6.9 | 34.1 |
| | Rural | 13.9 | 26.0 | 25.4 | 65.3 |
| | Total | 33.7 | 34.0 | 32.4 | 100 |

3.5 **Tirana nuk ka mbetur gjithmonë vendi i preferuar si destinacion për shumicën e migrantëve të brendshëm ruralë.** Figura 3.2 tregon destinacionin e migrantëve të brendshëm në kohë. Së pari, ka një rënie të pritshme të migrantëve nga zonat rurale në ato rurale. Së dyti, para rënies së skemës së piramidave, shumica e migrantëve ruralë shkuan ose në zona të tjera urbane ose në destinacione të tjera rurale, por jo në Tiranë. Këto zona të tjera urbane u preferuan nga rreth 50 përqind migrantë të tjerë të brendshëm qysh në vitin 1999. Së treti, që atëhere migrimi i brendshëm nga zonat rurale në ato urbane është ulur mjaft. Gjithashtu, migrimi drejt zonave të tjera urbane dhe rurale ka rënë shumë më tepër.(në rreth 2000 persona në vit), kështu që Tirana është tashmë desitnacioni për më shumë se një të tretën e migrantëve të brendshëm.

**Figura 3.2: Migrantët e Brendshëm nga zonat rurale sipas Zonës së Destinacionit**




**Figura 3.3: Migrantët e Përhershëm sipas Vendndodhjes së Familjes Origjinë, 1991-2004**




3.6 Një vështrim në flukset e brendshme midis rajoneve[9] tregon se në mënyrë jo proporcionale, shumica e migrantëve të brendshëm vijnë nga rajonet më të varfëra dhe më të largëta Malore, megjithëse janë më të ulët në vlerë absolute,. Rajoni Malor përfaqëson vetëm 11 përqind të popullatës në total, por ai përbënte pothuajse 30 përqind të totalit të migrimit të brendshëm qysh më 1990. Rreth çereku i individëve të lindur në zonën Malore deklarojnë se janë shpërngulur brenda vendit, ku më shumë se gjysma aktualisht jetojnë në Tiranë ose në zonat rurale të rajonit Qendror, ku presupozohet të jenë përqëndruar pranë Tiranës.(Tabela C.2). Ja vlen të përmendim se në periudhën pas rënies se piramidave, një proporcion madje më i madh i migrantëve të brendshëm, (35.1 përqind) erdhi nga rajoni Malor. Në të kundërtën, dhe jo cuditërisht, probabiliteti i migrimit të brendshëm nga rajoni në gjendje më të mirë ekonomike, nga zona Bregdetare, dhe nga Tirana, është shumë më i ulët. (Tabela C.4) Konsideruar nga numrat, zonat rurale të rajonit Qendror, janë origjina e fluksit më të madh të migrantëve të brendshëm (rreth një e treta), ku një pjesë e madhe lëvizin drejt të njëjtit rajon, për në qytete ose në zona të tjera rurale.

## *Migrimi Ndërkombëtar*

3.7 Me qëllim që të përshkuajmë strukturën e migrimit ndërkombëtar, duhet bërë një dallim midis migrimit të *përhershëm* dhe atij të *përkohshëm,* ku migrantët e përhershëm janë të gjithë ish anëtarë të

[9] Për qëllime modelimi, vendi është ndarë në katër rajone, të përcaktuar sipas vijave agro-klimatike dhe socio-ekonomike, respektivisht, rajonet Bregdetare, Qendrore, Malore, plus Bashkinë e Tiranës.

familjeve që aktualisht jetojnë jashtë shtetit, me një fjalë nuk jetojne më në familje.[10] Për këta individë, informacioni u morr nëpërmjet një të afërmi i cili aktualisht jetonte në familje, dhe përfshin karakteristika bazë demografike dhe socio-ekonomike të migrantit si edhe informacion për çështje të migrimit aktual dhe të mëparshëm. Nga ana tjetër, migrantët e përkohshëm janë të gjithë anëtarë të familjeve aktuale të cilët kanë qenë jashtë shtetit për të paktën një muaj qysh prej 1990 por janë kthyer dhe tani jetojnë në familje.

3.8 Në 15 vitet e fundit, migrimi i përhershëm ndërkombëtar jashtë Shqipërisë ka qenë masiv. Pothuajse një në tre familje, (34 përqind), ka të paktën një ish anëtar që aktualisht jeton jashtë shtetit dhe rreth 1 në 2 (50 përqind) nga këto familje, ka më shumë se një anëtar. (Tabela 3.2). Numri i madh i familjeve me më shumë se një migrant sugjeron ekzistencën e efektit të rrjetit familjar, ku migrimi i vëllait apo motrës, lehtëson më tej migrimin brenda anëtarëve të mbetur të familjes. Nga pothuajse një milion persona që janë shkëputur nga familjet e tyre të origjinës, që prej vitit 1990, rreth gjysma e tyre jeton tani jashtë shtetit. Nga këta, rreth 80 përqind janë të ndarë në mënyrë të barabartë midis Greqisë dhe Italisë, ndërsa pjesa tjetër prej 20 përqind kanë migruar në vende të tjera Europiane, ose me tujte, në Amerikën Veriore (Tabela 3.3).

**Tabela 3.2: Numri i Familjeve sipas Numrit të Migrantëve jashtë Shtetit**

| | *# e familjeve* | *%* | **kum.** |
|---|---|---|---|
| 0 | 483,517 | 65.9 | 65.9 |
| 1 | 128,271 | 17.5 | 83.4 |
| 2 | 73,937 | 10.1 | 93.4 |
| 3+ | 48,135 | 6.6 | 100 |
| Total | 733,860 | 100 | |

**Tabela 3.3: Destinacioni i të shkëputurve që largohen nga Familjet Origjinë**

| | **# i individëve** | **%** | ***Akum.*** |
|---|---|---|---|
| Shqipëri | 522,692 | 53.7 | 53.7 |
| Greqi | 197,381 | 20.3 | 74.0 |
| Itali | 179,587 | 18.4 | 92.4 |
| Më tej | 74,069 | 7.6 | 100 |
| Totali | 973,729 | 100 | |

[10] Sondazhi ka mbledhur informacion për të gjithë fëmijët mbi 15 vjeç të kryetarit të familjes dhe/ose të bashkëshortes, si edhe për bashkëshoritn/ bashkëshorten nëse ai/ ajo nuk jeton më në familje por jeton jashtë shtetit. Shumica dërmuese e këtyre shkëputjeve, i përkasin kategorisë së parë, me fëmijët që përbëjnë rreth 98 përqind të numrit në total.

3.9 Struktura e migrimit ndërkombetar është e ngjashme me atë të konstatuar për migrimin e brendshëm. Në mënyrë të veçantë, ka një dyndje të migrimit ndërkombëtar pas rënies se piramidave, por kjo filloi të bjerë në vitin 2000. Sic paraqitet në Figurë 3.3, numri i migrantëve të përhershëm ndërkombëtarë u rrit më shumë se dy herë pas rënies së skemave piramidale, arriti kulmin në vitin 2000 me rreth 50,000 migrantë të rinj në vit dhe më pas ka ardhur duke u zvogëluar në mënyrë të qëndrueshme.11 Sikurse pritej, destinacioni kryesor i migrantëve ndërkombëtarë është Greqia dhe Italia. Tabela 3.3 tregon se 46 përqind e të gjithë migrantëve të përhershëm, janë vendosur jashtë shtetit dhe pothuajse 83 përqind (39 nga 46 përqind) shkojnë ose në Greqi ose në Itali. Është mjaft domethënëse rritja e madhe e numrit të emigrantëve drejt Greqisë, në dy vitet para programit të parë të legalizimit të dokumentave në vitin 1998 dhe duke përkuar me vitet menjëherë pas rënies se piramidave, pasuar nga një rënie drastike në vitin 1999, kur proporcioni i migrimit në Itali dhe më tej ishte në kulmin e vet. (Figura C.3). Për personat që largohen nga Tirana, një në 4 do të zgjedhë një destinacion të ndryshëm nga Greqia dhe Italia. Në të kundërtën, një migrant ndër 4, nga zona të tjera urbane është larguar për në Itali. Sikurse shihet, një numër i madh i migrantëve që shkojnë në Itali janë nga qytetet bregdetare si Vlora dhe Durrësi. Midis migrantëve të përhershëm, nga zonat urbane në rajonin Malor, drejt Italisë ka ikur një përqindje më e lartë se drejt Greqisë. Megjithatë, duhet theksuar se sikurse tregohet edhe në tabelën e mëparshme, numri absolut i migrantëve nga qendrat urbane të rajonit Malor është disi i vogel. Së fundmi, mbi 70 përqind e të shkëputurve nga rajoni malor kanë qëndruar brenda Shqipërisë.

3.10 **Mbi 55 përqind e migrantëve ndërkombetarë të perhershëm, vijnë nga familje rurale**. Në vitet më të fundit, ky raport është rritur, kështu që nga viti 2002, migrimi nga zonat rurale përbënte rreth dy të tretat e totalit të migrimit. (Figura 3.4). Pjesa më e madhe e migrantëve ndërkombëtarë, e ka origjinën nga rajoni Bregdetar, (44.3 përqind), pasuar nga rajoni Qendror (39 përqind). Vetëm 6 përqind e totalit të migrantëve të përhershëm që prej vitit 1990, erdhën nga rajoni Malor, ndërsa pjesa tjetër prej 10 përqind erdhi nga Tirana.12. Megjithëse, përfaqësojnë më shumë se gjysmën e totalit të migrantëve, të rriturit nga zonat rurale kanë një tendencë më të ulët për të migruar jashtë shtetit si migrantë të përhershëm në krahasim me të rriturit nga zonat urbane. (42 vs. rreth 53 përqind; kolona e fundit në Tabelën C.8 Midis gjithë të shkëputurve, personat nga zonat urbane të rajonit Bregdetar, kanë prirje më të madhe për të migruar jashtë shtetit (se sa të largohen nga familja por të mbeten në Shqipëri), ndërsa njerëzit nga zonat më të varfëra Malore, kanë prirje më të ulët me një frekuencë prej 28 përqind.

3.11 Megjithëse, numri i migrantëve ka rënë në mënyrë të konsiderueshme që prej fundit të viteve 1990, fluksi i migranteve të rinj nga zonat Malore, është rritur në mënyrë të konsiderueshme që prej vitit 2000. Figura 3.5 tregon tendencat në numrin e migrantëve të përhershëm.Vërejmë se rajoni Malor ështe pjesa e vetme e vendit ku ne konstatojmë një tendencë në rritje në vazhdimësi, duke u thelluar në vitet e fundit dhe duke arritur nivele të krahasueshme me ato të rajonit Bregdetar. Në tërësi, pavarësisht nga fluksi në rënie i viteve të fundit, në vijim të një migrimi në pikun e vet në vitin 1999, në mënyrë proporcionale më shumë njerëz janë duke migruar tani në destinacione të tjera të ndryshme nga Greqia dhe Italia, të tilla si Mbretëria e Bashkuar dhe Gjermania, si edhe Amerika e Veriut. Për rrjedhojë, duke ndjekur vendosjen e rrjeteve të migrantëve jashtë shtetit, migrimi po bëhet më pak i vështirë, duke i lejuar njerëzit që të udhëtojnë në distanca më të largëta në destinacione më të preferuara dhe për t'u vendosur atje (Tabela C.2).

---

[11]Në këtë shifer dhe në shifrat qe vijojnë, viti tregon vitin e migrimit të parë të migrantëve të perhershëm. Kështu në raste të migrimeve të shumta, para vendosjes jashtë shtetit, ne përdorim periudhen kohore të levizjes së parë.Megjithatë, në shumicën e rasteve, migrantët e përhershëm deklaruan vetëm një episod migrimi. Gjjithashtu numrat më të vegjel në fillim të viteve 1990, reflektojnë faktin që një numër më i madh i këtyre migrantëve janë rikthyer dhe rivendosur në Shqipëri, sikurse reflektohet në numrat e larte të migrantëve të përkohshem në vitet e hershme të tranzicionit.(shiko seksionin tjeter.)

[12] Meqënëse nuk kemi informacion për rezidencen aktuale në kohën e largimit, ne përdorim rezidencën e familjes origjinë për të percaktuar vendin e origjinës së episodit të migrimit.

**Figura 3.4: Fluksi i Migrantëve të përhershëm sipas Rajonit, 1991-2004**




**Figura 3.5: Numri i Migrantëve të përhershëm sipas Rajonit, 1991-2004**




3.12 Ndryshe nga migrimi i përhershëm, forma e migrimit të përkohshëm është bi-modale, ndërsa destinacioni ështe pothuajse ekskluzivisht Greqia. Afërsisht 13 përqind e personave të rritur raportojnë se kanë kaluar të paktën një muaj jashtë shtetit gjatë 14 viteve të fundit, nga të cilat rreth gjysmat (53 %) janë kryefamiljarë (Tabela C.11). Në nivel familjar, rreth 1 në 3 familje në Shqipëri, ka patur të paktën një episod migrimi të përkohshëm që prej vitit 1990.(Tabela C.12a-b).

3.13 Pjesa më e madhe e këtyre familjeve, (82%) kanë patur vetëm një anëtar jashtë shtetit. Kjo tregon se ndryshe nga migrimi i përhershëm, migrimi i përkohshëm është kryer në përgjithësi vetëm nga një anëtar i familjes, kryesisht nga kryefamiljari. Ndryshe nga migrimi i përhershëm, migrimi i përkohshëm karakterizohet nga dy kulme ku fluksi i parë korrespondon me periudhën menjëherë pas hapjes se kufijve. Dyndja e dytë korrespondon me rënien e menjëhershme të skemave piramidale. Pas çdo episodi, një dyndje e madhe për jashtë shtetit pasohej nga një numër i madh i njerëzve që riktheheshin. Krahas kësaj, shumica e migrantëve të përkohshëm shkuan në Greqi. (Figura 3.6). Gjithashtu, në kontrast me migrimin e përhershëm, migrantët e përkohshëm, janë pothuajse ekskluzivisht meshkuj, faktor që shpjegon si dominimin nga meshkujt të valës së parë të migrimit në fillim të viteve 1990, ashtu edhe punën sezonale/qarkulluese në migrim, kryesisht në vendin fqinjGreqi.

**Figura 3.6: Fluksi i emigrantëve të Përkohshëm sipas Gjinisë**




**Figura 3.7: Fluksi Migrantëve të Përkohshëm (që migrojnë për herë të parë) sipas Destinacionit**



3.14 Pjesa më e madhe e migrantëve të përkohshëm ishte nga zonat rurale, kryesisht nga zonat Qendrore të rajonit pranë kufijve me Greqinë. Të gjitha zonat patën rritje të valëve të migrimit në periudhat pas hapjes së kufijve dhe rënies së skemave piramidale. Ky pik i fundit përkon gjithashtu edhe me programin e legalizimit të dokumentave në Greqi në vitin 1998, i cili mund të shpjegojë edhe një pjesë të rritjes së migrimit në vitet 1997-98. Në fakt, vërejmë se shumica e fluksit të migrantëve të vitit 1998, vjen nga zonat rurale të zonës Qendrore, burimi i parë i migrimit për në Greqi.(Figura 3.8 dhe Figura 3.9).

| **Figura 3.8: Fluksi i parë i Migrantëve të përkohshem sipas vendndodhjes së familjes origjinale** | **Figura 3.9: Fluksi i parë i Migrantëve të përkohshëm sipas rajonit të rezidencës së familjes origjinë** |
|---|---|
|  |  |





## B. KARAKTERISTIKAT E MIGRANTËVE

3.15 Migrantët e brendshëm janë më të rinj dhe më të arsimuar. Migrantët e brendshëm mesatarisht janë 5 vjet më të rinj se jo migrantët. Ata gjithashu janë shumë më të arsimuar dhe janë kryesisht femra. (Tabela C.13). Kryefamljarët që janë shpërngulur brenda vendit që prej vitit 1990 janë më pak të varfër, më të arsimuar dhe ka më shumë mundësi të jenë të martuar. E ndoshta jo çuditerisht ata kanë më shumë premisa të jenë të papunë çka reflekton faktin që ata mund të kenë braktisur një punë si të mbikualifikuar në bujqësi për të bërë përpjekje (të parealizuara) për të gjetur një punë më të mirë në destinacion.

3.16 Migrantët e përhershëm ndërkombëtarë janë gjithashtu më të rinj dhe më të arsimuar por në këto vitet e fundit u janë shtuar persona më të moshuar dhe gra. Sikurse tregohet në Figurën 3.10 dhe në Figurën 3.11, migrantët e përhershëm janë në përgjithësi më të rinj, janë meshkuj dhe pak më të arsimuar se të rriturit mesatarë që ndodhen në Shqipëri. Ka gjithashtu mundësi që ata të vijnë nga familje me një kryefamiljar ku kryefamiljari është femër.13 Sikurse pritet, migrantët vijnë nga familje më të mëdha, (në 1990) të cilat gjithashtu për shkak të migrimit, tani janë shumë më të vogla. Po kështu, familjet me migrantë në përgjithesi janë më pak të arsimuara, pjesërisht për faktin që anëtarët më të arsimuar të familjes janë në emigracion. Gjithashtu, familjet e migrantëve përbëhen nga anëtarë më të vjetër në moshë, pjesërisht si rezultat i migrimit të anëtarëve më të rinj të familjes. Së fundmi, familjet me një migrant janë gjithashtu në gjendje më të mirë ekonomike, sikurse ilustrohet nga treguesit e ndryshëm të varfërisë (Tabela C.14).

[13] Nëse konsiderojmë vetëm fëmijët jashtë shtetit për të klasifikuar familjet e migrantëve, sikurse pritet, proporcioni i familjeve me kryefamljare femra bie në 13 përqind, krahsuar me 18 përqind në tabelën e mësipërme e cila gjithashtu merr parasysh bashkëshortët migrantë

3.17 Megjithatë, në këto vitet e fundit, po migrojnë persona më të moshuar dhe më shumë gra. Që të dyja tendencat mund të kenë efekte të konsiderueshme përsa u takon remitancave në të ardhmen si rrjedhojë e potencialeve të ulta të fitimit nga ana e këtyre grupeve. Një shpjegim i mundshëm i këtyre tendencave është fluksi në rritje i migrantëve për bashkim familjar në vijim të programeve të legalizimit të dokumentave në vendet e destinacioneve kryesore.

**Figura 3.10: Raporti Mashkull-Femër për migrantëve të përhershëm që migrojnë për herë të parë**




**Figura 3.11: Mosha Mesatare në kohën e Migrimit sipas gjinisë**
.




3.18 Për më tepër, një numër më i madh i personave më pak të arsimuar po largohet për emigrim të përhershëm në këto vitet e fundit. Dy panelet e fundit të Figurës 3.12 tregojnë arritjet arsimore të migrantëve të përhershëm sipas destinacionit. Rënia në nivelet arsimore nuk lidhet me fluksin të migrantëve të përhershëm që largohen nga Tirana dhe shkojnë në destinacione përtej Greqisë dhe Italisë. Pikërisht dhe vetëm për këtë fluks të veçantë migrantësh, nivelet arsimore kanë qëndruar të pandryshuara gjatë viteve, nivele që qëndrojnë shumë më lart se të migrantëve të tjerë që shkojnë në Greqi dhe në Itali. Është interesant fakti që emigrantet femra janë mesatarisht më të arsimuara se meshkujt veçanërisht në vitet 1990 (Figura 3.12 paneli 1).

**Figura 3.12: Tendencat në nivelin Arsimor të Migranteve të përhershëm, sipas Gjinisë, Destinacionit kryesor, dhe Origjinës (1991-2004)**



3.19 Sikurse është konstatuar për flukset e përhershme, nivelet arsimore të migrantëve të përkohshëm janë përkeqësuar me kalimin e kohës, ndërkohë që mosha mesatare e migrantëve është rritur. Mosha e migrantëve të përkohshem arriti kulmin në vitet menjëherë pas rënies se skemave priamidale, e cila sugjeron një intensifikim të faktorëve nxitës, duke shkaktuar një migrim kandidatësh jo tipikë. Megjithatë, tendencat në kohë tregojnë një grup të moshuar dhe më pak e arsimuar, mesatarisht, migrantët e përkohshëm, afatshkurtër, janë kryesisht meshkuj më të rinj, të martuar, pak më të arsimuar, nga familje me kryefamiljar mashkull dhe nga familje më të mëdha. (Tabela C.15 dhe Figura 3.13-Figura 3.14). Mesatarisht ata kanë migruar rreth 4 herë në një periudhë prej 14 vitesh në një total prej 26 muajsh.

| **Figura 3.13: Arsimimi i migrantëve të Herës së parë (numri i viteve të arsimit)** | **Figura 3.14: Mosha e migrantëve të herës së parë** |
|---|---|
|   |   |

3.20 Seksionet e mëparshme kane treguar një sërë faktesh për migrimin shqiptar. I pari tregon se valët e migracionit që prej vitit 1990, kanë qenë masive. I dyti është që procesi ka qenë jashtëzakonisht dinamik në sensin që tendencat e konstatuara, kanë qenë rezultat i ndryshimeve në faktorët nxitës dhe frenues, të cilët brenda një harku kohor të shkurtër prej mbi një dekade, e kanë ndryshuar në mënyre dramatike profilin demografik të vendit. Nga perspektiva e një politike, është e dobishme të kuptojmë jo vetëm faktorët që ndikojnë në vendimin për të migruar por edhe ndikimin e migrimit në një sërë rezultatesh si mirëqenia, formimi i kapitalit njerëzor etj. Ky seksion hedh vështrimin tek vendimi për të migruar dhe eventualisht për t'u kthyer, duke përdorur modele të funksionit të rrezikut të kushtëzuar (Kutia 3.1). Ai arrin në tre konkluzione.

## C. PËRCAKTUESIT E MIGRIMIT NDËRKOMBËTAR

3.21 Së pari familjet specializohen mbi llojin e migrimit në bazë të rrjeteve të organizuara mirë si edhe në bazë të profilit demografik të familjeve. Sa më i madh që të jetë rrjeti i migrantëve në vendin pritës, aq më e lartë është probabiliteti dhe më e shkurtër eshtë koha për të migruar. Kjo është veçanërisht e vërtetë për migrimin ndërkombëtar të përhershëm. Megjithatë koefiçenti i destinacionit italian për migrimin e përkohshëm sugjeron se familjet me rrjete të mirëvendosura në Itali, kanë më pak gjasa për të dërguar migrantë të përkohshëm në Greqi. Specializimi është gjithashtu rajonal. Individët nga rajonet Bregdetare dhe Qendrore, veçanërisht nga zonat urbane, kanë më shumë premisa për të migruar në mënyrë permanente, ndërkohë që ata nga zonat Malore kanë më pak premisa për të migruar krahasuar me individët nga Tirana, e cila është dhe shtresa e referencës, (Tabela C.16).

**Kutia 3.1: Modelet e Rrezikut të Kushtëzuar**

Në këtë kuadër, vendimi për të migruar (ose për t'u kthyer) në kohë është i kushtëzuar nga ngjarjet e kaluara dhe i ndikuar nga ndryshimi i kushteve me kalimin e kohës. Ky kuadër krijon mundësi për të modeluar rolin që luan ndryshimi i kushteve për rritjen apo zvogëlimin e migrimit midis individëve me karakteristika të veçanta. Vendimi i individit për të migruar jashtë shtetit mund të modelohet si një model me kohëzgjatjeje prej një periudhe të vetme kohore, me variabla përcaktues që ndryshojne në kohë, model i cili bazohet në një funksion të rrezikut të formës logaritmik-logjistik. Në këtë kontekst periudha identifikohet si një numer vitesh midis vitit të parë të ekspozimit të individit ndaj "rrezikut të migrimit" dhe vitit aktual të migrimit. Individët që nuk kanë migruar deri në vitin 2005, trajtohen si të censuruar në mënyrë të drejtë, duke treguar se ata janë ende në rrezik për migrim, dhe periudha e tyre e para-emigracionit mund të mbarojë në një datë të pakonstatuar në të ardhmen.

Janë llogaritur tre modele të veçanta : se pari, një model ku nuk bëhet dallim midis llojeve të migrimit. Pastaj periudhat për migrantët e përhershem dhe të përkohshëm ndahen për të testuar hipotezën se proceset nxiten nga faktorë të ndryshëm. Me interes të veçantë në Shqipëri janë një numur ndryshoresh ku falë natyrës se tyre të luhatshme në kohë, vlerësimet e bëra janë të dallueshme. Në mënyrë të veçanë modelet përfshijnë dy ndryshore të luhatshme në kohë të cilat matin përbërjen e krijimit të rrjeteve të migrantëve në çdo vit qysh në vitin 1990 në Greqi, në Itali dhe më tej. Konstatohet se vendimi për të migruar çdo vit, do të varet nga rrjeti specifik në çdo vend në atë kohë, ku rrjete më të mëdha e bëjnë migrimin më të mundshëm. Gjithashtu përfshihen një sërë ndryshoresh të luhatshme në kohë të cilat tregojnë ekspozimin e familjes ndaj llojeve të ndryshme të tronditjeve. Tek tronditje specifik përfshihet rënia e firmave piramidale, humbja e pronës, humbja e punës apo personit që mban familjen ekonomikisht, si edhe sëmundje dhe vdekje në familje. Modeli gjithashtu paraqet edhe një ndryshore dummy epoch për periudhën 1999-2004 për të kapur efektet e programit të legalizimeve në Greqi dhe në Itali. Më në fund bëhet edhe kontrolli i një sërë tipareve demografike dhe socio-ekonomike në nivel personal dhe familjeje. Për të testuar fuqinë e vlerësimit ndaj specifikimit funksional, të njëjtat modele vlerësohen duke supozuar (përdorur) formën funksionale te rrezikut Ëeibull. Ndryshe nga specifikimi i Ëeibull, specifikimi log-logjistik është një formë më fleksibël pasi ajo nuk imponon një norëm rreziku monotonik. Këtu raportohen vetëm vlerësimet e një specifikimi më fleksibël të logjistikës logaritëm. Megjithatë, rezultatet Ëeibull janë cilësisht të ngjashme si përsa u takon shenjave edhe madhësisë se koefiçentëve.

Në të njëjtën mënyrë dhe vetëm për migrantët, bëhet vlerësimi i episodeve të migrimit nga një model i dytë në të cilin periudha e migrimit eshtë e barabartë me numrin e viteve midis episodit të parë (largimit) dhe të fundit (kthimi) të migrimit. Si e tillë, periudha është një tregues matës i ciklit të migrimit të individit. Sërish disa migrantë janë ende jashtë shtetit dhe mund të vendosin të kthehen në një ditë të pa-vëzhgueshme në të ardhmen. Ndaj këto vëzhgime trajtohen si të censuruara. Ndryshore e përdoruar në këtë model janë të njëtja sikurse në modelin e parë, me përjashtim të sa më poshtë. Nga njera anë, tani merret parasysh tërësisht vendi i destinacionit pasi çdo vend paraqet faktorë të ndryshëm tërheqjeje. Më në fund përfshihet edhe puna e migrantit gjatë episodit të fundit të migrimit, ku si grup reference përdoret të qenët i papunë. Kësisoj, punësimi në vende më të mira pune mund të konsiderohet si një integrim më i mirë në vendin pritës e kështu me më pak premisa për t'u rikthyer.

3.22 Nuk të **habit** fakti që femrat më të moshuara nga rajonet Malore kanë më pak gjasa për të migruar, qoftë përkohësisht ose përgjithmonë. Disponibiliteti i meshkujve në moshë pune e bën mjaft më të mundur migrimin e përhershëm, ndërsa prezenca e fëmijëve në shtëpi synon ta vonojë atë. Në të kundërtën, ndikimi mbi migrimin e përkohshëm është faktikisht i kundërt. Kjo sërish sugjeron që migrimet e përkohshëm dhe të përhershëm, janë strategji zëvendësuese të ardhurash dhe përbërja e familjes para migrimit, kontribuon pjesërisht në vendimin për llojin e migrimit që do të ndërmerret. Së

fundmi, individët që filluan të jenë "në rrezik," më vonë se sa në vitin 1990, çka do të thotë individët më të rinj, kanë më shumë premisa për të migruar në mënyrë permanente dhe më pak premisa për migrim të përkohshëm, se sa individët që i ishin ekspozuar mundësisë për migrim qysh në vitin 1990.

3.23 **Së dyti, efekti i skemave piramidale, ishte si i madh edhe i përkohshëm**. Familjet u pyetën në se u goditen apo jo nga një sërë tronditjesh dhe katër prej këtyre, (skema piramidale, humbja e pronës, humbja e vendit të punës, si edhe semundje apo vdekje e një anëtari të familjes) u përfshinë në vlerësim. Sikurse pritej, efekti i humbjes së menjëhershme të kursimeve dhe si rrjedhojë humbje të të ardhurave të përhershme nga skemat piramidale, shkaktoi një eksod të madh dhe shpejtoi kohën për të migruar. Megjithatë duhet theksuar se kriza e menjëhershme dhe ndoshta e papritur është statistikisht e rëndësishme vetëm për migrimin e përkohshëm. Humbja e punës shkakton migrim të përkohshëm dhe të përhershëm. Shenjat e kundërta tregojnë se disa familje i përgjigjen humbjes së vendit të punës duke e shpejtuar kohën e migrimit (migrimi i përkohshem), ndërsa të tjerat e vonojnë kohën e migrimit ( migrimi i përhershëm), ndoshta për shkak të kufizimeve të likuiditeteve.

3.24 **Së treti, individëd më shumë të arsimuar ata në punëra të kualifikuara, kanë më pak premisa për t'u rikthyer ndonjëherë.** Në përgjithësi, te pasurit një vend pune e vonon rikthimin por sikurse pritet, lloji i punës gjithashtu ndikon edhe dëshirën për t'u kthyer në Shqipëri, ku, krahasuar me gjithë llojet e punëve, ata që punojnë në bujqësi janë më shumë të mundshëm për t'u kthyer, dhe ata që janë zyrtarë dhe profesionistë janë më pak të mundshëm për tu kthyer. Efektet ne lidhje me largimin e e trurit dhe përfitimet e humbura të trurit, janë të dukshme dhe jashtëzakonisht të dëmshme për të ardhmen. Programet e legalizimeve synojnë të dekurajojnë migrimin e ri por ata favorizojnë periudha më të gjata migrimi midis migrantëve. Por në kundërshtim me faktin e modelit të migrimit ku gratë kishin më pak gjasa për të migruar, sapo ndodhen në migrim, ato janë më të prirura për të qëndruar më gjatë ose për të qëndruar jashtë shtetit përfundimisht. Migrantët e vonë kanë më shumë tendencë për t'u kthyer. Ndoshta ky është një tregues i politikave më të ngurta për migrimin në vitet e fundit, duke e bërë rezidencën e përhershme, më pak të mundshme. Nga ana tjetër kjo mund të jetë një shenjë që migrantët e vonë, veçanërisht nëse episodet e para migrative ndodhën në vitet e fundit, të kenë patur kohë të pamjaftueshme për të kompletuar "ciklin e migrimit", ose në të kundërt, për të vendosur që të jetojnë përgjithmonë jashtë shtetit. (Tabela C.16).

**Figura 3.15: Shkalla e varfërise subjektive sipas synimit për t'u rikthyer**



3.25 Migrantët shqiptarë të kontaktuar në Greqi, konfirmojnë se ata që synojnë të kthehen, kanë prirje te jenë më pak të kualifikuar dhe më pak të suksesshem në vendin e destinacionit. Studimi u krye në bazë pilot me një mostër të vogël migrantësh (Kutia 3.2). Tabela C. 19 krahason dy grupet e migrantëve në bazë të synimit të tyre për t'u rikthyer (këtu ne përjashtojmë kategorinë e të pavendosurve ) me qëllim që të eksplorojë diferenca sistematike midis grupit të atyre që kanë më tepër premisa për t'u kthyer dhe individëve që kanë më shumë premisa për të qëndruar në Greqi. Grupi i individëve me premisa për t'u rikthyer, përbëhet nga meshkuj me qëndrime më të shkurtra në Greqi të cilët kanë qenë më pak të suksesshëm për të gjetur një punë të qëndrueshme në vendin pritës. Një pjesë më e madhe e këtyre individëve, raportojnë se kanë fituar zanate të reja ndërkohë që kanë qenë në Greqi, çka tregon kualifikimin e tyre të dobët para migrimit. Gjithashtu ata janë edhe disi më të varfër dhe më pak të arsimuar se individëd e grupit që kanë premisa të jenë "qëndrues". Këto konstatime janë në një linjë me

**Kutia 3.2: Vrojtim Kontaktues mbi Migrantët shqiptarë në Greqi**

Megjithëse e krahasuar me vrojtime të tjera të ngjashme, LSMS 2005 ofron një informacion plotësisht të hollësishëm mbi migrantët e përhershëm, ekziston një kufi mbi sasinë e informacionit që mund të mblidhet nëpërmjet të afërmëve të të anketuarve. Me qëllim që të plotësojmë të dhënat mbi migrantët e përhershëm, u krye një vrojtim tjetër për migrantët në Greqi në vijim të LSMS 2005 duke kontaktuar një grup të vogël migrantësh të përhershëm, të cilët bazuar në informacionet nga kontaktet e marra nga familjet në Shqipëri, jetonin në Greqi në kohën e vrojtimit. Synimi i vrojtimit kontaktues, ishte të thelloheshin dijet tona mbi opinionin e migrantëve shqiptarë ndaj kthimit në Shqipëri dhe sjelljen e tyre ndaj investimet dhe remitancave.

Informacionet e kontaktit me pothuajse 400 migrantë që jetonin në Greqi, u siguruan nga familjet e tyre në Shqipëri. Tipike për këto lloj vrojtimesh, ishte shterrimi në faza të ndryshme të seleksionimit çka përbënte një problem. Vetëm thuajse gjysma e familjeve me migrantë të Greqisë ofruan informacion kontakti të vlefshëm në formën e një telefoni apo të ndonjë adrese. Nga të 400 migrantët, gjysma u përjashtuan për shkak të kostos së shkaktuar nga larmia e shpërndarjes dhe distanca e rezidencës së tyre aktuale. Për pjesën tjetër, prej 200 migrantësh, me informacion kontakti të vlefshëm, të cilët jetonin kryesisht në Athinë dhe në Selanik, u krye një total prej 127 intervistash. Duke marrë parasysh shterrimin e madh, rezultatet duhen marë me kujdes.

Meqënëse ka informacion të pjesshem për të gjithe migrantët nga LSMS 2005, para se të analizojmë grupin e migrantëve të kontaktuar, ne jemi në gjendje të krahasojmë këtë grup me ata individë të cilët nuk ishim në gjendje që t'i ndiqnim me qëllim që të krijonim një ide për natyrën e diferencimit potencial. Ne gjithashtu krahasojmë karakteristikat e familjeve origjininë për këto dy grupe me qëllim që të eksplorojmë ekzistencën e diferencave sistematike që mund të ndikojnë krahasimin e drejtpërdrejtë. Migrantët e kontaktuar priren te jeë në moshë më të rritur dhe meshkuj. Ata gjithashtu kanë më shumë tendenca për të punuar në Greqi legalisht dhe flasin greqisht. Veç kësaj, ata janë më të prirur që të jenë të martuar me partner shqiptar dhe të dërgojnë remitanca në Shqipëri. Midis nëngrupit të migrantëve të kontaktuar, një e treta e të intervistuarve raportoi se nuk kishte plan për t'u kthyer në Shqipëri, ndërsa 40 përqind kanë plane përfundimtare për t'u kthyer. Një numur i madh gjithashtu raportoi se ende nuk e dinin se çfarë do të bënin.

provat e paraqitura kur shohim modelet e migrimit ku migrantet e përkohshëm duket se janë zgjedhur negativisht. Sikurse pritet, një proporcion më i madh migrantësh që planifikojne të kthehen në Shqipëri në të ardhmen, dërgojnë remitanca, megjithëse mesatarisht, ata synojnë të dërgojnë sasira të njëjta. Jo çuditërisht, migrantët që planifikojnë të kthehen në Shqipëri kanë raportin më të madh të investimeve në

vendin e origjinës dhe po ashtu porcionin më të lartë të kursimeve. Shumica dërmuese e njerëzve që kanë tendenca për të qëndruar, raportojnë gjithashtu se planifikojnë të qëndrojnë në Greqi përfundimisht.

3.26 Midis atyre që synojnë të kthehen dhe midis atyre që synojne të qëndrojnë, mund të zbulohen gjithashtu edhe disa dallime në lidhje me nivelet e mirëqënies së vetëraportuar. Figura 3.5 paraqet në mënyrë grafike përgjigjet ndaj pyetjeve ku të intërvistuarit u pyetën për të klasifikuar gjendjen e tyre financiare sipas një shkallë nga një deri në dhjetë (1-10) ku me 1 do të paraqisnin më të varfërit dhe me 10 më të pasurit.14. Me përjashtim të rangut më të lartë ata individë që synojnë të kthehen në Shqipëri ndjehen më mirë nga gjendja financiare se migrantët e tjerë që planifikojnë të qëndrojnë në Greqi. Ky konstatim është në njëfarë mënyre në kontrast me statistikat përshkruese (Tabela C.18), bazuar në masa më objektive ku ne vërejmë se të kthyerit e mundshëm mesatarisht duken më keq se sa ata që kanë premisa të qëndrojnë.

## D. MADHËSIA DHE SHPËRNDARJA E REMITANCAVE

3.27 **Dihet tashmë mjaft mirë se remitancat janë shfaqur si një nga komponentët kyçë të strategjive të jetesës së familjeve në Shqipëri**. FMN vlerëson se remitancat përfaqësonin 14 përqind të PBB në vitin 2005. Ato arritën deri në 13 përqind të të ardhurave familjare. Ndërsa ndikimi i migrimit mbi familjet që kanë mbetur në atdhe është më i madh se ç'mund të blejnë remitancat, megjithatë është e qartë se remitancat luajnë një rol kryesor në ndikimin e mirëqënies së familjes për sa kohë ato bëhen instrumenti mediatues themelor për të rritur të ardhurat dhe rrethin e mundësive të familjeve të migrantëve. Për këtë arsye, në këtë seksion, do të vështrojmë madhësinë dhe shpërndarjen e remitancave, para se ti kthehemi ceshtjes më të gjerë, se si migrimi ndikon mirëqënien e familjes.

3.28 **Rreth 65 përqind e anëtarëve të familjes bërthamë, që aktualisht janë jashtë shtetit, dërguan remitanca (para dhe në natyrë) në vitin para vrojtimit**. Ky numër vlerësohet të jetë rreth 451,000 migrantë të shkëputur, të përkufizuar si anëtarë të një familjeje, të larguar prej saj që në vitin 1990 dhe që tani jetojnë jashtë shtetit. Mesatarisht ata dërguan USD 1,179, që përbën një total prej 340 million USD për një periudhë prej 12 muajsh. Kjo përfaqëson rreth 87 përqind të remitancave totale të marra nga gjithë familjet në të njëjtën periudhë. Pjesa tjetër u dërgua nga të afërm të tjerë të largët ose miq. Në tërësi nga familjet shqiptare morren një total prej afërsisht 400 milion USD gjatë një viti. Këto flukse janë në fakt një nënvlerësim bruto i remitancave pasi ato nuk përfshijnë të gjitha fitimet dhe kursimet e sjella nga vetë migrantët personalisht. Në tërësi, një përqindje më e madhe e familjeve mori remitanca në vitin 2005 krahasuar me vitin 2002. Për më tepër fluksi total i remitancave është rritur me 11 përqind në vitin 2005, krahasuar me vitin 2002. Megjithatë, në vitin 2005 familjet morën mesatarisht më pak remitanca krahasuar me vitin 2002, (shih Tabela C.22).

3.29 **Zonat Malore kanë numrin më të madh të migrantëve që dërgojnë remitanca (në raport me numrin total të migrantëve nga kjo zonë), megjithëse parë në numra absolutë zonat e Bregdetit dhe të Qendrës- dy prej burimeve më të mëdha të migrimit të përhershëm, kanë më shumë familje që marrin më shumë remitanca**. Ndërkohë që nga zonat Bregdetare dërgojnë remitanca 60 përqind e migrantëve, nga zonat Malore dërgojnë remitanca 74 përqind e migrantëve. Për më tepër, migrantët nga zonat Malore më të varfëra, dërgojnë mesatarisht thuajse dy herë më shumë se sa migrantët nga zona Qendrore. Kësisoj proporcionalisht më shumë remitanca dhe në numur më të madh po shkojnë drej zonave Malore krahasuar me zonat e tjera më të pasura të vendit. Këto konstatime, të kombinuara edhe me tendencën e sipërme të migrimit ndërkombëtar, jashtë zonave Malore, tregojnë një rol jashtëzakonisht të madh në rritje të migrimit dhe remitancave në uljen e varfërisë në këto zona më të largëta të cilat deri vonë dukej të ishin të shkëputura nga flukset kryesore të migrimit drejt destinacioneve ndërkombëtare. Figura 3.16).

---

[14] Të tre shkallët më të larta janë kombinuar për shkak të numurit të kufizuar të vëzhgimeve në çdo shkallë.

**Figura 3.16: Numri i Migrantëve dhe Remituesve; % e remituesve sipas Shtresës**




**Figura 3.17: Sasia mesatare e dërguar sipas Shtresës**




3.30 **Sikurse pritet, kohëzgjatja e migrimit ka një ndikim të rëndësishëm si në numurin e remituesve edhe në vlerën e dërguar nga migrantët.** Megjithëse tashmë në numur më të vogël, një pjesë e madhe e migrantëve të hershëm ende po dërgon remitanca. Bazuar në vitin e parë të migrimit, pjesa e migrantëve që dërgonin remitanca u rrit deri në vitin 1997, pas të cilit filloi të bjerë ndjeshëm. Vetëm rreth 50 përqind e migrantëve më të fundit ende po dërgojnë remitanca krahasuar me më shumë se sa 70 përqind të dërguara nga migrantët që u larguan në mes të viteve 1990. Megjithatë, migrantët e larguar kohët e fundit mesatarisht po dërgojnë më shumë remitanca - rreth 300 USD më shumë në vitin para vrojtimit. Kjo tregon se një numur i madh migrantësh ruan lidhje të forta me familjet e tyre megjithëse ka kaluar më tepër se një dekadë dhe ata ende dërgojnë një masë të qëndrueshme megjithëse mesatarisht një masë më të vogel remitancash.15 Nga ana tjetër, një numur i madh migrantësh të rinj mund ta kenë të vështirë të fillojnë të dërgojnë mënjëherë për shkak të kostove të larta në fillim të vendosjes në vendin pritës. Megjithatë, mesatarisht, ata që dërgojnë janë në gjendje të dërgojnë më shumë. Figura 3.18-Figura 3.19).

**Figura 3.18: Numri i Migrantëve dhe Remituesve; % e remituesve sipas vitit të migrimit**




**Figura 3.19: Sasia mesatare e dërguar nga të shkëputurit sipas kohës së qëndrimit**




---

[15] Kjo nuk është e habitshme duke u nisur nga përbërja e grupit të të shkëputurve që po analizohet, e cila përbëhet teresisht nga anëtare aktuale te familjeve. Qëndrimi ndaj remitancave i remituesve që mbeten, mundet të jetë i ndryshëm në fakt.

3.31 Një pjesë mjaft më e madhe e familjeve në kuintilet e sipërme, kanë migrantë jashtë shtetit dhe marrin remitanca, krahasuar me homologët e tyre në kuintilet më të ulta. Sikurse tregohet në figurën 3.20, numri i migrantëve të shkëputur, dhe i remituesve kanë një lidhje të fortë dhe pozitive me mirëqënien të matur sipas kuintilit të shpenzimeve për frymë. Megjithatë, tendenca në tërësi midis nivelit të mirëqënies dhe pjesës se migrantëve që dërgojnë remitanca në çdo kuintil është faktikisht e sheshtë. Po kështu nuk ka dallim përgjatë kuintileve të mirëqënies në sasinë mesatare të dërguar nga migrantët e shkëputur. (Figura 3.21).

**Figura 3.20: Numri i Migrantëve dhe Remituesve, % e remituesve sipas kuintilit**




**Figura 3.21: Sasia mesatare e Remituar sipas Kuintilit**




3.32 Ne menyre të qartë në këto figura, vihet re se nivelet e konsumit, e kësisoj kuintilet, ndikohen nga niveli i remitancave të marra. Kësisoj, ndërkohë që nuk janë ideale, ne shohim përqindjen e remituesve dhe pjesën e migrantëve për kuintil të konsumit neto për person të remitancave. Rezultatet tregohen në Figurën C.7. Ato tregojnë se ndërkohë që ky model qëndron, shumica e migrantëve tashmë vijnë nga kuintili i katërt. Kjo sugjeron se familjet relativisht më të pasura dërgojnë më shumë migrantë dhe marrin relativisht më shumë remitanca dhe ndërkohë lëvizin drejt një rangu më të lartë.

3.33 Me qëllim që të shmangim vështirësinë e ndarjes së pozicionit të mirëqënies nga remitancat, ndërtojmë të njëjtin tip grafiku por të bazuar në pozicionin e aseteve të familjes në vitin 1990.[16] Megjithëse një alternativë jo e plotë e të ardhurave të familjes, indeksi i përdorur për renditjen e familjeve nuk ështe i kontaminuar nga vlera e remitancave të marra sikurse në rastin e renditjes së konsumit për frymë. Rezultatet tregojnë se familjet në mes të shpërndarjes së aseteve, kanë premisa më të pakta për të marrë remitanca. Familjet që ishin në gjendje më të mirë në vitin 1990, mesatarisht, po marrin gjithashtu mjaft remitanca më shumë. (Figura 3.22).

[16]Në ideks të dhënat e nxjerra nga analizat e komponentëve kryesorë, janë të bazuara mbi pronësinë e familjes mbi tetë mjete të qëndrueshme në vitin 1990.

**Figura 3.22: Remitancat e nxjerra nga Indeksi i Pasurisë llogaritur në bazë të Aseteve në zotërim në vitin 1990**




3.34 **Migrantët më të rinj dhe më të vjetër dërgojnë nivele më të larta të remitancave**. Figura 3.23 tregon lidhjen midis sasisë së remitancave dhe moshës së migrantit. Lidhja është në formën–U, çka tregon se migrantët midis moshave 30-35 vjeç, dërgojnë më pak krahasuar me ata që janë më të rinj dhe ata që janë më të mëdhenj. Çuditërisht, mesatarisht, migrantët e moshave të hershme njëzet vjeçare, janë ata që dërgojnë sasitë më të mëdha. Megjithatë ky është edhe grupi i remituesve që përbën grupin më të vogël. (Figura 3.24). Për moshat e tjera, tendencat për të dërguar janë në fakt identike, me rreth 65 përqind. Kështu në tërësi, tendenca për të transferuar para tek anëtarët e familjeve origjinë duket të jetë e ndikuar më shumë nga numri i viteve jashtë shtetit, dhe nga vendndodhja e familjes por jo aq nga mosha e migrantit (me përjashtim të më të rinjve që kanë tendencën më të ulët për të dërguar).

**Figura 3.23: Sasia mesatare e Dërguar sipas moshës së Migrantit**




**Figura 3.24: % e Remituesve sipas moshës së Migrantit**



## E. NDIKIMI I MIGRIMIT MBI VARFËRINË

3.35 Një krahasim i drejtpërdrejtë midis familjeve me migrantë dhe atyre pa migrantë tregon diferenca të mëdha në konsum dhe në varfëri. Tabela 3.4 tregon diferencat në konsumin për frymë si edhe dy nivele të rezultateve të varfërisë midis familjeve me migrantë ndarë sipas llojit të migrimit që ka zgjedhur një familje si edhe familjeve pa migrantë. Rezultatet tregojnë diferenca të mëdha në nivelet e konsumit si edhe frekuencën e varfërisë dhe thellësinë e saj, midis familjeve me një migrant të përhershëm jashtë shtetit dhe atyre familjeve pa migrant. Megjithatë duket se nuk ka diferenca të matura në këto rezultate midis familjeve që mbësheten tek migrimi i përkohshëm dhe atyre pa migrantë.

**Tabela 3.4: Treguesit e Varfërisë dhe Migrimi**

| | Migrimi i Përhershëm | | | Migrimi i Përkohshëm | | | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | jo | po | Δ | Jo | po | Δ | |
| Konsumi për fryme* | 8,813 | 9,856 | 1,043*** | 9,202 | 8,943 | -259 | 9,109 |
| Matja e varfërisë | 21.2 | 11.8 | -9.4*** | 18.6 | 18.4 | -0.1 | 18.5 |
| Hendeku i varfërisë | 4.7 | 2.2 | -2.5*** | 4.0 | 4.0 | 0.0 | 4.0 |
| Numuri i vëzhgimeve | 2,486 | 1,154 | | 2,544 | 1,096 | | 3,640 |

* Llogaritur në nivel individual

*** I rëndësishëm në nivelin 99%

3.36 Nga të dhënat mund të arrihet ne konkluzionin që migrimi i përhershëm përmirëson mirëqënien, ndërkohë që nuk ndodh kështu me migrimin e përkohshëm. Megjithatë kjo do të ishte jo e saktë, sepse mund të ndodhë për shembull që migrantët e përhershëm të kenë patur nivele më të larta konsumi madje edhe para migrimit, ose që familjet me migrantë të përkohshëm të kishin nivel mjaft më të ulët konsumi para migrimit, në krahasim me familjet homologe pa migrantë. Me qëllim që të marrim një vlerësim të saktë të ndikimit të migrimit mbi mirëqënien- ne duhet të marrim ne konsideratë vet-përzgjedhjen e migrantëve, që do të thotë, natyrën jo rastësore të statusit të migrantit. Ndërkohë që ka mjaft mënyra për të kontrolluar për njëanshmërinë që rrjedh nga ky vetëseleksionim i migrantëve, rezultatet e këtij raporti përdorin metodën e ndryshores instrumentale (IV). Së pari probabiliteti i migrimit vlerësohet sipas disa karakteristikave që mendohet se mund të ndikojnë në vendimin për migrim. Pastaj bëhet vlerësimi i diferencës në konsum për familjet duke kontrolluar karakteristika të vëzhgueshme si edhe tendencat për të migruar.

3.37 Si migrimi i përkohshëm edhe ai i përhershëm kanë një ndikim pozitiv në konsum por ndikimi është më i madh për migrimin e përhershëm. Koefiçenti IV i llogaritur për ndryshoren instrumentale të migrimit të përkohshëm, tregon se një vit më shumë i migrimit ndërkombëtar, shoqërohet me një rritje prej 5 % në konsum. Ky ndikim është disi më i madh se sa ai i matur nëpërmjet koefiçentit të përllogaritur sipas metodës së katrorëve më të vegjël të zakonshëm (OLS), duke sugjeruar një njëanshmëri negative në procesin e migrimit të përkohshëm. Ndikimi i migrimit të përhershëm mbi konsumin është gjithashtu pozitiv dhe i rëndësishëm. Megjithëse vlera e madhe e koefiçentit IV është disi e dyshimtë, që të dyja vlerësimet tregojnë një lidhje shkak- pasojë midis të paturit të një migranti të përhershëm që jeton jashtë shtetit dhe nivelit të konsumit të familjes. Një migrant jashtë shtetit e rrit nivelin e konsumit të familjes me rreth 50 përqind (Tabela C.23).

3.38 Vetraportimi i renditjes së mirëqënies tregon gjithashtu se familjet me migrantë patën përmirësime pozitive në kohë, ndërkohë që familjet pa migrantë nuk raportuan ndryshime. LSMS 2005 përmbante një modul mbi varfërinë subjektive, në të cilën një person përfaqësues për familjen në përgjithësi kryefamiljari/rja,- u pyetën për percepsionin e tyre për mirëqënien në momente të ndryshme në

kohë që në vitin 1990. Duke u bazuar në këtë informacion si edhe në ekspozimin e migrimit ndaj familjeve, në përgatitëm një sërë grafikësh me qëllim që të përshkruanim nga ana pamore lidhjen midis migrimit si edhe ndryshimeve në mirëqënie të perceptuar nga i intervistuari. Për të treguar lidhjen midis migrimit dhe ndryshimeve në mirëqënie, ne përdorim përgjigjet ndaj pyejteve që përmban literatura "Pyetja mbi Mirëqënien Ekonomike", në të cilën të intervistuarve ju kërkua që ta vendosin vetveten në një shkallë me 10 rangje, ku rangu 1 i përgjigjej rangut më të varfër dhe rangu 10, më të pasurit.17 Të intervistuarit ju kërkua të vlerësonte situatën financiare të familjes si në vitin 1990 edhe në vitin 2005.

3.39 Kurba solide e Figurës 3.25 tregon kushtet e vetëraportuara për vitin 1990 nga familjet pa migrantë ndërkombëtarë. Kurba e dytë (tek legjenda) i referohet situatës në vitin 1990, të familjeve me gjithë llojet e migrimit ndërkombëtar (të përkohshëm dhe të përhershëm). Kurba e tretë dhe e katërt tregon shpërndarjen e renditjeve për të dy grupet e njëjta në vitin 2005 respektivisht. Duke u bazuar në percepsionin e të intervistuarve, në vitin 1990, nuk ekzistonin diferenca të matshme midis familjeve me migrantë dhe atyre pa migrantë. Megjithatë, në vitin 2005 ka një zhvendosje të ndjeshme në të djathtë të shpërndarjes së renditjeve sipas raportimeve nga familjet me migrantë, ndërsa vihet re një ndryshim i vogël në shpërndarjen e renditjeve te raportuara nga familjet pa migrantë. Kjo tregon qartë se familjet me migrantë mendojnë se janë në gjendje më të mirë se sa fqinjët e tyre pa migrantë. Të njëjtat konkluzione mund të nxirren po të konsiderohet vetëm migrimi i përhershëm, duke treguar se një pjesë e madhe e përmirësimit të perceptuar vjen nga ky lloj migrimi dhe jo nga migrimi i përkohshëm. (shih figura 3.26) Kur renditja e perceptuar e familjeve me migrim të përhershëm është e ndarë sipas destinacionit në vende të ndryshme, ne konstatuam se ndërkohë që familjet me migrantë në Greqi e konceptonin gjendjen e tyre disi të përmirësuar, pjesa më e madhe përmirësimit vjen nga familjet me migrantë në Itali dhe përtej (Shih Figura C.5). Kjo mund të pasqyrojë përfitimet më të larta dhe statusin më të mirë të mundshëm që ka lidhje me llojin e dytë të migrimit, megjithëse, sikurse e shqyrtuam edhe më lart, migrantët në këto vende nuk dërgojnë në mënyrë të ndjeshme më shumë se sa homologët e tyre në Greqi.

| **Tabela 3.5: Shkalla e Varfërisë Subjektive në vitin 1990 dhe 2005, me ose pa ndonjë migrim** | **Tabela 3.6: Shkalla e Varfësisë Subjektive në vitin1990 dhe 2005 me ose pa migrim të përhershëm** |
|---|---|
|  |  |

17 Për shkak të numurave të vegjël në vëzhgimet e bëra në rangjet e larta, në i grupojme përgjigjet në katër rangjet më të larta.

3.40 **Një grup migrantësh shqiptarë të kontaktuar në Greqi, raportojnë gjithashtu se migrimi e ka përmirësuar gjendjen e tyre**. Një grup të migrantëve të kontaktuar në Greqi, iu kërkua të vetëraportojnë se si e perceptonin ata situatën e tyre financiare para migrimit (kur ishin në Shqipëri) dhe tani(që ndodhen në Greqi) dhe në mënyrë hipotetike nëse do të ktheheshin. Rezultatet tregojnë se migrantët mendojnë që situata e tyre tani, është përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme krahasuar me situatën e tyre në Shqipëri, para migrimit. Megjithatë shumë pak njerëz e konsiderojnë veten e tyre në gjendje shumë të mirë financiare në Greqi, Figura 3.27, rangu 8+ vija solide), pasi popullsia së cilës ata i referohen është në mënyrë të konsiderueshme në gjendje shumë më të mirë se në Shqipëri. Megjithatë, ata ende mendojnë se situata e tyre me kthimin në Shqipëri do të përbënte një përmrësim radikal në krahasim me situatën e tyre para migrimit dhe ende disi më e përmirësuar krahasuar me situatën e tyre aktuale në Greqi.

**Figura 3.25: Shkalla e Varfërisë Subjektive sipas Vendndodhjes**




**Figura 3.26: Fluksi i Migrantëve të përkohshëm të rikthyer sipas Gjinisë**




3.41 Migrimi dhe remitancat shpjegojnë pjesërisht uljen e madhe të varfërisë si edhe konvergjencën rajonale të vëzhguar. Sikurse tregohet në Kreun 1 (shiko gjithashtu Tabelën A.8), shkalla e varfërisë në Shqipëri ka rënë ndjeshëm në harkun kohor prej vetëm 3 vjetësh. Masa e varfërise (headcount) ra deri në 7 pikë përqindje midis viteve 2002 dhe 2005, nga 25.4 përqind në vitin 2002, në 18.5 përqind në vitin 2005. Për më tepër, të dhënat tregojnë se një ulje madje më e ndjeshme e varfërisë u vu re në zonat urbane, veçanërisht në Tiranë dhe në zonat Malore.

3.42 Ka katër lloj treguesish që mbështesin rolin jashtëzakonisht të madh që luan migrimi në modelet e vëzhguara për ndryshimet e varfërisë në Shqipëri. Së pari, ka tregues të qartë se Tirana dhe rajonet Malore rurale janë zonat ku ne shohim rritjen më të madhe të pjesës së familjeve që marrin remitanca. Së dyti, jo vetëm që u rrit pjesa e familjeve që merrnin remitanca, por gjithashtu u rrit në mënyrë të konsiderueshme edhe sasia e remitancave. Në mënyrë të veçantë, flukset drejt Tiranës e tejkaluan dyfishin, ndërsa ato të zonave Malore u rritën në masën 50 përqind. (Tabela C.22). Së treti, sikurse e kemi përmendur edhe më lart, rajoni malor është i vetmi rajon në të cilin fluksi i migrantëve të rinj të përhershëm ka pësuar rritje të vazhdueshme në vitet e fundit. Kjo bie në kontrast me të gjitha rajonet e tjera të cilat po pësojnë një ulje të dukshme në vitet e fundit. Së fundmi duhet thënë se sa më e lartë të jetë fuqia blerëse e një dollari të remitancave në rajonin Malor, krahasuar me rajonet e tjera, aq më shumë shtohet ndikimi i transfertave në uljen e varfërisë. Megjithëse, kjo është vetëm përshkruese dhe aspak përfundimtare, këto të dhëna duket se sugjerojnë një lidhje të mundshme midis migrimit dhe remitancave nga njera anë si edhe përparimet e mëdha në uljen e varfërisë, të vërejtur në rajonin Malor në vitet e fundi, nga ana tjetër.

## F. MIGRIMI DHE AKUMULIMI I KAPITALIT NJERËZOR

3.43 Në diskutimet e kohëve te fundit rreth migrimit Shqiptar, po i jepet shumë më tepër rëndësi analizimit të migrimit jashtë shtetit, kryesisht nga anëtarët ne moshë të re të familjeve, të cilët të detyruar nga vështirësitë ekonomike, shkojnë drejt vendeve fqinje me gjendje më të mirë ekonomike. Si në politikëbërje edhe në kërkime shkencore, pak vëmendje i është kushtuar, ndikimit të migrimit të rikthimit, i cili sa vjen e po bëhet më i rëndësishëm ndërkohë që migrimi po maturohet e po kështu edhe ndikimi i tij në arritjet e kapitalit njerëzor në Shqipëri. Ky seksion përmbledh disa konstatime të kohëve të fundit në këto dy fusha. Sikurse pritet, modeli i kohës së ritkthimit të migrantëve po rritet me një ritëm të ndjeshëm dhe është i dominuar nga meshkujt. (Figura 3.28) Për më tepër një pjesë e madhe e të kthyerve janë nga Greqia. (Figura 3.29).

3.44 Duket qartë se të rikthyerit e kohëve të fundit kanë më shumë tendenca për të mos e plotësuar ciklin e tyre të "migrimit" ende, dhe sikurse tregohet në Figurën 3.30, kanë më shumë tendenca për të migruar sërish në të ardhmen e afërt. Si rrjedhojë minimalisht, shifra për vitin 2004 duhet parë si një mbivlerësim i fluksit aktual të të rikthyerve (Figura 3.28). Megjithatë, edhe sikur ta konsiderojmë pikun në vitin 2004 si një lapsus statistikor, tendenca drejt ngjitjes është e sigurt dhe potenciali i saj i madh ka premisa të mos jetë i neglizhueshëm. Duke qenë pjesërisht reflektimi i asaj që në e kemi quajtur deri tani si migrimi i përkohshëm, nuk të habit fakti që të rikthyerit janë shumica meshkuj që kthehen nga Greqia fqinjë.

**Figura 3.27: Fluksi i Migrantëve të Përkohshëm të rikthyer sipas Destinacionit të fundit**




**Figura 3.28: Pjesa e Migrantëve të Përkohshëm të rikthyer sipas synimit për të migruar sërish**




3.45 **Të dhënat mbi përbërjen demografike dhe kualifikimin e migrantëve të kthyer, nuk flasin për një "përthithje të trurit"**. Vitet mesatare të arsimimit të të kthyerve, kanë ardhur duke u ulur që në vitin 1995, me një ritëm më të shpejtë se sa tendenca në ulje e vënë re në nivelin e arsimimit të migrantëve të rinj. Për më tepër megjithëse piku në moshën mesatare të të kthyerve rreth vitit 1999, mund të pritej nga fluksi masiv i migrantëve më të moshuar pas krizes se skemave piramidale te vitit 1996, rritja në vitet e mëvonshme duhet të përbëjë një shqetësim. (Figura 3.32).

| Figura 3.29: Arsimimi mesatar i Migrantëve të herës së fundit sipas Gjinisë | Figura 3.30: Mosha mesatare e Migrantëve të herës së fundit sipas Gjinisë |
|---|---|
|  |  |





3.46 Ka një marrëdhënie të fortë dhe pozitive midis migrantëve të rikthyer dhe pronësisë në biznes, por të dhënat gjithashtu tregojnë se ky biznes karakterizohet nga një produktivitet i ulët. Një proporcion në rritje i migrantëve të përkohshëm, janë duke u kthyer në Tiranë ose në qendra të tjera urbane pavarësisht se ata kanë qenë nga zonat rurale, megjithëse rritja në kthimin nga migrimi i zonave rurale, e vërejtur në dy vitet para vrojtimit, është deri diku kuptueshme. (Figura C 6) Një pjesë e mire e këtyre të rikthyerve përdorin (disa nga) fitimet e huaja për të ngritur biznes familjar, shpesh kopje të bizneseve që ata bënin ndërkohë që punonin jashtë shtetit. (Labrianidis dhe Hatziprokopiou, 2006). Probabiliteti i ngritjes së këtyre ndërmarrjeve të vogla rritet me kalimin e kohës që ata kanë kaluar jashtë shtetit (Kule et al., 2002). Studime të tjera gjithashtu konstatojnë një lidhje të fortë dhe pozitive midis kthimit nga migrimit dhe pronësisë në biznes dhe se tendencat për t'u mare me biznesin personal janë më të mëdha midis familjeve që kthehen nga vende veç Greqisë(Kilic et al., 2007). Megjithatë, sikurse kanë theksuar edhe autorët, në rastet më të shumta, këto biznese janë të vogla, me fitime të vogla dhe përpjekje informale të familjes në sektorin e shërbimit, çka sugjeron aftësi të dobëta sipërmarrjeje nga ana e migrantëve të kthyer.

3.47 **Madje edhe më tepër shqetësuese janë tendencat në drejtim të mirëqënies**. Në vitet e fundit, migrantët që po rikthehen vijnë në familje më të varfra se sa në vitet e mëparshme. Të gjitha këto prirje të kombinuara tregojnë një lloj përzgjedhjeje negative midis migrantëve që me kalimin e kohës përbëhen nga migrantë më të moshuar dhe më të paarsimuar të cilët kthehen në familjet e tyre më të varfëra.. Si të tillë dhe sikurse thuhet edhe nga Barjaba, (2000), migrimi i rikthyer mund të reflektojë një dështim jashtë shtetit, çka përbën një katalist më të dobët për zhvillim në vend.

3.48 **Megjithatë, migrimi duket se promovon lëvizshmëri më të lartë në punësim**. LSMS 2005 grumbulloi informacion për punësimin e individëve në harqe kohorë të ndryshëm që në vitin 1990. Për anëtarët e familjeve që tani janë jashte shtetit, (migrantët e përhershëm), vrojtimi u interesua për punën e bërë në vitin 1990, në kohën e migrimit dhe punën aktuale që bën në vendin në destinacion. Anëtarët e familjeve u pyetën për punën e bërë në vitin 1990, për migrantët u kërkua puna e kryer gjatë çdo episodi migrimi si edhe në kohën e vrojtimit. Bazuar në këtë informacion, ne jemi në gjendje të analizojmë lëvizshmërinë në punësim të individëve qysh në fillim të tranzicionit dhe të zbulojmë për migrantët lidhjen midis migrimit dhe lëvizshmërise sociale. Analiza është thjesht përshkruese dhe nuk nenkupton

lidhje shkakësore midis migrimit dhe ndryshimeve në punësim. Megjithate ajo na jep të dhëna për ndryshimet në përzgjedhjen për punë midis migrantëve të kthyer dhe atyre që nuk migruan.

3.49 **Megjithëse,** midis jo-migrantëve vihet re një lëvizshmëri e vogël, të dy grupet e migrantëve tregojnë një lëvizshmëri mjaft të madhe, e shkaktuar kryesisht nga lëvizje dramatike në papunësi. Sikurse tregohet edhe në Tabelën 3.5, migrimi shoqërohet me pjesëmarrje më të ulët në bujqësi, si në Shqipëri edhe jashtë shtetit. Para migrimit, thuajse gjysma e migrantëve punonin në bujqësi, por tashmë në kthim këta përbëjnë një të tretën. Rënia madje është më e madhe midis migrantëve të përhershëm. Megjithëse thuajse gjysma merreshin me bujqësi, ndërkohë që ishin në Shqipëri, thuajse vetëm një e pesta merren ende me bujqësi jashtë shtetit. Për migrantët e përkohshëm, ndryshimet më të mëdha vihen re në ndërtim ( një pjesë e profesioneve), dhe në sektorët e shërbimit. Midis viteve 1990 dhe 2005, pjesa e individëve që punonin në këto dy sektorë, thuajse u dyfishua (nga 12.6 në 21.3 përqind.).18 Një model i ngjashëm por madje më i theksuar vihet re midis migrantëve të përhershëm, ku pjesa që merren me zejtari rritet në më shumë se gjashtëfish.(nga 6.3 në 40.1 përqind), dhe pjesa me punë krahu, bëhet më tepër se trefishi. (nga 4.1 në 15.9 përqind.) Nuk është çudi që migrimi i përhershëm është një mjet më i suksesshëm i gjetjes së punës (jashtë shtetit).

**Tabela 3.7: Puna e Individeve në kohë sipas statusit të Migrimit (mostër e plotë)**

| | Jo-migrantë | | Migrantë të përkohshëm | | Migrantë të përhershëm | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 1990 | 2005 | 1990 | 2005 | 1990 | 2005 |
| Bujqësi | 27.2 | 24.5 | 26.9 | 26.9 | 17.4 | 12 |
| Zejtari | 6.9 | 7.3 | 12.6 | 21.3 | 6.3 | 40.1 |
| Shërbim | 1.5 | 4.9 | 1.6 | 7.5 | 1.7 | 8 |
| Administratë | 7.9 | 8.3 | 7.7 | 9.3 | 5.7 | 4.2 |
| Punë krahu | 7.4 | 5.9 | 7.4 | 9.6 | 4.1 | 15.9 |
| Të tjera | 1.1 | 0.3 | 1.0 | 0.5 | 0.7 | 1.3 |
| Nuk punojnë | 48 | 48.7 | 42.7 | 24.9 | 64.1 | 18.6 |
| Totali | 100 | 100 | 100 | 100 | 100 | 100 |

paktën dy episode migrimi jashtë shtetit, çon në arritjen e disa konstatimeve. Së pari, në këtë nën-grup një përqindje jashtëzakonisht e madhe ishte dhe mbetet në bujqësi duke sugjeruar se migrimi i përsëritur ishte dhe mbetet një migrim sezonal i lidhur me sezonin bujqësor inaktiv. Shumica e migrantëve punojnë në bujqësi kur janë jashtë shtetit, sidomos gjatë periudhës se tyre të parë të migrimit. Së dyti, me kalimin e kohës, vetëm një pjesë e vogël janë në gjendje të punojnë në sektorë të tjerë. Punët në ndërtim duket se janë një nga format kryesore të punës jashtë shtetit për këtë nëngrup. Së treti, shumë pak persona që bënin punë administrative ndërkohë që ishin në Shqipëri, janë në gjendje të ruajnë të njëjtën lloj pune kur punojnë jashtë shtetit, duke treguar një rënie në lëvizshmëri megjithëse kjo është e përkohshme. Së fundmi, një pjesë veçanërisht më e madhe e individëve janë të punësuar në sektorin e shërbimeve, në vitin 2005, krahasuar me vitin 1990 ose kur kanë qenë jashtë shtetit, duke vërtetuar në këtë mënyrë konstatimin se migrantët dhe familjet e tyre ka mundësi që t'i përdorin remitancat e tyre si edhe kursimet nga jashtë shtetit, për të ngritur biznese të vogla familjare në sektorin e shërbimeve, pas kthimit. (Tabela C.26) Një vëzhgim i mëtejshëm i lëvizshmërisë për punë midis episodeve të migrimit, për migrantët e përkohshëm me shumë episode migrimi, tregon një lëvizshmëri shumë të vogël ndërmjet episodeve të migrimit. I vetmi ndryshim i vërejtur është kalimi i 25 përqind të individëve të cilët punonin në bujqësi gjatë episodit të migrimit të tyre të parë në sektorin e shërbimeve (Tabela C.27).

[18] Një pjesë e rritjes vjen nga persona të cilët në vitin 1990 nuk punonin, disa prej të cilëve mund të kenë qenë tepër të rinj për t'u inkuadruar në forcën e punës.

3.50 Migrimi Ndërkombetar i përhershëm, ka një ndikim negativ në shkallën e frekuentimit të shkollës për fëmijët femra.

3.51 Tabela C.36 tregon rezultatet e kufizimit të analizës për familjet që kanë fëmijë midis moshave 6 deri në 22 vjeç. Vlerësimet kontrollojnë për faktorë të tillë si distanca nga shkolla, arsimi i kyefamiljarit, kapitali social dhe efektet rajonale të cilat kanë efekt mbi shkallën e frekuentimit të shkollës. Rezultati i papritur është se familjet me migrantë ndërkombëtarë të përhershëm kanë, mesatarisht, shkallë frekuentimi më të ulët se familjet pa migrantë ndërkombëtarë. Kur bëhen vlerësime të veçanta për frekuentimin e fëmijëve meshkuj dhe femra, rezultatet tregojnë se efekti negativ është i rëndësishëm statistikisht vetëm për fëmijët femra. Të njëjtat vlerësime u bënë duke i ndarë familjet në familje rurale dhe urbane. Në të dyja zonat, të dhënat vazhdojnë të tregojnë se shkalla e frekuentimit të shkollës për familjet me migrim ndërkombëtar të përhershëm, është më e vogel se sa ai i familjeve pa migrantë. Megjithatë, në zonat rurale kjo është e vërtetë vetëm për frekuentimin e fëmijëve femra ndërsa në zonat urbane, diferencat nuk janë statistikisht të rëndësishme.

3.52 **Efekti është më i fortë për frekuentimin e shkollave të mesme në zonat rurale.** Kufizimi i analizave në arsimin e mesëm, të çon në të njëjtat konkluzione por rezultatet janë të mëdha dhe statistikisht të rëndësishme vetëm në zonat rurale. Tabela C.34 dhe tabela C. 31, tregojnë se efekti i madh dhe statistikisht i rëndësishëm i frekuentimit të shkollës nga femrat, është tërësisht një problem rural. Nuk ka ndonjë diferencë të matur në shkallën e frekuentimit për fëmijët meshkuj dhe femra në zonat urbane midis familjeve me dhe pa migrim të përhershëm ndërkombëtar.

3.53 **Po kështu, familjet me migrantë ndërkombëtarë të përhershëm që kanë shpenzime pozitive në arsim, harxhojnë më pak në këtë sektor.** Analizat e shpenzimeve për arsimin për të njëjtat familje u bënë duke përdorur gjithashtu një model me dy pjesë, në të cilin, vendimi për të bërë ose jo shpenzime për arsimin e fëmijëve ështe i ndarë nga vendimi se sa duhet harxhuar pasi të jetë marrë vendimi për të kryer shpenzime (pozitive) për arsimin. Paneli i parë i tabelës C.34 dhe Tabela C.36 tregon se mesatarisht familjet me migrantë të përhershëm ndërkombëtarë kanë një probabilitet më të ulët shpenzimi për arsimin. Midis atyre që kryejnë shpenzime (pozitive), familjet me migrantë të përhershën ndërkombëtarë shpenzojnë më pak se sa familjet pa migrantë ndërkombëtarë të përhershëm. Efekti është negativ dhe statistikisht i rëndësishëm për fëmijët meshkuj dhe femra por më i madh për fëmijët meshkuj. Një shpjegim për këtë rezultat mund jetë fakti se shpenzimet për arsimin për shumë familje migrantësh si për shembull transporti në shkollë, rrobat etj. janë shpenzime në natyrë ndaj edhe janë të paraportuara. Për shembull ndoshta një fëmijë nga një familje migrantësh çohet në shkollë me makinë ose rrobat i dërgohen nga Greqia ose Italia.

3.54 Të marra se bashku këto konstatime që i lidhin vendimet e migrimit dhe rezultatet e arsimimit, janë të habitshme sepse mund të mendohet se kombinimi i të ardhurave më të larta nga remitancat, i cili lehtëson çdo kufizim likuiditeti ekzistues, dhe ekspozimi i migrantëve të rikthyer ndaj të ardhurave për shkollim në vendin në destinacion, do të ofrojë një bazë të fuqishme për investimin në arsim në Shqipëri. Fakti që në vërejmë të kundërtën, tregon tre rrugë të mundshme që barazojnë këto forca. E para është që migrimi ndërkombëtar i përhershëm mund të ketë një efekt shqetësues në strukturën familjare, organizimin dhe udhëheqjen. Për shembull, mungesa e kryefamiljarit mund të çojë në më pak kontribut prindëror në arsim, strukturë dhe kontroll në familje, duke ndikuar kështu negativisht në frekuentimin e shkollës nga fëmijët, performancën dhe vazhdimin e arsimimit.(Mc.Kenzie, 2006) Në fakt, të dhënat tona tregojnë se përqindja e familjeve me kryefamiljare femra, midis familjeve migrante është dy herë më e madhe se sa ajo e familjeve jo migrante. Për më tepër, preferencat e anëtarit të familjes migrante dhe vendimmarresit në pjesën tjetër mund të mos jenë në një linjë. Kjo ndodh në rastet kur migrantët të cilët shpesh janë meshkuj të rinj dhe relativisht më të arsimuar mund ta vlerësojnë arsimin dhe duan të invesojnë për të, por vendimmarrësi i cili mund të jete mashkull më i moshuar dhe që është më pak i arsimuar, mund të mos ketë të njëjtat synime.(Commander, Kangasniemi dhe Ëinters, 2004).

3.55 E dyta është se ekspozimi ndaj rrjeteve të informacionit dhe emigracionit rrit mundësinë e migrimit në të ardhmen duke i bërë migrimin dhe frekuentimin e shkollës, forca konkuruese. Megjithëse fëmijët mund të mos emigrojnë sot për sot, planet për të migruar në të ardhmen i ndikojnë në të ardhurat e pritshme nga arsimimi. Kur kostua oportune e qëndrimit në shkollë rritet falë potencialit më të lartë të fitimeve jashtë shtetit, fëmijët e familjeve migrante mund ta lenë shkollën më herët. Aty ku mundësitë e punësimit janë më të larta, për punë të pakualifikuara të cilat mund të gjenden veçanërisht nëpërmjet imigrimit ilegal në Greqi, motivimi i fëmijës për të frekuentuar shkollën mund të ulet. Ky efekt mund të jetë më i madh veçanërisht për fëmijët nga familje me migrantë jashtë shtetit të cilët mund të mbështeten në rrjete dhe ta ulin koston e migrimit. Sikurse tregohet në pjesën e parë të këtij kreu, shumë migrantë ndërkombëtarë nga Shqipëria shkojnë në Greqi. Pothuajse 51 përqind e familjeve me migrantë ndërkombëtarë, aktualisht kanë një migrant në Greqi dhe shifra më e lartë e viteve të shkollës për familjet me migrantë të cilët nuk shpenzojnë për arsimimin është më e ulët (9.8 vjet ) se sa ajo e familjeve që kanë shpenzime pozitive arsimore për fëmijët e tyre (10.5 vjet). Ne do të prisnim që ky efekt të ishte më i fortë në zonat rurale ku kushtet ekonomike janë më të këqia se sa ato në zonat urbane dhe në të cilat migrimi shfaqet fort si një rrugë shpëtimi nga vështirësitë sikurse konfirmohet edhe nga rezultatet e vlerësimit. Koefiçenti i migrimit në normat e frekuentimit të shkollës, në zonat rurale, (-68)ështe më i madh (do të thotë më keq) se sa ai i zonave urbane (-0.04) (Tabela C.34 dhe Tabela C.33).

3.56 **Së fundmi, migrimi mund të ketë një efekt negativ në shkallën e frekuentimit të shkollës, nëse fëmijët nga familjet me migrantë kanë mundësi për përfitime më të larta se sa ato që mund t'ju sjellë arsimimi**. Në veçanti, nëse familjet me migrantë i përdorin remitancat për t'u marrë me veprimtari më fitimprurëse, dhe këto sjellin rrugë alternative për krijimin e aftësive, dhe përfitime më të mëdha se sa qëndrimi në shkollë, atëhere fëmijët e familjeve të migrantëve mund të ndërpresin investimet për shkollim më herët se të tjerët.

**Konkluzion**

3.57 **Si përfundim, migrimi i kohëve të fundit i Shqipërise, si ai i brendshëm, edhe ai ndërkombëtar, kanë qenë pa precedent për nga niveli dhe ndikimi i vet në vend**. Shumica e migrantëve të brendshëm vijnë nga zonat rurale, nga zonat e izoluara Malore dhe në një masë të madhe janë femra. Migrimi ndërkombëtar ka rritur intensitetin e këtyre rivendosjeve. Ndikimi mbi popullatën ka qenë i ndjeshëm dhe shumëdimensioanl. Së pari, forma e migrimit ka pësuar ndryshim dhe shkalla e migrimit ka riformuar shpërndarjen hapësinore të popullatës në vend, së dyti, ndryshimet në mirëqenie kanë qenë të konsiderueshme. Në përgjithësi, familjet me migrantë mendojnë se mirëqenia e tyre është më e mirë pas migrimit të një anëtari të familjes, se kanë konsum më të madh dhe shkallë më të ulët të varfërisë. Krahas kësaj, ata kanë më shumë premisa që të investojnë në fillimin e një biznesi. Migrimi duket se përmirëson lëvizshmërinë në punë, megjithëse nga të dhënat nga migrantët që kthehen, nuk duket se vendi po përfiton aftësi superiore ende. Më në fund përkundrejt këtij sfondi të këtyre efekteve pozitive të migrimit, ka disa mangësi që shfaqen më tepër në faktin që familjet e migrantëve investojnë më pak në arsimimim, veçanërisht për fëmijët femra në zonat rurale dhe ju kushtojne më pak përpjekje veprimtarive bujqësore.

# *KREU 4:* MBËSHTETJA PËR TË VARFËRIT NËPËRMJET PROGRAMIT NDIHMA EKONOMIKE (NE)

*Programi NE , i cili është i vetmi program kundër varfërisë i bazuar në proces seleksionimi në Shqipëri, ka një mbulim të ulët megjithëse kjo gjë është përmirësuar ndërmjet viteve 2002 dhe 2005 për shkak të rritjeve të mëdha të konsumit në Zonat Malore, Tiranë dhe në zonat Rurale. Në të njëjtën kohë, mos përfshirja e jo të varfërve është rritur kështu që është përkeqesuar rrjedhja e fondeve. Një shpërbërje e targetimit të performancës, tregon se shumica e fitimeve në mbulim u atribuohen përpjekjeve të autoriteteve lokale për të gjetur dhe mbështetur të varfërit. Përfundimisht, ne kemi konstatuar se ndërsa udhëzimet e shumta administrative për të monitoruar dhe përzgjedhur familjet duket se po ndiqen në nivele të kënaqshme, ato kanë një lidhje të dobët me statusin e varfërisë së familjeve krahasuar me një listë lehtësisht të verifikueshme të aseteve që ka familja në përdorim.*

4.1 Shqipëria shpenzoi afërsisht 7 përqind të PBB për mbrojtjen sociale – një kombinim i sigurimeve shoqërore, planit të të ardhurave dhe programeve të tregut të punës – në vitin 2005. Pjesa më e madhe e shpenzimeve, në 5.4 përqind të PBB shkoi për programe të sigurimeve shoqërore duke përfshirë pensionet (Urban, rural dhe veteran) dhe lejet e lindjes. Programet e tregut të punës duke përfshirë asistencën, trainime profesionale dhe promovimin e punësimit përftuan një 0.4 përqind tjetër të PBB. Pjesa e mbetur shkoi për programe të projektuara në mënyrë të qartë për të mbështetur të ardhurat e të varfërve apo të njerëzve në nevojë. Kolektivisht, këto programe në mbështetje të të ardhurave referohen si asistencë sociale, dhe përfshijnë , institucionet për kujdesin social dhe Ndihma Ekonomike (NE). Pensionet e invaliditetit të cilat përthithën 0.6 përqind të PBB ose 10 përqind të gjithë shpenzimeve për mbrojtjen sociale në 2005, janë programi më i madh i asistencës sociale. Megjithatë NE. mbetet programi më i mirënjohur dhe ai që synon direkt tek familjet e varfëra.

4.2 **Një rishikim i balancuar i programeve të mbrojtjes sociale u përfundua së fundmi nën rishikimin e shpenzimeve publike (Banka Boterore, 2006).** Për këtë arsye, në këtë kre, ne fokusohemi vetëm tek një program që është projektuar për të asistuar familjet e varfëra, që është NE. Ky Kre do të shqyrtojë evolimin e ndihmave të NE, aftësinë e saj për të mbështetur të varfërit dhe targetimin e performancës së saj. Me interes të veçantë do të jetë analizimi i faktit se si natyra e decentralizuar e programit të NE ndikon në targetimin e performancës.

## A. TENDENCAT NË ALOKIMET E NE.

4.3 **Alokimet mesatare të NE për komunë apo bashki, u ulën në mënyrë të qëndrueshme ndërmjet viteve 2000 dhe 2006.** Shpërndarja mesatare (me çmimet e vitit 2002) për një komunë ose bashki, ishte përafërsisht një milion lek në 2000, por kjo u ul në rreth 740,000 Lek në 2006, e cila është një ulje reale prej 29 përqind në përmasat e alokimeve. Niveli i alokimeve në 2006 shënon një përmirësim nga një ulje e menjëhershme dhe e papritur në 2005, e cila e reduktoi alokimin real mesatar me 21 përqind ndërmjet viteve 2004 dhe 2005 (Figura 4.1). Përgjatë rajoneve, ulje të mëdha janë veçanërisht evidente në Tiranë dhe në Zonën Bregdetare, ku alokimet mesatare për komunë u ulën 41 dhe 35 përqind në vlera reale gjatë gjashtë viteve, ndërkohë që ulja ishte më pak e rëndë në zonat malore, të cilat pësuan një ulje kumulative prej 16 përqind.

4.4 **Numri mesatar i familjeve përfituese në një komune apo bashki është ulur gjithashtu.** Por ulja këtu ka qenë e qëndrueshme dhe graduale. Siç tregohet në Figurën 4.1, pothuajse 400 familje mund të kishin përfituar NE, mesatarisht, në një komunë apo bashki në vitin 2000. Por kjo u ul në 310, ose në një

reduktim prej 22 përqind, në vitin 2006. Si rrjedhojë, numri total i familjeve përfituese u ul nga rreth 150,000 në vitin 2000, në afërsisht 112,000 në vitin 2006. Reduktimi i konstatuar në pagesat e NE-së duket se është zbatuar në mënyrë të barabartë tek përfituesit e plotë apo të pjesshem të NE. Paraqitja vizuale në Figurën 4.2, tregon se si lista e përfituesve të pjesshëm edhe ajo e përfituesve të plotë, u reduktuan në të njëjtin nivel. Tendencat tregojnë se nivelet më të mëdha të heqjes nga lista e personave përfitues, u vunë re në Tiranë dhe zonat Bregdetare dhe shumë më pak në zonat malore dhe qendrore.

**Figura 4.1: Tendencat në alokimet mesatare të NE dhe numri i Personave përfitues**




*Burimi:* Ministria e Punes dhe Çështjeve Sociale (MPÇS).

4.5 **Ka diferenca të mëdha në alokimet mesatare për familjet përfituese përmes rajoneve**. Alokimi mesatar për familje në Tiranë është shumë më i lartë krahasuar me rajonet e tjera. Gjatë gjashtë viteve, niveli mesatar i përfitimit për familje përfituese në Tiranë ishte tre herë më i madh se alokimi mesatar për familje në zonat Bregdetare, dy herë më e madhe për familje në zonat Qendrore dhe pothuajse 70 përqind më e lartë se alokimi mesatar në zonat malore, zona e dytë më e madhe për nga numri i familjeve përfituese.

**Figura 4.2: Alokimi mesatar për komune/bashki dhe për familje përftuese, sipas Rajonit në kohë**




*Burimi:* Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale (MPÇS).

4.6 **Megjithatë, Vlera e NE për familje përftuese është ulur me ngadalë me kalimin e kohës.** Niveli i përfitimit për familje përftuese u ul nga rreth 2170 Lek për muaj në vitin 2000, në rreth 2113 Lek për muaj në vitin 2006, e cila është vetëm një ulje kumulative prej 3 përqind në 6 vjet. Ky është pjesërisht një kompensim i rritjes prej 25 përqind në alokimin mesatar ndërmjet viteve 2005 dhe 2006. Këto nivele uljeje janë pak më të larta se sa ritmi i reduktimit të përfitimit për familje i konstatuar duke përdorur sondazhet e familjeve. Sipas të dhënave administrative, nivelet e përftimit për familje përfituese ndërmjet viteve 2002 dhe 2005, për të dy vitet për të cilat ne kemi të dhëna nga sondazhet, u ulën me rreth 23 përqind. Duke përdorur të dhënat e sondazheve, ne konstatuam se ulja ishte vetëm në gjysmen e atij niveli. Për më tepër, nëse dikush shikon jo reduktimet reale për familje por reduktimet reale për frymë në nivelet e përftimit të ndihmës ekonomike, ulja është përafërsisht vetëm 11 përqind ose gjysma e niveleve (Tabela 4.1). Si të dhënat administrative ashtu dhe ato prej sondazheve tregojnë gjithashtu se uljet më të shpejta ndodhën në Tiranë dhe Zonat Bregdetare, ku tendencat shihen midis rajoneve, ndërkohë që nivelet urbane u ulën më shpejt se ato në zonat rurale, ku niveli i përfitimit për frymë u rrit lehtë.

**Tabela 4.1: Tendencat në vlerën e përfitimit real për frymë të NE, dhe për familje përfituese**

| | Përfitimet për familje, Përshtatur vetëm për CPI | | | Përfitimet për frymë, Përshtatur për CPI dhe ndryshimet rajonale të çmimeve | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 2002 | 2005 | Δ% | 2002 | 2005 | Δ% |
| Bregdet | 2806.56 | 2146.87 | -23.5 | 742.1 | 652 | -12.1 |
| Qendër | 2439.21 | 2231.62 | -8.5 | 577.3 | 546.1 | -5.4 |
| Mal | 2053.00 | 1988.20 | -3.2 | 427.4 | 394.8 | -7.6 |
| Tiranë | 3219.85 | 2146.53 | -33.3 | 883.7 | 569.3 | -35.6 |
| | | | | | | |
| Urban | 3031.22 | 2609.68 | -13.9 | 775.4 | 707.5 | -8.8 |
| Rural | 1928.43 | 1948.51 | 1.0 | 410.2 | 429.6 | 4.7 |
| | | | | | | |
| Total | 2408.30 | 2161.03 | -10.3 | 2389.899 | 2116.491 | -11.4 |

*Burimi*: Vlerësime të stafit të Bankës Botërore nga të dhënat e sondazheve.

4.7 **Në vështrim të parë, këto reduktime masive në numrin e alokimeve dhe numrin e pjesëmarrësve në një program të projektuar për të asistuar të varfërit duken shqetësuese në një vend ku nivelet e varfërisë janë ende relativisht të larta.** Megjithatë, në kontekstin e një zhvillimi relativisht të lartë, të ruajtur në shumë vite, dhe reduktimit thelbësor të varfërisë, pritet që lista e pjesëmarresve në NE të ulet. Ritmi i uljes mund të jetë gjithashtu i arsyeshëm duke marë parasysh natyrën e cekët të varfërisë së matur në 2002. Pyetja që shtrohet është nëse programi ka sjellë ndonjë përfitim në lidhje me mbështetjen dhe targetimit të të varfërve, tek të cilët ne drejtojmë vëmendjen.

## B. MBULIMI DHE TARGETIMI I PERFORMANCËS SË NE

4.8 **Mbulimi i të varfërve është përmirësuar ndërmjet viteve 2002 dhe 2005**. Tabela D.6 tregon pjesën e familjeve që kanë përfituar NE ndërmjet viteve 2002 dhe 2005. Në total, rreth 11 përqind e familjeve përftuan NE dhe kjo u rrit vetëm në masë të vogël në 13 përqind në 2005. Megjithatë, fraksioni i familjeve të varfëra të mbuluara nga programi në të njëjtën periudhë është rritur me rreth 7 pikë përqindje, nga 24.6 në 32.5 përqind. Ky është një përmirësim thelbësor duke marë parasysh faktin që varfëria në përgjithesi u ul. Pjesëmarrja nëpërmjet decileve të konsumit real për frymë nxjerr dy konstatime. E para, mbulimi i dy decileve më të ulëta, në fakt të gjithë të varfërit në 2005, u rritën me 3 pikë përqindje. Së dyti, sa më të larta të jenë decilet, aq më shumë ulet mbulimi, por niveli i rënies është

më i madh pas decilit të mesëm (që është i pesti). Për shembull, për çdo 10 pjesëmarrës në decilin më të varfër të familjeve, pothujase 1 në çdo 2 decilet e kreut, merr pjesë. (Tabela D.7 dhe Tabela D.8).

**Tabela 4.2: Pjesa e përfituesve të NE sipas shtresave dhe ndarjes në zona urbane/rurale**

| | 2002 | | | 2005 | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Të Varfër | Jo të varfër | Të gjithë | Të varfër | Jo të varfër | Të gjithë |
| Breg | 0.158 | 0.040 | 0.058 | 0.097 | 0.028 | 0.036 |
| Qendër | 0.238 | 0.090 | 0.119 | 0.416 | 0.130 | 0.179 |
| Mal | 0.463 | 0.271 | 0.340 | 0.450 | 0.299 | 0.329 |
| Tiranë | 0.082 | 0.022 | 0.029 | 0.197 | 0.020 | 0.030 |
| | | | | | | |
| Urban | 0.263 | 0.079 | 0.105 | 0.329 | 0.063 | 0.085 |
| Rural | 0.237 | 0.077 | 0.115 | 0.324 | 0.127 | 0.165 |
| | | | | | | |
| Shqipëria | 0.246 | 0.078 | 0.110 | 0.325 | 0.095 | 0.127 |

*Burimi*: Vlerësime të stafit të Bankes Botërore nga të dhënat e sondazheve.

4.9 **Një tipar tjetër pozitiv i programit është konstatimi se në program merr pjesë një numër më i madh i familjeve në zonat më të varfëra.** Zonat malore njihen në përgjithësi si më të varfëra se zonat e tjera të vendit, ndërkohë që Bregu dhe Tirana konsiderohen si zonat me gjendje më të mirë ekonomike. Në 2005 nivelet e varfërisë në zonat malore ishin përafërsisht tre herë më të larta se në Tiranë dhe afërsisht 58 përqind më të larta se në zonat Bregdetare. Rezultatet në Tabelën D.6 tregojnë se pak më shumë se një e treta e të gjithë familjeve në zonat Malore marrin pjesë në program, ndërkohë që vetëm 3 përqind e familjeve në Tiranë dhe 4 përqind në Breg marrin pjesë në vitin 2005. Për më tepër, pothuajse gjysma e të gjitha familjeve të klasifikuara si të varfëra në zonat Malore mbulohen nga NE krahasuar me 10 dhe 20 përqind në Breg dhe në Tiranë respektivisht.

4.10 Për më tepër, me kalimin e kohës, mbulimi në zonat rurale, ku jetojnë më shumë se dy të tretat e të varfërve, është përmirësuar më shpejt se në zonat urbane. Në 2002, afërsisht 11 përqind e të gjitha familjeve në zonat urbane dhe rurale u mbuluan nga programi. Në 2005, nivelet e mbulimit në zonat rurale, në afërsisht 17 përqind, ishin pothuajse dy herë më të larta se nivelet urbane (9 përqind). Fatkeqësisht, jo të gjitha përmirësimet e matura në zonat rurale burojnë vetëm nga mbulimi me ndihmë i të varfërve në fshat. Sikurse e tregon Tabela D.6 përmirësimet në pjesëmarrjen e të varfërve në zonat urbane dhe rurale ishin të të njëjtit rend madhësie, por ndërkohë që mbulimi i jo të varfërve në zonat urbane u ul, në zonat rurale ai u shtua.

4.11 Mbulimi me ndihmë NE i të varfërve ekstremë është edhe më i lartë. Tabela D.6 dhe Tabela D.4 regojnë tendencat në mbulimin me NE për të varfërit ekstremë, të varfërit dhe familjet jo të varfëra. Të varfërit i kemi ndarë në të varfër ekstremë dhe jo ekstremë, në mënyrë që të shihet më qartë progresi i bërë në mbulimin e të varfërve ekstremë. Përmirësimet në mbulimin e të varfërve duke përjashtuar të varfërit ekstremë mbeten të njëjta si ato të prezantuara në Tabelën D.6. Megjithatë, përmirësimet në mbulimin e të varfërve në ekstrem kanë qenë shumë më të mëdha. Në përgjithësi, programi mbërrin tek 50 përqind e të varfërve ekstremë, qe është një përmirësim i rëndësishëm nga viti 2002 kur ai mbërrinte vetëm tek 30 përqind e të varfërve ekstremë. Në zonat Malore dhe Qendrore, përpjekjet për të mbërritur tek të varfërit ekstremë duket se kane çuar në një dyfishim të niveleve të mbulimit. Në këto zona, rreth 60 përqind e të gjithë të varfërve ekstremë u mbuluan nga programi në vitin 2005 krahasuar me vitin 2002, kur mbulohej vetëm një e treta (Tabela D.4).

4.12 **Në gjithë këtë progres është i njohur edhe fakti që niveli i mbulimit mbetet i ulët dhe rrjedhjet janë rritur**. Vetëm një e treta e të varfërve marrin pjesë në program (Tabela 4.3). Ky mbulim

me NE është më i ulët në disa zona, veçanërisht në zonën Bregdetare, ku janë të mbuluar vetëm 10 përqind e të varfërve që jetojnë në atë zonë. Edhe në zonat ku ka patur sukses më të madh në mbulimin e të varfërve, si në ato Malore dhe Qendrore, pjesëmarrja e të varfërve është maksimumi 45 përqind. Në të njëjtën kohë, pjesëmarrja e jo të varfërve në program është rritur. Në total, 8 përqind e familjeve jo të varfëra u mbuluan në vitin 2002, por kjo është rritur në 10 përqind në vitin 2005. Kjo rritje është konstatuar në zonat Rurale, Malore dhe Qendrore. Në zonat rurale pjesa e familjeve jo të varfëra të cilat marrin përfitime u rrit nga 8 përqind në 2002 në 13 përqind në 2005, ndërkohë që në zonat Malore ajo u ngrit nga 27 në 30 përqind. Por në zonat urbane dhe Bregdetare, mbulimi i jo të varfërve u ul, ndërkohë që në Tiranë mbeti i njëjtë.

4.13 **Një vështrim i atyre që përfitojnë vetëm NE, tregon se pjesa e familjeve jo të varfëra të cilët kanë përfituar ("rrjedhja") është rritur ndërmjet viteve 2002 dhe 2005 nga 57 përqind në 64 përqind.** Midis rajoneve, numri i familjeve jo të varfëra të cilat morën përfitime, u rrit ndjeshëm në zonat malore dhe Bregdetare, ai qëndroi i njëjtë në Qender dhe u ul mjaft në Tiranë. Një rritje në rrjedhje është vërejtur gjithashtu në zonat rurale, ku fraksioni i jo të varfërve ndërmjet përfituesve u rrit nga 52 në 64 përqind.

**Tabela 4.3: Pjesa e familjeve jo të varfëra në programin e NE**

| | 2002 | 2005 |
|---|---|---|
| Breg | 57.31 | 68.89 |
| Qendër | 60.94 | 60.36 |
| Mal | 50.76 | 72.32 |
| Tiranë | 64.59 | 62.95 |
| | | |
| Urban | 64.75 | 67.83 |
| Rural | 51.62 | 62.43 |
| | | |
| Shqipëria | 57.33 | 64.17 |

*Burimi*: Vlerësime të stafit të Bankes Boterore nga të dhënat e sondazheve.

## B. SHPËRBËRJA E TARGETIMIT TË PERFORMANCËS+

4.14 NE është një program i decentralizuar. Sikurse administrohet aktualisht, NE ndjek një proces alokimi me dy faza. Së pari, si pjesë e procesit të buxhetit, parlamenti përcakton shpërndarjet totale për çdo komune dhe bashki mbi bazën e raporteve të dërguara nga Min. Punës, të cilat në vetvete bazohen në kërkesat dhe informacionet e komunitetit të paraqitura nga këshillat e zgjedhur të komunave dhe bashkive. Menjëherë pas përcaktimit të alokimeve, pushteti vendor lokale përcakton familjet e përzgjedhura, shumat për t'u transferuar në çdo familje dhe nëse duhet të plotësohet ndonjë kusht (si kërkesë pune) nga ana e familjes në mënyrë që të marrë përfitimet (Kutia 4.1**).** Kështu, është e lehte të kuptohet se natyra e decentralizuar e programit ndikon në efektivitetin e planifikimit të përgjithshem të programit. Për shembull, nëse pushteti qendror alokon shumicën e fondeve tek bashkitë më të varfëra dhe nëse pushtetet lokale konstatojnë familjet më të varfëra nën juridiksionin e tyre, programi pritet të mbulojë një pjesë më të madhe të varfërish dhe targetimi i performancës do të jetë më i lartë. Përkundrazi, nëse shumica e fondeve u alokohen bashkive dhe komunave më pak të varfëra, ne do të prisnim që targetimi i performancës të ishte më i ulët edhe nëse zyrtarët lokalë bëjnë përpjekjet maksimale për të gjetur të varfërit. Në mënyrë të ngjashme, nëse zyrtarët lokalë nuk bëjnë përpjekje për të gjetur të varfërit, apo më keq, i përdorin fondet për favore, duke i dhënë përfitimet tek familjet me

lidhje miqësie por jo domosdoshmërisht të varfëra, targetimi do të jete gjithashtu i ulet, edhe nëse alokimet janë bërë në mënyrë të ndershme. Ndaj, ne shpërbëjmë targetimin e performancës për të vëzhguar se sa nga performanca e programit në mbulimin e familjeve të varfëra buron nga përpjekjet e qendrës për të mbërritur tek komunat e varfëra (komponenti inter-komunë) përkundrejt përpjekjeve të komunës për të mbërritur tek popullsia e vet e varfër (komponenti intra-komunë ). Ne mbërrijmë në tre konkluzione kryesore:

**Kutia 4.1: Procesi i shpërndarjes së NE**

Programi i NE filloi më 1993 në përgjigje të papunësisë së vazhdueshme dhe revoltave sociale në rritje pas kolapsit të ekonomisë së planifikuar të centralizuar, me synim mbështetjen e familjeve urbane pa ndonjë burim tjetër të ardhurash dhe familjet bujqësore me pronësi të vogël toke. Në konceptim, pushteti qendror administroi fonde nëpërmjet zyrave lokale të ministrive. Megjithatë, në vitin 1995 programi u decentralizua meqë u bë e qartë se sistemi i centralizuar mundësonte stimuj të paktë për zyrtarët lokalë për të verifikuar legjitimitetin ose për të ruajtur disiplinën fiskale.

Sipas administrimit të tanishëm, këshillat e zgjedhur të bashkive dhe komunave përcaktojnë nevojat e familjeve të tyre në lidhje me disa tregues socio-ekonomikë dhe paraqesin kërkesat e tyre për fonde për NE tek Aministrata e Shërbimit Social Shteteror. (SSS). Më pas, SSS dhe MPÇS paraqet një kërkesë të përgjithshme për buxhet për t'u shqyrtuar nga autoritetet qendrore. Parlamenti vendos shpërndarjet në bazë të prioriteteve të buxhetit shtetëror. Pas përcaktimit të fondeve, SSS i paraqet më pas fondet e përcaktuara Drejtorisë së Programimit dhe Zhvillimit (DPZH) në Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale, e cila vlerëson prioritetet në nivel kombëtar dhe vendos mbi shpërndarjet përfundimtare për çdo komunë. Në vazhdim të vendimit të DPZh, dhe shpërndarjes së fondeve të NE tek bashkitë dhe komunat, zyrtarët lokalë përzgjedhin familjet përfituese dhe nivelin e përfitimit mbi bazën e udhëzimeve të përgjithshme mundësuar nga qendra. Përzgjedhja e familjeve përfituese përmban tre hapa.

Së pari, kryefamiljari aplikon për NE në zyrën lokale dhe kalon në një intervistë me administratorin social. Plotësimi i aplikimit për NE bëhet çdo muaj ndërkohë që intervista nga administratori social bëhet çdo vit. Aplikimi mujor kërkon që kryefamiljari të rideklarojë burimet e të ardhurave të familjes si dhe çdo ndryshim lidhur me statusin e punësimit të anëtarëve të familjes ose pronësinë e familjes. Së dyti, administratori social, verifikon informacionin e kërkuar dhe propozon një listë përfituesish të cilët plotësojnë kushtet dhe vlerëson nevojat për çdo përfitues. Së treti, këshilli lokal i zgjedhur përcakton përfitimet aktuale për çdo familje. Këshilli ka autoritetin të kushtëzojë përfitimet me pjesëmarrje me kohë të plotë apo të pjesshme në projektet e komunitetit.

4.15 **Së pari, targetimi i performancës është e ulët por është përmirësuar me kalimin e kohës**. Një rrugë për të vlerësuar targetimin e performancës është të përcaktohet koeficienti i targetimit (TC) si diferenca ndërmjet pjesës së të varfërve që marrin pjesë në program (mbulimi) dhe pjesës së jo të varfërve që marrin pjesë në program (rrjedhja) (shiko Gallaso dhe Ravallion, 2005). Koefiçenti shtrihet në periudhin -1 dhe 1. Një program i cili fokusohet në mënyrë të përsosur tek të varfërit – që supozon asnjë përfitim për jo të varfërit – dhe mbulon gjithë të varfërit – do të kishte një vlerë 1, ndërkohë që një program që fokusohet përsosmërisht tek jo të varfërit, do të këtë një vlere -1 meqënëse të gjithë jo të varfërit mund të marrin pjese në program, dhe mund të mos marrë pjesë asnjë i varfër. Së fundmi, koefiçenti do të ishte i barabarte me 0 në rastin e mbulimit të barabartë me rrjedhjen. Sikurse tregohet në Tabelën 4.4, koefiçenti i targetimit në vitin 2002, në nivelin 16.8 përqind është i ulët, por është përmirësuar në 23 përqind në vitin 2005. Koefiçenti i targetimit u rrit gjatë periudhës në fjalë, falë mbulimit të përmirësuar të të varfërve dhe një rritjeje mjaft të kontrolluar të rrjedhjeve. Një vlerësim i ngjashëm i targetimit të performancës, duke përdorur vlera transfertash në vend të sa më sipër, tregon përmirësime të pakta me kalimin e kohës. (Tabela D.3 dhe Tabela D 16).

**Tabela 4.4: Shpërbërja e Targetimit të Performancës duke përdorur nivelet e Pjesemarrjes së të varfërve dhe Jo të varfërve**

| | 2002 | | | 2005 | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Përgjithshme** | **Intra-komunë** | **Inter-komunë** | **Përgjithshme** | **Intra-komunë** | **Inter-komunë** |
| Qendror | 0.147 | 0.115 | 0.033 | 0.286 | 0.182 | 0.104 |
| Breg | 0.118 | 0.084 | 0.034 | 0.069 | 0.066 | 0.003 |
| Mal | 0.192 | 0.161 | 0.031 | 0.151 | 0.159 | -0.007 |
| Tiranë | 0.06 | 0.06 | 0 | 0.177 | 0.172 | 0.005 |
| | | | | | | |
| Urban | 0.184 | 0.164 | 0.02 | 0.266 | 0.234 | 0.032 |
| Rural | 0.16 | 0.073 | 0.087 | 0.197 | 0.1 | 0.097 |
| | | | | | | |
| Kombëtar | 0.168 | 0.105 | 0.062 | 0.23 | 0.144 | 0.086 |

*Burimi*: Vlerësime të stafit të Bankës Botërore nga të dhënat e sondazheve.

4.16 **Përfundimisht, targetimi i performancës në zonat urbane u përmirësua më shpejt krahasuar me zonat rurale.** Koefiçentët e targetimit në zonat urbane dhe rurale, matur në 18 dhe 16 përqind respektivisht, kishin diferencë të vogël në vitin 2002. Por në vitin 2005, targetimi i performancës në zonat urbane u përmirësua me 50 përqind, nga 18 në 27 përqind, ndërkohë që performanca rurale u rrit me gjysmën e saj, që është 25 përqind. Kjo ka ndodhur brenda një konteksti ku ka patur reduktime të mëdha në alokimet për zonat urbane, veçanërisht për Tiranën, krahasuar me zonat rurale. Shpërbërja e targetimit të performancës tregon se përpjekjet lokale shpjegojnë pothuajse të gjitha performancat e matura në zonat urbane, ndërkohë që në zonat rurale, përpjekjet lokale shpjegojnë pothuajse gjysmën e targetimit të performancës të matur. Në fakt, vetëm në zonat rurale përpjekjet e pushtetit qendror dhe ato të pushtetit lokal përkojnë me njera tjetrën në drejtim të targetimit të performancës sipas matjeve të bëra. Kështu që, shpërbërjet tregojnë gjithashtu se ka një përmirësim megjithëse paksa të ngadaltë të asaj pjese të performancës së reflektuar nga përpjekjet lokale. (Tabela 4.4).

4.17 Së dyti, komponenti intra-komunë, ose përpjekjet e komunave dhe bashkive për të mbërritur tek të varfërit e tyre, shpjegon më shumë se dy të tretat e targetimit të performancës. Shpërbërja e koefiçentit të targetimit tregon se të paktën dy të tretat e targetimit të performancës në nivel kombëtar, janë atribut i përpjekjeve të zyrtarëve lokalë për identifikimin dhe mbërritjen tek të varfërit. Për më tepër, me kalimin e kohës, kjo përpjekje lokale është përmirësuar në Zonat malore dhe Bregdetare dhe ka mbetur e njëjtë në Tiranë. Në zonat Qendrore, targetimi i performancës, pothuajse u dyfishua – koefiçenti u rrit nga 0.15 në 0.29. Megjithatë, mbi tre të katërtat e performancës u atribuohen përpjekjeve lokale, ndërkohë që dy të tretat mund të shpjegohen nga përpjekjet lokale në vitin 2005 (Tabela D.9).

## C. PËCAKTUESIT E PJESËMARRJES DHE PËRFITIMET

4.18 Si përmbledhje, evidencat sugjerojnë se mbulimi është i ulët por është përmirësuar, dhe përmirësimi madje është më i theksuar për të varfërit ekstremë, ndërmjet viteve 2002 dhe 2005. Për më tepër, përmirësimet më të mëdha janë vënë re në zona, të tilla si rurale dhe malore, ku jeton shumica e të varfërve. Megjithatë, sikurse tregojnë të dhënat, jo vetëm që shumë familje jo të varfëra mbeten në këtë program, por pjesa e përfituesve ndërmjet tyre, është rritur gjatë së njëjtës periudhe.

4.19 Një arsye për prezencën e vazhdueshme të jo të varfërve në listën e pjesëmarrësve do të ishte thjesht inercia, që do të thotë se, në kontekstin e transformimeve madhore strukturore dhe teknologjise së varfër të informacionit për të monitoruar ndryshimet e statusit të mirëqënies në familje, pushteti lokal mund të jetë vetëm një hap mbrapa në identifikimin e atyre që duhet të dalin nga programi. Nga ana tjetër, jo të varfërit mbeten në listë sepse ndoshta ka diçka që zyrtarët lokalë dinë mbi kushtet e vërteta të

mirëqënies së këtyre familjeve, diçka që mund t'i ketë munguar një instrumenti të paanshëm sikurse është agregati i konsumit. Kjo mund të jetë e vërtetë veçanërisht nëse shumë nga familjet që mund të konsiderohen jo të varfëra mbi bazën e konsumit të tyre të raportuar dhe vijës së varfërisë, gjykohen gjithsesi si të varfër . Në fakt, evidenca tregon se 60 përqind e jo të varfërve të cilët kanë marë përfitime, janë të një mesatareje prej 25 përqind mbi vijën e varfërisë (Tabela D.30 gjithashtu shiko Tabela D.29), e cila përkon në mënyrë preçize me përkufizimin e ndjeshmërisë së pranuar në këtë raport. Kjo na çon në një eksplorim të përcaktuesve të pjesëmarrjes dhe të niveleve të përfitimit.

**Figura 4.3: Shpërndarja e Pjesëmarresve Jo të varfër në NE sipas distancës së Konsumit real për frymë nga vija e Varfërisë**




4.20 Fillojmë me një vështrim të disa ndryshoreve të cilat përdoren si udhëzues nga zyrtarët lokalë për të përcaktuar të drejtën për të përfituar NE. Më pas ne e shtrijmë analizën më tej për të përfshirë një numër më të madh ndryshoresh duke përfshirë krizat, alokimet e NE si një mënyrë për të marrë një pjesë të informacionit lokal që mund të jetë përdorur nga zyrtarët lokalë, krahas udhëzimeve, për të përfshirë familjet në NE. Ne i krahasuam këto modele me një tjetër ku përdoren vetëm disa pajisje shtëpiake për të përcaktuar nivelin e varfërisë së familjes. Në të dyja rastet ne gjithashtu u munduam dhe vlerësuam se në çfarë niveli e parashikojnë varfërinë këto dy modele. Rezultatet i kemi përmbledhur më poshtë.

4.21 **Së pari, programi duket bën një përzgjedhje të mirë mbi bazën e udhëzimeve administrative**. Ky vëzhgim bazohet vetëm në faktin se përafërsisht të gjitha ndryshoret që supozohet të përdoren nga zyrtaret lokalë për të përcaktuar të drejtën e mbulimit me ndihmë, e kryejnë këtë funksion me vërtetësi – që do të thotë se koefiçentët i kanë shenjat e duhura dhe pothuajse të gjithë janë statistikisht të rëndësishëm. Për shembull, familjet që kanë një pensionist, të cilat kanë më shumë tokë në pronësi dhe ku ka më shumë punonjës dhe/ose kryefamiljari punon, kanë më pak premisa të marrin pjesë në program sikurse mund të pritet. Po kështu, familjet me kryefamiljar të ndarë/divorcuar, me më shumë se tre fëmijë ose që jetojnë në zona Malore kanë më shumë mundësi të marrin pjesë (Kutia 4.1 dhe Tabela D.25).

**Kutia 4.2: Udhëzimet seleksionuese dhe Nivelet e Përfitimit**

Udhëzimet seleksionuese dhe nivelet e përfitimit: Aktualisht, një familje nuk kualifikohet për NE nëse ka të paktën një anëtar që (i) zotëron/është bashkëpronar në çdo pronë tjetër veç banesës dhe tokës bujqësore; (ii) është aktiv ekonomikisht (punëdhënës, punëmarrës, ose i vetëpunesuar), (iii) është jashtë shtetit për çdo arsye tjetër veç arsimimit, trajtimit mjekësor, punës diplomatike, ose emërimit në një organizatë ndërkombetare, (iv) nuk është i regjistruar si punëkërkues i papunë, me përjashtim të pjesëtarëve të familjeve bujqësore, invalidëve të punës, të paaftëve, paraplegjikëve dhe tetraplegjikëve, (v) refuzon të pranojë oferta pune nga zyra e punës dhe/ose nuk merr pjesë në punët e komunitetit organizuar nga bashkia ose në kurse profesionale trainimi kur është i papunë, i aftë dhe në moshë pune; (vi) nuk e tërheq shumën e NE miratuar nga këshilli i bashkisë/komunës brenda 6 ditëve pune të fondeve që janë të disponueshme në bankë dhe (vii) ndërmerr veprime të qëllimshme për të përfituar NE në mënyrë të pamerituar. Duhet thënë gjithashtu se familjet bujqësore me tokë në zotërim kanë të drejtë për asistencë të pjesshme sociale.

Pasi një familje quhet e kualifikuar, kompensimi potencial mujor konsiston si më poshtë: për çdo pjesëtar të kualifikuar të familjes (i) 2600 Lek për kryefamiljarin, (ii) 2600 Lek për çdo anëtar të familjes mbi moshë pune (18+), (iii) 600 Lek për çdo pjesëtar familjeje në moshë pune dhe (iv) 700 Lek për çdo pjesëtar familjeje nën moshë pune. Në çdo rast, NE potenciale mujore, pavarësisht nga përbërja e familjes, nuk mund të kaloje 7000 Lek. Për të llogaritur përfitimet e NE aktuale mujore të familjes, administratori social llogarit në fillim të ardhurat e familjes së kualifikuar për NE. Këto të ardhura përfshijnë të ardhura nga (i) veprimtari ekonomike jo-bujqësore, (ii) skema të ndryshme të mbrojtjes sociale, dhe (iii) çdo lloj kapitali, prodhim toke dhe blegtori. Administratori social pastaj zbret të ardhurat aktuale nga NE mujore e mundshme për të përcaktuar nivelin aktual të NE të cilën mund ta përfitojë një familje e kualifikuar.

4.22 **E dyta, informacioni lokal është i rëndësishëm.** Ndryshoret e tjera që nuk përfshihen në udhëzime, por të cilat ndikojnë në gjendjen ekonomike të familjes, është konstatuar se janë të rëndësishme për pjesëmarrjen në program. Ndërmjet tyre, të rëndësishme janë tronditjet si humbja e një pune apo sëmundje. Pikërisht kështu duhet të jetë. Dhe kjo është një nga pikat e forta të programit. Rezultatet statistikisht të rëndësishme tek Tabela D.27, tregojnë se që të dyja këto tronditje, duket se merren në konsiderate nga zyrtarët lokalë. Për shkak se këto janë efekte marxhinale, rezultatet sugjeruan se një tronditje ekzogjene që çon në humbje të një pune, e ngre probabilitetin e përfshirjes në NE me 6 pikë përqindje. Premisa e pjesëmarrjes është 3 pikë përqind më e larte se për një tronditje shëndetsore (sëmundje).

4.23 **Së treti, historia e pjesëmarrjes ka lidhje me nivele më të larta përfitimi**. Ata që kanë qëndruar më gjatë në listën e pjesëmarrësve duket se marrin nivele më të larta përfitimi. Një muaj shtesë me tepër si një pjesëmarrës në NE shoqërohet me 47 lekë në muaj më tepër në përfitime (duke përdorur rezultatet e grumbulluara). Dhe ndërkohë që kjo ndihmë është ulur nga 57 në 39 Lek për muaj ndërmjet viteve 2002 dhe 2005, faktet tregojnë se kjo është pozitive dhe statistikisht e rëndësishme. Arsyeja kryesore për t'u shqetësuar për këtë rezultat është se duke paguar përfitime më të larta për qëndrim më të gjatë në program, mund të çojë në përpjekje më të pakta për të gjetur burime alternative të ardhurash – që do të thotë, se ka një potencial që krijon stimuj që i mbajnë familjet larg nga përfshirja në aktivitete më produktive dhe shpërblyese sikurse është pjesëmarrrja në rrogën jobujqesore. Evidenca paraprake sugjerojnë se ata që marrin NE varen nga NE për një pjesë të rëndësishme të mbrojtjes së tyre sociale. (Tabela D.21 dhe Tabela D.22) dhe ofrojnë më pak punë. Nga ana tjetër, përcaktuesit e tjerë të nivelit të fitimit janë të qëndrueshëm sipas pritshmërisë. Nivelet e përfitimit janë më të larta për familjet që janë shpërbërë (divorcuar apo ndarë) dhe jetojnë në zona Malore apo Qendrore, (krahasuar me zonën

Bregdetare), ndërkohë që ato bien me rritjen e nivelit të decileve. Gjithashtu përfitimet bien për familjet me pensione më të mëdha, me shumë punëtorë në familje, me një kryefamiljar në punë, dhe për ata që jetojnë në Tiranë.

4.24 Përfundimisht, ndryshoret e përdorura si udhëzues për të përfshirë apo përjashtuar familje nga NE, kanë fuqi të ulët parashikuese lidhur me statusin e varfërisë. Tabela D. 28 përdor të njëjtat ndryshore që janë përdorur si udhëzues nga zyrtarët lokalë për të përcaktuar kualifikimin për NE për të parashikuar statusin e varfërisë të familjeve. Me fjalë të tjera, ne shtrojmë pyetjen se sa janë në gjendje këto ndryshore të parashikojne statusin e vafërisë së familjeve bazuar në LSMS 2005. Rezultatet tregojnë se vetëm 29 përqind e të varfërve mund të parashikohen si të varfër nga këto ndryshore. Parashikimi është pak më i mirë për zonat Malore ku parashikohen si të tillë 34 përqind e të varfërve por këto ndryshore nuk kanë qenë rezultative në zona të tilla si Tirana, ku ato parashikojnë si të varfër vetëm 16 përqind. Krahasimisht, një model tjetër që mbështetet në informacion familjar lehtësisht të vëzhgueshem dhe të verifikueshem, tregon se është më rezultativ. Parashikimi rritet me 38 përqind nga përdorimi i karakteristikave të vëzhgueshme për banesën të tilla si: nëse familja ka apo jo ujë të rrjedhshem, banjë moderne, ose asete të tilla si veturë, antenë satelitore, furrë me gaz etj. (Tabela D.29). Kjo do të thotë se, një model që përdor vetëm asetet në nivel familje ose shtëpie mund të parashikojë 40 përqind të të varfërve si të varfër krahasuar me 29 përqind të parashikuar nga ndryshoret e "udhëzimit". Madje në disa raste sikurse në Tiranë, modeli i mësipërm e tejkalon dyfishin e vlerës sëparashikuar (numrin e pritshëm të të varfërve). Përvec kësaj, rezultatet nga një model i tille janë më të qëndrueshme se rezultatet e ndryshoreve të "udhëzimit".

**Konkluzion**

4.25 Programi i NE është i vogel. Në vitin 2005, ai përthithi vetëm 0.4 përqind të PBB dhe vetëm 6 përqind të gjithë shpenzimeve për mbrojtje sociale. Megjithatë, ai mbulon 15 përqind të familjeve dhe si mekanizmi kryesor për të mbërritur tek të varfërit, roli i tij mund të jetë më i rëndësishëm sesa ai që duket nga pjesa e buxhetit. Në vitet e fundit, alokimet e NE në komuna dhe numri i familjeve pjesëmarrëse është rritur mjaft, po kështu edhe nivelet e përfitimit për familje. Parë nga një këndvështrim pozitiv, mbulimi i të varfërve është përmirësuar, megjithëse mbetet i ulet. Përmirësimet kanë ardhur pjesërisht nga ulja e madhe e varfërisë, por ndoshta edhe nga përpjekjet për të identifikuar të varfërit në zona më të varfëra si zonat Malore dhe Rurale. Fatkeqësisht, pjesëmarrja e jo të varfërve është rritur gjithashtu në të njëjtën kohë. Një tipar interesant i ketij programi është natyra e vet e decentralizuar dhe të dhënat këtu tregojne se pjesa më e madhe e përfitimit në përmirësimin e mbulimit me ndihmë të të varfërve u atribuohet përpjekjeve të zyrtarëve lokalë për të mbërritur tek të varfërit nën administrimin e tyre.

# *SHTOJCA A*: RRITJA EKONOMIKE, VARFËRIA DHE PABARAZIA

**Figura A. 1: Normat e Rritjes së PBB**




*Burimi:* Database i ËDI dhe Albania Live**.**

**Figura A. 2: Përbërja sektoriale e PBB**




*Burimi*: Database i ËDI dhe Albania Live.

**Figura A. 3: Niveli i punësimit sipas grup-moshave; 2002, 2005**




**Figura A. 4: Funksionet e Densitetit Kumulativ-Kombëtar, Rural dhe urban: 2002-2005**



**Figura A. 5: Funksionet e Densitetit Kumulativ-Tirana dhe Zona të tjera Urbane : 2002-2005**




**Figura A. 6: Funksionet e Densitetit Kumulativ-Zona bregdetare: 2002-2005**



**Figura A. 7: Funksionet e Densitetit Kumulativ-Zona Qendrore: 2002-2005**




**Figura A. 8: Funksionet e Densitetit Kumulativ-Zona Malore: 2002-2005**



**Figura A. 9: Proporcioni i njerëzve me çezma në shtëpi**




*Burimi*: Llogaritjet e stafit të Bankes nga të dhenat e sondazheve.

**Figura A. 10: Proporcioni i njerëzve me çezma në shtëpi, Urbane**




*Burimi*: Llogaritje të stafit të Bankes nga të dhenat e sondazheve.

**Figura A. 11: Proporcioni i njerëzve me çezma në shtëpi, Rurale**




*Burimi*: Llogaritjet e stafit të Bankes nga të dhenat e sondazheve.

**Figura A. 12: Frekuenca e Varfërisë për parametra te Ndryshëm te Ekonomise së Shkallës, 2005**



**Figura A. 13: Frekuenca e Varfërisë për parametra te Ndryshëm te Ekonomise së Shkallës, 2005**




**Tabela A. 1: Shqipëria: Prirjet në PBB reale dhe Rritjen Sektoriale**

| | 1990 | 1991 | 1992 | 1993 | 1994 | 1995 | 1996 | 1997 | 1998 | 1999 | 2000 | 2001 | 2002 | 2003 | 2004 | 2005 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Ndarja Sektoriale | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Bujqësi | 23.2 | 26.4 | 33.7 | 34.0 | 33.7 | 35.0 | 33.0 | 32.7 | 31.1 | 28.8 | 28.0 | 26.7 | 26.1 | 25.3 | | |
| Industri | 39.3 | 32.4 | 20.5 | 19.2 | 18.4 | 19.0 | 20.2 | 16.4 | 18.8 | 23.2 | 21.7 | 21.5 | 21.0 | 20.8 | | |
| Ndërtim | 2.8 | 2.7 | 3.1 | 3.7 | 3.8 | 4.3 | 4.7 | 4.6 | 4.9 | 5.3 | 6.8 | 9.0 | 9.2 | 9.4 | | |
| Prodhim | | | | | | | 14.4 | 11.8 | 13.9 | 16.6 | 15.5 | 15.3 | 14.7 | | | |
| Shërbime | 32.8 | 38.8 | 43.7 | 46.0 | 49.1 | 43.4 | 46.8 | 50.9 | 50.1 | 48.0 | 50.3 | 51.8 | 53.0 | 53.9 | | |
| Rritja në përqindje | | | | | | | | | | | | | | | | |
| PBB | -9.6 | -27.5 | -7.2 | 9.6 | 9.4 | 8.9 | 9.1 | -7.0 | 7.9 | 7.3 | 7.8 | 6.5 | 4.7 | 6.0 | 5.9 | 5.5 |
| Bujqësi | 3.6 | -17.4 | 18.5 | 10.4 | 8.3 | 13.2 | 3.0 | -9.7 | 4.9 | 0.4 | 4.5 | 3.0 | 2.3 | 3.0 | | |
| Industri | -6.0 | -40.2 | -41.3 | 2.5 | 4.7 | 12.6 | 15.9 | -25.8 | 26.1 | 34.2 | 0.5 | 7.2 | 2.0 | 5.0 | | |
| Ndërtim | | -29.9 | 7.0 | 30.0 | 15.0 | 21.2 | 18.4 | -10.5 | 18.0 | 17.8 | 37.2 | 43.9 | 7.1 | 8.5 | | |
| Prodhim | | | | | | | | -25.1 | 29.5 | 29.6 | 0.7 | 6.5 | 0.3 | | | |
| Shërbime | -35.2 | -14.1 | 4.4 | 15.5 | 16.6 | -3.8 | 17.8 | -0.6 | 8.1 | 4.3 | 12.7 | 11.1 | 7.1 | 7.9 | | |

*Burimi*: ËDI 2003 për nivelet e rritjes se PBB. Albania Live Database për përbërjen sektoriale dhe normat e rritjes sektoriale.

**Tabela A. 2: Përmbledhje e Ndryshoreve Kryesore**

| Ndryshore | 2002 Mesatarja | 2002 Gabim standart | 2005 Mesatarja | 2005 Gabim Standart | Testi i ndryshimeve në mesatare Vlerat P |
|---|---|---|---|---|---|
| Konsumi Total | 7801 | 82.5 | 9105 | 105.1 | 0.001 |
| Ushqime | 4906 | 51.4 | 5159 | 53.1 | 0.001 |
| Jo-ushqimore | 1655 | 30.9 | 2457 | 48.9 | 0.001 |
| Arsimim | 177 | 7.5 | 275 | 12.6 | 0.001 |
| Utilitetet | 958 | 12.4 | 1087 | 13.4 | 0.001 |
| Asete të qëndrueshme | 105 | 3.1 | 128 | 34.2 | 0.67 |
| Madhësia e shtëpisë | 4.3 | 1.8 | 4.2 | 1.7 | |
| Vija e varfërisë ekstreme | 3047.0 | | 3047.0 | | |
| Vija e varfërisë absolute | 4891.0 | | 4891.0 | | |
| Një dollar në ditë | 1888.0 | | 1888.0 | | |
| Dy dollare në ditë | 3775.0 | | 3775.0 | | |
| Katër dollarë në ditë | 7549.0 | | 7549.0 | | |
| Vija e varfërisë relative | 7671.4 | | 8683.0 | | |

*Shënim:* Konsumi total, ushqimi, joushqimoret, arsimimi, utilitetet dhe të qëndrueshmet janë të gjitha të përllogaritura për fryme dhe sipas çmimeve të vitit 2002. Gabimet standarte të paraqitura perdoren per stratfikim dhe dhe janë llogaritur duke përdorur komandën svymean të STATA. Kini parasysh se hipoteza e mesatarcve të barabarta në shpenzime në të dy vitet hidhet poshtë në të gjitha rastet përveç mallrave(aseteve) të qëndrueshmeve.

**Tabela A. 3: Pjesët e Shpenzimeve të Komponentët e Ushqimit**

| Ndryshore | 2002 | 2005 |
|---|---|---|
| Buke dhe brumëra | 7.1 | 6.0 |
| Drithëra, miell dhe makarona | 9.6 | 10.6 |
| Mish | 20 | 19.4 |
| Peshk | 1.2 | 1.2 |
| Qumësht dhe produkte bulmeti | 21.3 | 22.1 |
| Vaj | 7.1 | 6.1 |
| Fruta | 4.3 | 4.7 |
| Perime dhe zarzavate | 14.7 | 18.2 |
| Perime të konservuara dhe të ngrira | 1.9 | 0.0 |
| Sheqer dhe ëmbëlsira | 3.7 | 3.4 |
| Erëza, piper dhe kripë | 0.5 | 0.7 |
| Pije jo-alkoolike, çaj dhe kafe | 3.6 | 2.8 |
| Të ndryshme | 0.3 | 0.1 |
| Ushqim i ngrënë jashtë | 4.5 | 4.7 |

**Tabela A. 4: Pjesët e komponentëve te Konsumit Real për Frymë**

| Komponentët e konsumit | 2002 | 2005 |
|---|---|---|
| Ushqim | 64.5 | 59.2 |
| Jo ushqim | 19.4 | 24.8 |
| Utilitete | 12.6 | 12.6 |
| Arsimim | 2.3 | 2.4 |
| Asete të qëndrueshme | 1.2 | 0.9 |

**Table A. 5**: **Rritja e Konsumit Real për frymë, sipas Shtresës, 2002- 2005**

| | 2002 | | | 2005 | | | Niveli i rritjes se konsumit | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Shtresa | Urbane | Rurale | Total | Urbane | Rurale | Total | Urbane | Rurale | Total |
| Bregdet | 8809.9 | 8122.5 | 8419.3 | 10750.5 | 8693.9 | 9580.5 | 1.22 | 1.07 | 1.14 |
| Qendrore | 8264.6 | 7136.6 | 7496.1 | 10088.5 | 7670.8 | 8510.6 | 1.22 | 1.07 | 1.14 |
| Malore | 7795.9 | 5759.5 | 6168.3 | 8159.2 | 6888.1 | 7140.6 | 1.05 | 1.20 | 1.16 |
| Tiranë | 9042.6 | | 9042.6 | 11812.5 | | 11812.5 | 1.31 | | 1.31 |
| Total | 8624.2 | 7211.6 | 7800.8 | 10690.1 | 7867.7 | 9108.0 | 1.24 | 1.09 | 1.17 |

**Tabela A. 6: Tendencat në Varfërine Eksteme, sipas Shtresës: 2002-2005**

| | | | 2002 | | | 2005 | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Shtresa** | **Treguesi i Varfërisë** | **Urbane** | **Rurale** | **Total** | **Urbane** | **Rurale** | **Total** |
| Bregdet | Numri i të varfërve (Headcount poverty) | 5.9 | 1.8 | 3.6 | 1.8 | 2.5 | 2.2 |
| | Thellësia (Hendeku) | 1.2 | 0.3 | 0.7 | 0.2 | 0.4 | 0.3 |
| | Ashpërsia | 0.3 | 0.1 | 0.2 | 0.0 | 0.1 | 0.1 |
| Qendrore | Numri i të varfërve | 3.4 | 5.1 | 4.6 | 3.5 | 6.0 | 5.2 |
| | Thellësia | 0.5 | 0.5 | 0.5 | 0.8 | 0.9 | 0.9 |
| | Ashpërsia | 0.2 | 0.1 | 0.1 | 0.3 | 0.2 | 0.2 |
| Malore | Numri i të varfërve | 7.8 | 11.6 | 10.8 | 2.6 | 3.4 | 3.2 |
| | Thellësia | 1.6 | 2.1 | 2.0 | 0.3 | 0.4 | 0.4 |
| | Ashpërsia | 0.5 | 0.5 | 0.5 | 0.0 | 0.1 | 0.1 |
| Tiranë | Numri i të varfërve | 2.3 | | 2.3 | 1.0 | | 1.0 |
| | Thellësia | 0.6 | | 0.6 | 0.1 | | 0.1 |
| | Ashpërsia | 0.2 | | 0.2 | 0.0 | | 0.0 |
| Total | Numri i të varfërve | 4.1 | 5.2 | 4.7 | 2.2 | 4.5 | 3.5 |
| | Thellësia | 0.8 | 0.7 | 0.8 | 0.4 | 0.7 | 0.5 |
| | Ashpërsia | 0.2 | 0.2 | 0.2 | 0.1 | 0.1 | 0.1 |

**Tabela A. 7: Tendencat në Varfërinë Ekstreme sipas zonave Urbane dhe Rurale: 2002-2005**

| Zona | Matja e varfërisë | 2002 | 2005 |
|---|---|---|---|
| Tirana | Numri i të varfërve | 2.3 | 1.0 |
| | Thellësia | 0.6 | 0.1 |
| | Ashpërsia | 0.2 | 0.0 |
| Urbane të tjera | Numri i të varfërve | 4.8 | 2.7 |
| | Thellësia | 0.9 | 0.5 |
| | Ashpërsia | 0.2 | 0.1 |
| Rurale | Numri i të varfërve | 5.2 | 4.5 |
| | Thellësia | 0.7 | 0.7 |
| | Ashpërsia | 0.2 | 0.1 |
| Total | Numri i të varfërve | 4.7 | 3.5 |
| | Thellësia | 0.8 | 0.5 |
| | Ashpërsia | 0.2 | 0.1 |

**Tabela A. 8: Tendencat në Varfërinë Absolute sipas Shtresave: 2002-2005**

| | | 2002 | | | 2005 | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Shtresa** | **Matja e varfërisë** | **Urbane** | **Rurale** | **Total** | **Urbane** | **Rurale** | **Total** |
| Bregdet | Numri i të varfërve | 20.2 | 20.9 | 20.6 | 11.6 | 19.7 | 16.2 |
| | Thellësia | 5.4 | 3.6 | 4.4 | 2.0 | 4.1 | 3.2 |
| | Ashpërsia | 2.1 | 1.0 | 1.5 | 0.6 | 1.3 | 1.0 |
